

Me sinqeritet ndaj lexuesit, dy autorë përfaqësues të Shqipërisë në Panairin e Leipzig-ut këtë vit, fitues të mbështetjes së Qendrës Komëbtare të Librit dhe Leximit për autorët e rinj, Suad Arilla dhe Dionis Prifti, librat e të cilëve i ka botuar shtëpia botuese "Albas", ndajnë me njëri-tjetrin mendime, përsiatje dhe ide për letërsinë, shkrimtarësinë dhe raportin e tyre me vetveten, brenda kontekstit dinamik të kësaj kohe si dhe me shoqërinë në përgjithësi.



SUAD ARILLA

bisedon me **DIONIS PRIFTIN:**

Në veçantinë e vet, letërsia shqipe është e barabartë me çdo letërsi tjetër

LAMTUMIRË MIKU IM BAJRAM SEFAJ!

Nga *Qerim Vrioni*

Pas një sëmundje të rëndë, në datën 12 mars 2024, u nda nga jeta në Francë atdhetari, shkrimtari, poeti, publicisti nga Prishtina Bajram Sefaj. Lajmi i hidhur më brengosi shumë, sepse atë e kisha mik të veçantë...

(fq. 4)

SHËNIME MBI LIBRAT

SHKRIMTARI DHE MËSUESI IM ZIJA ÇELA

Nga *Prof. Dr. Enver Bytyçi* (fq. 5)

Një *Vikamë Tingulli* për Jetën,
Dashurinë dhe Përjetësinë

PËR IKJEN SI NJË RIKTHIM

Nga *Raimonda Belli Gjençaj* (fq. 8)

Romani "Parij" – Eric Faye, Botoi BUZUKU

RITUALI I LUFTËS SHKRIMTAR - TIRANI

Nga *Ballsor Hoxha* (fq. 10)

Në librin me 30 tregime "Boh" – "Ku e di unë"

UNIVERSI FEMËROR I ALBERTO MORAVIAS

Nga *Diana Kastrati* (fq. 16)

Roman nga Tereza Boučková, "Ombra GVG"

"VITI I GJELIT" NJË DRAMË FAMILJARE E LETËRSISË ÇEKE

nga *Elsa Skënderi* (fq. 22)



SI E LEXOJ UNË ROMANIN "PARISI VRET" TË MIRA MEKSIT?

Nga *Floresha Dado*

Leximi romanor i nënshtrohet parimit të përshtatshmërisë: nevoja për të kuptuar, instikti 'interpretativ' janë të pranishme te çdo lexues.. Ndonjëherë, mbas një subjekti, në dukje të drejtpërdrejtë, të thjeshtë, fshihet një nëntekst më i ndërlikur...

(fq. 6)

"Të mbyturit dhe të shpëtuarit" – libri dhe ngjizja e tij

nga *Prof. Fabio Levi*

Përktheu: Aida Baro (fq. 20)

Botim i ri nga Minerva

FITO BETEJAT ME VETEN

nga *Darius Foroux* (fq. 21)

VËRTET DO TË ISHTE MË MIRË TË MOS E SHIHIM KURRË LIBRIN E FUNDIT TË MARKEZIT?

Nga *Álvaro Santana-Acuña* (fq. 23)



BIBLIOTEKË

Nurie Emrullai (fq. 13)

fytyra që unë shoh

e. e. cummings (fq. 18)

e mbaj zemrën tënde

Përktheu Roland Gjoza

Eljesa Kraja (fq. 17)

Borëbardhë relikat e mia

Begzad Baliu (fq. 14)

Kemi nevojë për një hero tjetër

Arben Velo (fq. 9)

Një kafe në "Le Rostand"

Arben Meksi (fq. 15)

Karikatura e të shtunës

Mbresa nga Women Composers Festival në Hartford

Rruga e mundimshme e grave kompozitore

Nga *Ina Kosturi* (fq. 11)

Nobelista polake flet për problemin me leximin e Xhejms Xhojsit, frymëzimin nga Yuval Noah Harari dhe për librin e parë të vjedhur.

Librat e jetës sime, *The Guardian*

OLGA TOKARCZUK: Leximi i Frojdit ishte hapi im i parë për t'u bërë shkrimtare

Përktheu: Granit Zela (fq. 19)

SUAD: Përshëndetje, Dionis. Për të qënë i sinqertë deri në fund me ata që do interesohen ta lexojnë këtë bashkëbisedim, më duhet të shtoj që unë e ti vetëm para pak ditësh ndamë sëbashku një kohë për t'u njohur më gjatë, shumë shpejt do ndajmë një kohë më të gjatë në panairin e Laipcigut. Pra, lexuesit do mund të na njohë, tekna në njohim njëri tjetrin.

Por unë doja të ndaja një dilemë, siç e ndava edhe me kolegun tonë Andreasin, nëse ky shkrim në gazetën ExLibris, format i cili mund të kthehet në një traditë për lexuesit, do ngjallë ndopak interes për të kuptuar dhe interesuar më tej mbi diskutimin e dy autorëve të rinj, me aq sa kanë mundur të lexohen dhe ndikojnë tek lexuesi shqiptar? E para kjo. E dyta, nëse për ta marrë vesh këtë, mund të lëmë të hapur sëbashku një sfidë publike, që të gjithë ata që do e lexojnë dhe njohin nëpërmjet këtij bashkëbisedimi, le të na kontaktojnë virtualisht ose të lënë një koment në faqen e gazetës, duke vlerësuar këtë format dhe shprehur një ide mbi çfarë lexuan.

DIONIS: Përshëndetje Suad! Për mua është gjithmonë kënaqësi të bisedoj mbi letërsinë, dhe meqë më pëlqen të eksperimentoj me të, më pëlqeu edhe ideja se do të ishte një format ndryshe. Sa për dilemën tënde, nëse mund të jetë në interes të lexuesve një bisedë mes dy autorëve të rinj, personalisht më ka lodhur pak kohët e fundit ky etiketimi "autor i ri". Jo se jam vjetëruar, po se nuk e kam pasur të qartë asnjëherë se çfarë do të thotë "autor i vjetër", qe të kuptoja pastaj "autor i ri". A përcaktohet vjetërsia nga mosha, numri i botimeve, numri i çmimeve? Kush e vendos se kur "vjetërohet" një autor? Une jam përpjekur të lexoj mbi autorët që më kanë lënë mbresa, qofshin ata të rinj a të vjetër. Është e vërtetë se intervistat që na bien në dorë prej tyre janë më së shumti në kohën kur ata janë bërë tashmë "të vjetër", por në këtë rast "vjetërsia" e tyre nuk është përcaktuar nga lexuesit më shumë se sa nga kritika. Dhe meqë ne tani po i drejtohem lexuesve e jo kritikës, le t'i lejojmë vetes të mos shqetësohemi për këtë.

Gjithsesi bie plotësisht dakord që ta sqarojmë dilemën tënde, nëpërmjet sfidës që u propozove lexuesve. Madje unë do e zgjeroja sfidën duke i ftuar ata që të na kontaktojnë e komentojnë jo vetëm për të vlerësuar formatin e kësaj bisede, por edhe për t'u bërë vetë pjesë e bisedës duke dhënë mendimet e tyre mbi temat që ne do të trajtojmë këtu. Si mendon?

SUAD: Besoj se ky presion i madh, Dionis, vjen prej vëmendjes së madhe së dhënë sidomos 3-4 vitet e fundit për "nxjerrjen" e autorëve të rinj në pah. Një politikë e këndshme kjo për të rinj si ty dhe unë, sepse kështu patëm mundësi të botoheshim. Apo mos ndoshta janë bërë të mërziqshëm autorët e vjetër? Por kjo intervistë mes ne dyve, mendoj se do vlerësohej edhe më shumë vetëm nëse do lexoheshim më shumë. Jo për tja lënë lexuesit fajin, por ndoshta për të kërkuar njëfarë llogarie ndaj tyre: që t'i hedhin sytë, të kthehen, të lexojnë dhe besojnë

Me sinqeritet ndaj lexuesit, dy autorë përfaqësues të Shqipërisë në Panairin e Leipzig-it këtë vit, fitues të mbështetjes së Qendrës Komëbtare të Librit dhe Leximit për autorët e rinj, Suad Arilla dhe Dionis Prifti, librat e të cilëve i ka botuar shtëpia botuese "Albas", ndajnë me njëri-tjetrin mendime, përsiatje dhe ide për letërsinë, shkrimtarësinë dhe raportin e tyre me vetveten, brenda kontekstit dinamik të kësaj kohe si dhe me shoqërinë në përgjithësi.

SUAD ARILLA

bisedon me

DIONIS PRIFTIN:

NË VEÇANTINË

E VET, LETËRSIA

SHQIPE ËSHTË

E BARABARTË

ME ÇDO LETËRSI

TJETËR

më shumë tek letërsia shqipe. Sa më i madh ky ndikim, aq më shumë interes kjo intervistë. Gjithashtu, mes autorëve "të vjetër" dhe atyre "të rinj" do doja të kishte një formë të tillë solidariteti dhe bashkëpunimi që kalon pritshmëritë e një çmimi, e një promovimi. Ëndërroj të jem i mirëpritur mes kolegëve që shkruajnë, jo si një person që po zë vend, duke ngushtuar hapësirën përreth tyre; por si një si dikush që zë vend dhe hap një vend të ri bashkë me ta.

Sfida që unë hapa dhe qasja që ti i shtove, i shkon më së miri kohëve

moderne: tërthorazi, është lexuesi që merr pjesë në letërsinë, diskutimet dhe shprehjen e nevojave të autorit. Me këtë dua të them, që mediumet e ndryshme, takimet fizike apo virtuale, tashmë mund ta lehtësojnë njohjen dhe dialogimin lexues – autor. Nuk dua të nënkuptohem sikur po hamendësoj që lexuesi duhet të sugjerojë për autorin tema apo ide, por duhet të jetë diku aty në hapësirën e madhe fantasmagorike të përceptimeve të autorit dhe ta ngacmojë, ta qortojë, ta përkrähë. Por për ta çuar përpara këtë, ne sollëm edhe qasjen e një strukture

mbështetëse, ti seç më përmende agjentin letrar para ca ditësh...

DIONIS: E vërtetë, e them shpesh se mungesa kryesore që ka tregu shqiptar i botimit, nuk janë as botuesit, dhe as institucionet promovuese, por agjentët letrar. Vetë roli i agjentit mendoj se është i paqartë te ne, shpesh i paragjykuar. Ndoshta me të drejtë, por une nuk dua të flas për përfitimet ekonomike të agjentit sepse nuk më intereson kjo pjesë; nuk më intereson sepse gjithsesi letërsia nuk mund të ketë përfitime ekonomike në Shqipëri. Këtë besoj e kemi të qartë të gjithë. Unë rolin e agjentit e shoh të domosdoshëm për t'i krijuar hapësirën e nevojshme shkrimtarit, që të shkruaj pa u preokupuar për marrëdhëniet me botuesin, promovimin e suksesin e librit, përkthimet, ribotimet, etj. Ti si mendon?

SUAD: Të them të drejtën nuk e kam plotësisht të qartë rolin e agjentit letrar. Vetëm kur e shqiptoj me zë "agjent letrar", më duket si një term letrar për letërsi të masash. Por një strukturë e cila përforcon veprën, mendoj që është ajo që i mungon; e në këtë rast unë e ti po e quajmë agjent letrar. Këtu pastaj dua të ndalem në dy gjëra: forcimi i veprës dhe përfytyrimi im për agjentin letrar.

Forcimi i veprës nxjerr jashtë loje imazhin e shkrimtarit dhe për libra që nuk i rezistojnë kohës, kjo është një dilemë ekzistensiale. Sipas meje, sa më i pranishëm publikisht imazhi i shkrimtarit, aq më të mëdha janë pretendimet e tij/saj në letërsi. Me pretendime dua të nënkuptoj: kërkesë për çmime, honorare, përfaqësime, përkthime. Kjo gjë, dashje – padashje, e mban "gjallë" autorin edhe pas vdekjes. Një vepër, sado pak e merituar, kur shpërblehet me çmim, i mbetet emri ndër procesverbale të pakundërshtueshëm shkencërisht.

Përfytyrimi im për agjentin letrar është ai që kryesisht merr përfaqësinë e autorit jashtë vendit të tij. Agjenti insiston ndër shtëpi botuese që ai të përkthehet, lobon që të promovohet, ngacmon persona që të shkruajnë për të apo edhe që libri të jetë në "longlist-a" çmimesh.

Tani, tregut të botimeve në Shqipëri, sipas meje, më shumë se sa mungesë, lidhet me një nevojë: atë të mbijetuarit. Një autor i ri apo i vjetër shqiptar, s'mund të kapë rekorde të tilla shitjesh apo risie letrare deri në atë pikë sa të bëhet një mbizotëruar i vëmendjes së përgjithshme. E dyta, mungesa e rëndësisë që i jepet letërsisë në hapësirat mediatike. Nëse para 50-70 vitesh shkrimtarët kanë qënë edukues të shoqërive përkatëse, sot letërsia ka marrë "karakter argëtues" dhe qëndron poshtë në nivel ndikues. Sipas një qasjeje bihevoriste, nëse për letërsinë, shkrimtarët dhe librat do flitej më shumë, do investohej më shumë, do mediatizoheshin më shumë, nëse do kishin më shumë të drejta mbi pronën e tyre intelektuale, nëse lexuesit do nxiteshin më shumë, atëherë për pasojë do kishim letërsinë si një faktor me rëndësi shoqërore.

Por këtu do doja të ndalesha tek e brendshmeja jonë si autorë. Ti Dionis ke një qasje ndryshe, nuk kërkon të imponohesh, as të japësh konkluzione me shkrimet tua. Prej disa tregimeve,



unë kam mbetur disi i çuditur dhe i papërbushur nga përfundimi, saora abstrakt. Kjo formë e jotja, le ta themi, a ka një qëllim konkret?

DIONIS: Gjithmonë më ka munduar pyetja, a duhet të kete një moral, konkluzion, mesazh? Çfarë duhet të mbetet në fund të leximit - vetëm një shije e mirë, apo duhet të mësohet diçka, duhet të mbahet mend diçka. Këtë e kam shtjelluar shpesh, në mendjen time dhe në shkrimet e mia letrare e joletrare, kështu që mund të flas shumë gjatë, por do përpiqem sa më shkurt.

Kjo pyetje për mua e ka origjinën vite më parë kur lexoja me entuziazëm mbi fillesën e surrelizmit dhe "përçarjen" e surrealistëve mbi temën: a duhet të jete vepra surreale automatike, ashtu si një ëndërr, pa u përpjekur të shpjegojë, apo duhet të ndërtohet e mirëmendohet, duke mbartur edhe një mesazh/moral në të.

Së pari, duhet përcaktuar çfarë nënkuptohet me "mesazh" apo "moral". Po, unë nuk do e bëj, shpresoj të jetë e qartë nga sa më poshtë. Në fund të fundit, besoj biem dakord që çdo përkufizim do të ishte i mangët - analiza semiotike e dekonstruktivizmit te Derrida.

Nëse thellohemi, së pari: që të pretendosh se mund të përçosh një mesazh, duhet te ndiehes kompetent dhe të marrësh përsipër përgjegjësitë. Kompetent jo në aspektin letrar, sepse atë kompetencë e ke pretenduar në radhë të parë që në çastin që fillon të shkruash, por kompetent në rrafshin moral ku



përfshihet mesazhi që kërkon të përçosh. Dhe të merren përsipër përgjegjësitë nëse ky mesazh jepet në mënyrën e gabuar, në kohën e gabuar. Sidoqoftë, vepra si e tërë ka vlera përtej mesazhit të saj, i cili mund të interpretohet edhe gabim. (Rasti më esktrim: Niçe).



Në aspektin tjetër, më të rëndësishëm përsa i përket cilësive e vlerave letrare: A është i vërtetë, i sinqertë një krijim letrar që nxjerr hapur apo përpjket të fsheh me maniera letrare një mesazh që në thelb mbart rrezikun e të qënit i gabuar?

Edhe në qoftë i vlefshëm, a duhet të jetë letërsia shërbyese e një morali/mesazhi, apo mund të jetë më shumë se kaq? Kjo temë është e trajtueshme në çdo formë të artit, por mbetemi te letërsia: janë elementët e saj vetëm në funksion të mesazhit, apo vetë këto elementë janë aq me vlerë sa të lejojnë t'i përdorësh edhe për qëllime të tjera, të eksplorosh mbi to, t'i përvetësosh e t'i rigruposh e diku gjatë këtyre përpjekjeve mesazhi mund të zbehet e të bëhet i parëndësishëm, madje, vërtet i tepërt.

Mua më pëlqen të mendoj se rrugëtimi është më interesant dhe më i vlefshëm se sa konkluzioni ku ti arrin, që do të jetë disi edhe morali, mesazhi që ti do të përfshije në veprën letrare. Sepse konkluzionet mund të jenë të ndryshme, mbartin me vete diskutimin e përgjegjësive, ndërsa rrugëtimi ka në të diçka "të shenjtë" mbi naivitetin e të mësuarit, e të perthithurit nga bota informacione, që në rastin më të mirë, një shkrimtar i aftë do i përçonte bukur letrarisht. Nëse ia lejojmë vetes heqjen e barrës së "konkluzioneve", do të ndërtonim një letërsi më dinjitoze, që mbi të gjitha e vlerëson lexuesin duke mos i servirur atij një vepër të gatshme e të ftohtë.

Ti çfarë mendon për gjithë këtë? Si është për ty procesi i të shkruarit?

SUAD: Për mua në fakt nuk është diçka që më shqetëson shumë apo që e mendoj. Siç e the, ti nisesh nga një ndikim i caktuar mbi surrelizmin. Unë nisem më shumë nga pika që i mendoj si të rëndësishme në procesin tim të të shkruarit: vetëdijësimi dhe zgjimi i lexuesit. Sepse unë përpjket ta lidh fort letërsinë time me dy koncepte: njohjen dhe të kuptuarit. Pikësëpari, të vetes, asaj që ndodh brenda nesh, atë që nuk e njohim, atë që na del si befasi, atë që nuk e kemi ditur kurrë që e kemi. Këto dy koncepte përpjket ti shtjelloj në 3 trajta: në marrëdhënie me identitetin dhe personalitetin e njerit, kohën (e shkruara, e tashmja, e ardhmja) dhe ndjenjat e emocionet. Nga ana tjetër mua nuk më intereson profili i qartë fizik i personazheve, vendi konkret, hapësira



LAMTUMIRË, MIKU IM BAJRAM SEFAJ

Nga Qerim Vrioni

Pas një sëmundje të rëndë, në datën 12 mars 2024, u nda nga jeta në Francë atdhetari, shkrimtari, poeti, publicisti nga Prishtina Bajram Sefaj. Lajmi i hidhur më brengosi shumë, sepse atë e kisha mik të veçantë, me njohje dhe komunikim prej rreth njëzetë vitesh. Bajram Sefaj është dalluar për veprimtarinë e gjatë edhe si gazetar në TV dhe shtyp, eseist, reporter, intervistues etj., por dhe si një nga gazetarët kryesor të gazetës "Rilindja". Për disa kohë ai ka shërbyer edhe si korespondent për media ndërkombëtare. Përmendim këtu edhe bashkëpunimin e tij me shtypin e shkruar të Tiranës, sidomos me shtojcën kulturore javore "Milosao" ("Gazeta Shqiptare") disa vite më parë, dhe kohët e fundit në të përjavshmen letrare "ExLibris". Shkrimet e tij në këto dy organe, lexoheshin me kënaqësi nga lexuesit e tyre.

Penës së Bajram Sefajt i përkasin dhjetra botime, thuajse të gjitha gjinive letrare, një pjesë e cilave ndodhet në bibliotekën time vetjake të dhuruara nga ai, e kjo më jep kënaqësi të madhe. Bajram Sefaj shquhej për stilin e tij të shkruarit shumë origjinal, shpesh here, thonë kolegët e tij, kuptojë autori ende pa shikuar emrin e tij nëpër gazeta. Duhet shtuar në këto rreshta edhe natyra e tij shumë miqësore dhe me humor që shpesh herë kalonte edhe në vetironi, aq e shëndetshme për mjediset e njerëzve të artit dhe kulturës.

Shuarja e Bajram Sefajt është quajtur me të drejtë dhe plot pezm prej disa kolegëve nga Prishtina si "varfërim i jetës kulturore". Me prurjet e tij të shumta dhe të larmishme në lëmin e letrave shqip, Bajram Sefaj, mendojmë se meriton një vend të nderuar në historinë e kulturës kombëtare shqiptare. Ndihem fort mirë që krijimtarisë time në lëmin e studimit të fotografisë dhe fotografimit, Bajrami i ka kushtuar disa artikuj analitikë dhe 2-3 intervista në shtypin shqip në të "dy anët e Drinit".

Gjatë 2-3 dhjetvjeçarëve të fundit ai jetonte në Francë bashkë me familjarët, veçse sa herë shkonte prej andej në Prishtinën "e tij", do të kthehej patjetër edhe në Tiranën "e tij", mungesën e të cilave e ndjente mjaft. Kthimi i fundit i Bajramit në Tiranë do ishte në shtatorin e vitit 2022. Natyrisht u takuam bashkë për tu çmallur, për të biseduar dhe pirë kafe tek Bar "Taivani", ku kaluam një copë herë edhe me humorin e tij të hollë dhe të pashtershëm. Aty është shkrepur dhe kjo foto (fotoja dyshe), e cila mbetet e fundit me të, por që do të ma kujtojë përherë mikun tim, Bajram Sefaj.

Botuar tek Gazeta "Illyria", 16 mars 2024




Foto Qerim Vrioni, 2006



gjeografike, përshkrimet e natyrës. Kjo, edhe sepse mendoj që letërsia bashkëkohore, siç e shoh dhe pretendoj unë, nuk interesohet edhe aq çfarë ndodh jashtë individit si akt në vetvete, po se si manifestohet e brendshmeja e personazheve jashtë tij, me veten apo ndaj të tjerëve.

Dionis, sëbashku ne do jemi shumë shpejt në Leipzig Buchmesse, por do doja të të pyesja: e para, çfarë pritshmëri ke? E dyta, sa mendon që letërsia shqipe është e barabartë me përfaqësuesit e tjerë në këtë ngjarje të madhe letrare ndërkombëtare?

DIONIS: Nuk di ç'të pres nga panairi i librit në Lajpcig. Do doja që letërsia shqipe të përfaqësohej me dinjitet e të merrte vëmendjen e duhur, por dihet që panairi është aq i madh, sa do të jetë e vështirë që të dëgjohemi ndër mijëra stendat e tjera. A është e barabartë letërsia shqipe me atë ndërkombëtare? Mendoj se po. Por do doja që të ishte e barabartë në veçantinë e saj, pra të sillte edhe ajo diçka të re në arenën e madhe.

Dhe që të mund ta kuptojmë qartë nëse jemi duke kontribuar diçka te lexuesit e huaj, duhet të ndalemi te përkthimi. Mendon se duhet të jetë patjetër qëllimi "largpamës" i shkrimtarit shqiptar të përkthehet e botohet jashtë Shqipërisë?

SUAD: Unë jam dakort me ty kur thua që letërsia shqipe duhet të jetë e barabartë në veçantinë e vet, por sa arrihet kjo, nuk mund ta dimë. Gjithashtu mendoj që letërsia shqipe, që të vlerësohet ndërkombëtarisht duhet të përfaqësojë diçka qartësiht shqiptare. Në mos asgjë të brendshme, minimalisht pra gjuha e autorit duhet të jetë e tillë që të prodhojë shqipen në një nivel general, por me qasjen e veçantë siç e përmende. Nëse përkthimi duhet të jetë një qëllim? Unë them se po ti përgjigjem me "po", kjo është një përgjigje më largpamëse se ç'duhet. Do parapëlqejja që letërsia shqipe të shkruhet pikësisht me fushëpamje të ndryshme, pse jo të pafundme, që janë të reja dhe njëkohësisht tradicionale, avangarde dhe kontradiktore, konformiste po aq sa edhe liberale – më shumë se të guximshme; e të gjitha këto njëherë mbizotërojnë lexuesin shqiptar dhe janë po aq të qëlluara sa të përhapen, lexohen dhe komentohen edhe nga lexues të huaj. Ndaj, unë i pari,

nëse në lexuesit shqiptar nuk arrij të kem një lexuesshmëri të gjërë, studim dhe kritikë shqip, nuk mendoj se do më ngrohë përkthimi në ndonjë gjuhë të botës. Sepse edhe në gjuhën e huaj, trajtesa e tekstit tim duhet të jetë e tillë, e zvarritur, mjerane, e papërfillshme. A mendoj unë personalisht që një ditë të përkthehem dhe a kam unë personalisht si qëllim të largët lexuesin e huaj? Pyetja më josh dhe s'mund të them jo. Por ndoshta pasi jam stabilizuar dhe mbasi ia kam hequr vetes mbiemrin i ri (pra, shkrimtar i ri).


Besoj, për ta mbyllur kam një pyetje të fundit: a mendon ti se letërsia shqipe u përgjigjet nevojave të lexuesve bashkëkohorë të huaj?


DIONIS: Mendoj se ka letërsi shqiptare që i përgjigjet shumë mirë lexuesve të huaj, por ka edhe autorë që gati me kryeneçësi e ngulin fort veprën e tyre vetëm në këtë vend duke e bërë atë të vështirë për t'u përthithur jashtë kontekstit shqiptar. Kjo nuk është domosdoshmërisht diçka negative, por nuk ka pse të jetë qëllim në vetvete, ashtu si nuk ka pse të jetë qëllim në vetvete e kundërta. Dhe kjo nuk duhet ngatërruar as me universalitetin e veprës, dhe as me një term që e shoh shpesh të keqperdorur së fundmi: globalizmin (i cili ngatërrohet për vete me universalitetin).

E mbyllem me pyetjen klasike, bajate, por ndoshta të domosdoshme: çfarë po shkruan tani?

SUAD: Po shkruaj një roman. E kam vështirë ta them se për çfarë flet, por në thelb ka temën e humbjes, zvetënimit dhe rrënimin të individit. Një dorëshkrim që pret ditët e lumtura (dhe të pakëta) për t'u shkruar prej meje. Ndryshe prej dy romaneve të botuar tashmë, ky do jetë një eksperimentim tjetër në formë dhe përmbajtje. Sidoqoftë, nuk e di kur do dalë... Po ti, a po shkruan ndonjë gjë sëfundmi?

DIONIS: Përveçse jam duke mbyllur studimet e një masteri të dytë, të një pasioni tjetër, regjisë së filmit, te Universiteti i Arteve, po merrem me dy romane që prej kohësh i kam në ripunim e sipër. Njëri prej tyre, romani satiriko-eksperimental "Dy javë nën balonë", besoj do të botohet këtë vit, dhe aktualisht është finalist i Çmimit Kadare 2024.





Sa herë flas me miq për letërsinë dhe Sbie fjala për shkrimtarin e madh Zija Çela, Nderi i Kombit, më bëjnë përshtypje dashuria dhe respekti i lexuesve të shumtë, që shprehin aq ndjeshmëri. Për mua është hera e parë që shkruaj për Zija Çelën. Jo se nuk kam dashur. Por e kam parë veten në vështirësi që të gjej fjalët e duhura për t'u shprehur publikisht. Edhe sot nuk mund t'i gjejë ato fjalë që meriton. Ose më saktë nuk mund t'i shpreh, edhe pse mendja ime i përsërit një e nga një e vazhdimisht vlerësimet e epërme për shkrimtarin e ndritur. Madje, për Zija Çelën më shumë sesa mendja më flet zemra e shpirti. Dhe ka arsye. Kam qenë vetëm 13 vjeç, kur e kam njohur. Isha nxënës i klasës së shtatë në shkollën dhe konviktin "Skënderbeu" të Krumës në Has. Zija Çela erdhi nga Helshani në Krumë së bashku me të shoqen, zonjën Aliqi. Ata kishin një vit që kishin mbaruar studimet e larta dhe, meqë shkrimtari kishte marrë mbi vete "barrën" biografike nga e shoqja, i kishin emëruar në një fshat, që ndante Kukësin nga Tropoja dhe ku nuk kishte as elektrifikim. Aty, nën dritën e kandilit, Zija Çela do të shkruante librin e tij të parë me tregime. Ata jo vetëm erdhën mes nesh, por jetuan me ne në konvikt, ku kishin një dhomë e zgjoheshin me zile si të gjithë konviktorët. I kishim të dy mësuesit më të mirë të gjuhës dhe letërsisë shqipe, por edhe kujdestarët tanë më të vëmendshëm, më të dashur. Luanim basketboll e volejball së bashku. Nganjëherë edhe futboll. Na donte, na përqafoje si të ishim të një familjeje. Aty në konvikt u bënë me Dritanin, që edhe ne na solli gëzim. Kur prindërit ndodheshin në shkollë duke dhënë mësim, dera e asaj dhome rrinte gjithnjë çelë dhe ne e mbanim foshnjën në krahë, luanim me të. Nëse qante dhe nuk arrinin ta pajtonim, ashtu hopa ia çonim mësues në klasë: "Oj zonjushë, po qan voci!". Skena që Zija Çela i ka përshkruar në mënyrë të paharrueshme në librin e tij "Për dashurinë shkruhet pas vdekjes". Ne ishim adoleshentë, por të përgjegjshëm. Asokohe profesori dhe modeli ynë, Zija Çela, ishte dhe mbeti mësuesi që vuri themelet në dijet tona. Shpesh herë them se, nëse jam ky që jam sot, meritë të jashtëzakonshme ka Zija Çela. Ai nuk na kërkoi kurrë të ishim perfekt. Por na ngjizi perfeksionin në të mësuarit e të nxënësit e dijes. Na dha vullnetin e leximit dhe të mësimit. Na motivoi si askush tjetër për të sfiduar kohën dhe limitet e vullnetit tonë. Në një vit do të lexonim së paku 100 libra të letërsisë për fëmijë. Madje edhe romanet e të rriturve. Zija Çela na bëri që të ishim të parët në rrethin e Kukësit në olimpiadat e letërsisë. Ishte ai që, nganjëherë, edhe në mesnatë na vinte te krevati e na pyeste nëse e kishim krijuar poezinë ose jo, nëse

SHKRIMTARI DHE MËSUESI IM ZIJA ÇELA

Nga Prof. Dr. Enver Bytyçi

e kishim përfunduar leximin e librit të radhës ose jo! Ishte kërkues, ishte krijues, ishte liberal dhe na krijonte atmosferën e një familjeje të përbashkët. Edhe pse ishte mësuesi ynë, nuk kishte ndonjë diferencë të madhe moshe, çka na jepte më lehtësi në komunikim. Vetë mësuesi bënte shaka, hidhte batuta e kënaqej edhe nëse dikush prej nesh ia kthente po me shpoti. Kurrë nuk u bë nervoz me ne, nxënësit e klasës së shtatë e të tetë në vitin tjetër. Kurrë nuk e ngriti zërin. Prandaj asnjëherë nuk bëmë ndonjë truk për të mos zhvilluar orën e mësimit, siç bënim me ndonjë mësues tjetër, duke ia zënë sobës oxhakun për ta mbushur klasën me tym, apo duke futur breshkën në sirtarin e shkumësave. Zija Çela ishte ndryshe, unik, dhe i tillë mbeti edhe si shkrimtar gjatë gjithë jetës së tij. Ndoshta pse, i lindur në Shkofër, ishte fëmija i shtatë i dy prindërve punëtorë, njëri prej të cilëve, babai, u nda nga jeta duke e lënë vetëm pesë vjeç. Ndoshta se vetë ai i kishte kaluar vështirësitë e jetës njësoj si ne. Ndoshta për të gjitha këto së bashku. Por ai vetë u realizua dhe u plotësua në jetë më mirë se shumëkush, sepse gjeti fuqinë, motivin e jetës dhe u ngrit me guxim kundër së keqes, madje edhe kur humbi Dritanin e shtrenjtë, përkthyesin me flatra, siç e kanë cilësuar. Të tilla i ka dhe veprat letrare. Në Has dhe në Kukës, Zija Çela shkroi katër vepra, deri te "Një verë pa lamtumirë", romanin që desh e muros me një lamtumirë të hidhur, si ajo që prodhonte diktatura. Në Helshan, Krumë dhe Kukës ndenji një dekadë, së bashku me mësuese Aliqin, Dritanin e Rivierën e vogël. Për ca kohë punoi si gazetar. Në udhën e gazetarisë më futi Zija Çela. Thonë se asgjë nuk ndodh rastësisht në këtë botë. Kjo do të thotë se jam krenar që mësuesi e modeli im i pakontestueshëm as sot pas 50 e ca vitesh ishte shkrimtari i madh, emri i shquar i letërsisë shqipe, Zija Çela. E me këtë rast, thjesht, po vë në dukje se ai na dha ne lexuesve 31 vepra letrare me tregime, novela e shumica romane. Na dha kumtin e krijimtarisë. Sepse në veprën e tij nuk gjen ujë të burimeve të ndotura ideologjike,



politike apo perverse. Është krijimtaria e një shkrimtari të përgjegjshëm për ndikimin e tij në publikun shqiptar. Është semantika që lidh botën shpirtërore të njeriut me nevojën e formimit kulturor të kombit. Për mua, duke vlerësuar individualitetin e krijimtarisë së tij, Zija Çela mbetet një shkrimtar i papërsëritshëm. Ta lexosh Zija Çelën ndjehesh në fund si pas një terapie psiko-analitike me Frojden ose Jungun. Ta lexosh Zija Çelën mëson se si përjetohen kategoritë e ndjenjave njerëzore, gëzimi e hidhërimi, malli, dhembja, dashuria dhe humanizmi. Veprat letrare të Zija Çelës janë, në një kuptim metaforik, kodikë e kode të shoqërisë shqiptare. Asnjë letrar nuk ka mundur ta imitojë stilin e të shkruarit në detaje të Zija Çelës, madje është thënë se për individualitetin e tij nuk ka as paraardhës. Zija Çela është dhe mbetet i papërsëritshëm. Unik në krijimtari, unik në paraqitjen e tij para publikut! Unik për mesazhet që jep! Unik në urtësinë dhe mençurinë e tij! Aq sa kur del në ekranet e televizioneve, tërheq menjëherë vëmendjen dhe vlerësimin e shikuesve. Në këtë kuptim, Zija Çela na shërben edhe si modeli i ndërtimit të shoqërisë sonë. Ja përse nuk është e rastit që edhe në ditëlindjet e tij ndjeshmëria mirëpritëse e lexuesit është aq e ngrohtë.



Kam përshtypjen se leximi im nuk është shumë pranë leximeve që kam parë në shtypin e kohës. I vlerësuar si romani më i mirë i vitit, vepra e Mira Meksit, natyrshëm, tërhoqi vëmendjen e disa kritikëve... Por, ne të gjithë njohim specifikën e letërsisë së vërtetë, e cila konfirmon *parimin artistik* se ky lexim nuk merr fund asnjëherë, madje ai përmban në vetvete korrigjimin, përmbysjen, rikuptimin e veprës... Nëse është pranuar se figurat e ndërtuara në vepër marrin kuptim vetëm nëpërmjet leximit, se lexuesi është ai që i jep jetë veprës, se nëpërmjet *leximit një tekst ndërtohet si tekst letrar*, etj., atëherë interpretimet nuk janë unike, çka lidhet me mënyrën e perceptimit ideor dhe zbrërthimit të shtresës së brendshme kuptimore. Të lexosh është punë deshifrimi. Leximi romanor i nënshtrohet parimit të përshtatshmërisë : nevoja për të kuptuar, instikti 'interpretativ' janë të pranishme te çdo lexues.. Ndonjëherë, mbas një subjekti, në dukje të drejtpërdrejtë, të thjeshtë, fshihet një nëntekst më i ndërlikur... Shkrimtari, duke shpikur një situatë 'reale', kodon një realitet imagjinar ku, mbas veprimit të dukshëm, të drejtpërdrejtë, duhet të ndiqen lëvizjet e brendshme kuptimore të botës artistike të veprës. Përcaktimi i raportit midis 'reales' dhe nëntekstit filozofik është qasja thelbësore në krijimtarinë e M.Meksit. Në këtë raport qëndron edhe vlera kryesore e romanit të saj të fundit.

Nëse interpretimi i disa shkrimeve, për këtë vepër, është përqendruar në intrigën e përndjekjes djallëzore, të fshehtë, në rrezikun nga diktatura që shoqëron shkrimtarin, ky nuk është boshti kuptimor thelbësor, nuk është interpretim i mjaftueshëm, sepse këtë temë e kanë trajtuar disa shkrimtarë në dhjetëvjeçarët e fundit. Romani "Parisi vret", shkon përtej kësaj qasjeje ! Sipas leximit tim, në romanin "Parisi vret", ka dy boshte kuptimore themelore që formësojnë origjinalitetin dhe pikëvështrimin e shkrimtares Mira Meksi, tashmë me shumë përvojë krijuese. Nuk janë çështje anësore, apo thjesht 'intriguese', por dekodim mbi kuptimin e vërtetë të romanit.

BOSHTI I PARË

Ç'është kjo ide e 'rimishërimit' që çmbërthen mundimshëm Martin Gjergjin, në çdo moment të shpirtit të tij në Paris, në dy udhëtimet e fundit ? Cila është filozofia e romanit ? Thjesht vizita e shkrimtarit në Paris, përpjekjet e diktaturës për ta hetuar e zhdukur, raportet dashurore me personazhet femra (Ana, Luiza dhe Julinda) ? Ta shohësh romanin "Parisi vret" vetëm në raportin : shkrimtari dhe përndjekja nga diktatura, episode dashurore me personazhet femra, në të vërtetë e zvogëlon atë, zbeh thelbin kuptimor të tij. Në konceptimin filozofik rimishërimi është një parim themelor i feve indiane, por edhe i disa feve antike apo dhe moderne, që ka në themel besimin e kalimit të shpirtit nga një trup në tjetrin, se pas vdekjes çdo qenie njerëzore rilind, rimishërohet, vazhdon të jetojë, përmes një procesi të ndërlikuar ekzistencial. Është një proces që nënkuptonin çlirimin shpirtëror, rilindjen në një trup tjetër. E ka Mira këtë besim fetar e filozofik, apo jo, kjo nuk ka fare rëndësi, por në planin artistik ajo mbështet këtë parim filozofik, këtë dëshirë përvëluese të shkrimtarit (që sigurisht është pasojë e përndjekjes nga pushteti) për t'u zhdukur, shuar dhe për të rilindur në trupin e një 'gruaje të lirë në një vend të lirë', ku 'dhe ajri që thithnin ishte i lirë', jashtë ndjekjes tinëzore të shërbimit sekret komunist. Dialogu me Luizën zbulon për herë të parë këtë synim gati hyjnor : *Shpirtërisht ti je këtu, Martin-i thotë Luiza- E kam fjalën që*

SI E LEXOJUNË ROMANIN "PARISI VRET" TË MIRA MEKSIT ?

nga Floresha Dado

vepra jote gallon këtu e lirë. Gjej një mënyrë për ta sjellës trupin përgjithmonë këtu...- Po, iu përgjigj ai duke qeshur sërish. -me siguri një ditë do rimishërohem në këtë vend. - Ndoshta, më saktë, do rilindësh në botën e lirë, e mbylli bisedën ajo... (f.36)

Autorja ka realizuar në mënyrë origjinale dilemën e personazhit, i cili e ndjen se tashmë "transmigrimi i shpirtit" kish ndodhur në gjallje të tij, ndërsa lënda, trupi kish mbetur atje ku përndiqej nga policia e fshehtë. Personazhi përjeton dramën e brendshme se "ishte e pamundur që lëndërisht të kalonte përgjithmonë në botën e lirë, duke ekzistuar njëkohshëm edhe në burgun e madh që ishte vendi i tij." Dhe drama shpirtërore ishte se "tërë ato vite ishte përpjekur pikërisht për të sjellë lëndën e tij përgjithmonë në botën e lirë. Kjo kuintesencë që kishte përbërje palce dhe truri, siç e kishin përcaktuar mistikët, ishte boshti i botës, ishte fara e tij..." (f.38). Duhej të vdiste, pra, që të ringjallej në botën e lirë. Kjo është ëndrra e


tij ? Në mënyrë metaforike, përmes ëndrrës dhe halucinacionit, shkrimtari Martin Gjergji ndjen se vdekja e Luizës ishte : "të më presin udhën drejt botës së epërme..." , se kupa e artë pritëse e farës së tij, që do ta ndihte të kalonte lëndësisht në botën e epërme, në botën e lirë, nuk ekzistonte më. Pra raportet e Martinit me Luizën, më pas edhe me Julindën, nuk duhen parë thjesht si një marrëdhënie dashurie, por si filozofi e dëshirës gërryese për të ikur nga realiteti përndjekës dhe për t'u rimishërtuar në një botë të lirë. Është po aq alegorike për qasja e gjendjes ëndërr të personazhit me legjendën e Doruntinës, e konceptuar jo si filozofia e besës, por si besëshkelje (në intrigën që u imponohet nga sigurimi i shtetit të dy personazheve të dashuruar ndaj njeri tjetrit). Dështimi, për herë të dytë, i rimishërimit (vdekja/zhdokja edhe e Julindës), i kalimit shpirt e trup në botën e epërme, është drama e thellë e personazhit, të cilin Mira Meksi e ka konceptuar jo thjesht me skena



të përndjekjes, por në filozofinë e ringjalljes në një trup tjetër, që i përket një bote tjetër. "Transmigrimi i shpirtit, mërmëriti, kish ndodhur në gjallje të tij. Me sa duket mund të ndodhë vetëm në shpirtin e një krijuesi. Po lënda, trupi si mund të kalonte këtej, duke qenë anej për të gënjyer policinë e fshehtë të rregjimit të Tiranës ?...një pjesë e mirë e ndëndërgjegjes së tij u ndriçua mjaftueshëm që Martin Gjergji tyë kuptonte se se tërë ato vite ishte përpjekur pikërisht për të sjellë lëndën e tij përgjithmonë në botën e lirë. Ky do të ishte një lloj rimishërimit modern, kalimi i kuintesencës lëndorë të një të gjalli në botën e epërme, në botën e lirë. Kjo kuintesencë që kishte përbërje palce dhe truri, siç e kishin përcaktuar mistikët, ishte boshti i botës, ishte fara e tij..." (f.38)"

Kështu, drama e personazhit është më e thellë se ç'duket, sepse e kupton që rimishërimi për së gjalli nuk pranohej (siç bëhej në ujrata e pagëzimit ; duhej të vdiste që të ringjallej në botën e lirë. Përballë këtij parimi, autorja ngre idenë se forca e vetme që mund ta realizonte këtë rimishërim prej së gjalli, ishte dashuria! Poor, asgjë nuk mund të ndodhë, sepse dhe dashuria, që mund ta shpëtonte, ishte e ndaluar, ishte porosia fatale për të vuarë përfundimisht shpirtin e tij. Të dashurat e personazhit vriten ose detyrohen të zhduken...Dashuria , që do t'i siguronte kapërximin mitik në një botë tjetër, është tragjike dhe dërrmon ëndrrën e tij. Në këtë plan romani "Parisi vret" ka një kuptim më të thellë filozofik, se sa raportit me diktaturën. Është raportit me jetë-vdekjen, për t'iu kthyer një jete tjetër. Pamundësia, drama shpirtërore, i japin romanit një qasje dhe origjinalitet, ku në themel është jo thjesht përndjekja e shkrimtarit nga rregjimi diktatorial, por drama e dëshirës mbinjerëzore për t'u rishfaqur edhe një herë në jetë, në një botë tjetër, të lirë. Në këtë kuptim mendoj se në themel të shtresës kuptimore të romanit "Parisi vret" është jo thjesht diktatura, që ka shumë fytyra, jo thjesht rreziqet e shkrimtarit në atë rregjim, por filozofia e transformimit në një trup të ri, në një botë të re. Kjo është një filozofi që ka brenda vuajtje, dëshirë, sakrifikim dhe dështim ! Në këtë kuptim mund të them se autorja temën e diktaturës e vështron në një aspekt më të thellë, më filozofik, ekzistencial. (Ashtu sikurse në themel të romanit *Diktatori në kryq* nuk është thjesht figura e diktatorit shqiptar, por një filozofi më universale, makthi për ringjallje për të qenë sundimtar i pavdekshëm...)

Ndikimi estetik i figurës së Martin Gjergjit (i cili lehtësisht identifikohet nga lexuesi me shkrimtarin tonë bashkëkohës më të madh, çka nuk ka rëndësi parësore) përcaktohet nga lidhjet e vendosura, nga sinteza, nga marrëdhëniet e funksioneve subjektivo-vlerësuese dhe objektivo-përshkruese, nga intensiteti i tyre, nga kundërvënja, dashuria e disfata...Siç e thashë, vlera e veprës qëndron jo thjesht në episodet interesante të subjektit, por në filozofinë metaforike të rimishërimit, që



realizohet përmes kalimit të konvencionit artistik të romanit në diçka jokonvencionale, që i jep lexuesit zbulimin e vërtetë të kuptimit, duke vendosur atë në procesin e perceptimit të brendshëm të hallkave që i japin kuptimshmëri të përgjithshme. Nëse vepra nuk do të kishte një proces të tillë ajo do pushonte së qeni vepër arti dhe burim interesi estetik të veçantë...“Parisi vret” e kapërçen në mënyrë të natyrshme këtë rrezik dhe fton lexuesin të zbulojë filozofinë e brendshme të personazhit. Për të kuptuar vlerën e veçantë që ka në këtë roman konceptimi i figurës-personazh nga kjo autore, mund të kujtojmë se në një pjesë të mirë të veprave të saj boshtin e strukturës së brendshme kuptimore e përbën filozofia ekzistenciale.

BOSHTI I DYTË : LINJA E FAMILJES SË MUZAKAJVE

Është specifikë e krijimtarisë së Mira Meksit që, në disa romane, (*Diktatori në kryq, Puthja e Amazonës*) shkojnë paralelisht dy linja subjekti, që, në lexim të sipërfaqshëm, duket sikur nuk kanë ndonjë lidhje me njëra tjetrën. Njëra linjë është më reale, e drejtpërdrejtë, tjetra më pranë imagjinatës, *trillimit alegorik*...Këtë dukuri lexuesi mund ta ndjejë edhe në romanin “Parisi vret”, duke mos u përqëndruar në kuptimin filozofik të përjasjes. Mund të ndodhë, në këtë roman, që njëra linjë, ajo e familjes së Muzakajve, të lexohet thjesht me kureshtje, të duket interesante dhe kaq... Një lexim i tillë e ngushton strukturën e brendshme kuptimore, cënon tërësinë, sepse procesi i leximit të një veprë nga kritiku letrar nuk është thjesht dëfrim, kalim kohe, por ‘zbulim’ shpirtëror, mendim i papritur, kuptim i thelbit filozofik të çdo personazhi, raporti, mjedisi etj. Në lexim të parë linja e familjes së vjetër historike të muzakajve është shumë tërheqëse, por ç’kuptim ka në strukturën e jashtme dhe të brendshme të romanit ? Ç’lidhje ka me filozofinë themelore të veprës ? Mund të them se, në përshtypjen time, Mira ka një tërheqje apasionante ndaj historisë së vjetër të shqiptarëve, si ndaj vjetërsisë së gjuhës, ashtu dhe ndaj figurave të shquara të historisë shqiptare. Historia e familjes së muzakajve, e paraqitur me origjinë nga Gjergj Kastrioti, sigurisht nuk është një trillim kapriçoz, por tezë e gjetur në ndonjë shkrim apo vepër që vjen nga periudha e mesjetës së vonë, apo dhe nga kërkimet arkivore, bibliografike të kësaj autoreje, që ka tërheqje të veçantë për legjendat, kuriozitetet historike e kulturore të vendit të saj. Po pse zhvillohet kjo linjë në këtë roman ? Paralelizmi ‘i çuditshëm’ midis dy linjave (shkrimtari në Paris... dhe misioni i detyruar i Julindës) shpreh, në thelbin e vet një dramë tjetër që shkaktoi diktatura shqiptare...*rruga për në kryeqytetin e botës ishte udha e mundimshme e kryqit mbi shpinën e saj*. Presioni i sigurimit të shtetit për ta rekrutuar Julindën, pasardhëse e një familjeje të shquar të historisë shqiptare, në përndjekjen e shkrimtarit Martin Gjergji, është po aq drithërues, fyes, poshtërim, degradim i madhështisë së familjeve të mëdha...Drama e vazhës është akoma më tronditëse se situata e personazhit kryesor. Kjo dramë i kapërçen kufijtë e individit për të përvijuar dramën e një populli. Në stilin e Mira Meksit ëndërra, halucinacioni luajnë shpesh një rol të spikatur, që ndodh kur drama shpirtërore është përtejnjëzore. Dhe, në këtë aspekt, metafora e shkodimit të letrës disa shekullore drejtuar Skënderbeut, kur një histori e fshehtë dashurie i jep ngjyrë tjetër personit historik, mbajtja e fshehtë, vështirësia e zbrërthimit të dokumentit të lashtë... në aspektin filozofik i jep frymëmarrje më të gjerë boshtit themelor të romanit. Alegoria e përjasjes midis dy



linjave përmban në vetvete misterin që rrethon njeriun, përndjekjen e fatit që ia organizojnë të tjerë, përdhunimin e lirisë së individit...

Në përfytyrimin krijues të autores në fund të veprës mësohet se është arritur, « të shkodohej një tekst i kyçur me kodin djallëzor »... Pritjet për shkodime vazhdojnë në historinë e Shqipërisë sikurse dhe në historitë e shoqërive të hershme diktatoriale. Simboli i ‘shkodimit’ të « një teksti të kyçur me kodin djallëzor » i përcjell lexuesit filozofinë e fshehtë të së vërtetës, ose të pabesisë, ose të sekretit që i jep çdo veprimi...Paralelizmi alegorik midis ‘zhdukjes’ së personazhit, Julindës, dhe shkodimit të letrës së shekullit XVIII, rikthen në vëmendjen e lexuesit të sotëm se historia kërkon shkodim të të fshehtëve, pabesive, intrigave që veprojnë mbi fatin e individit. Raportet Martin-Ana, Martin-Luiza, Martin-Julinda nuk janë thjesht marrëdhënie dashurie, por shkodimi i një raporti ekzistencial, që ngrihet mbi të fshehtë dhe pabesinë. Dy episodet në mbyllje të romanit, nga një anë shfaqja e mistershme e Julindës që nuk paska vdekur (!), nga ana tjetër realizimi, më në fund, i shkodimit të letrës së papës të shekullit XV, që fshihte një mesazh dhe fakt të panjohur, formojnë paralelen alegorike të shkodimit : sekretet, përndjekjen në plan djallëzor dhe dokumente të fshehtë në planin historik, si dukuri që shoqërojnë njerëzimin gjatë gjithë historisë së tij.

Përplasja e madhe e dy boshteve : përndjekja e fshehtë e shkrimtarit Martin Gjergji nga diktatura, që mbart rrezikun e jetës së tij, dhe drama e Julindës së pafuqishme përballë hakmarrjes së

sigurimit të shtetit, bëjnë që kufijtë e romanit “Parisi vret” të kenë shtrirje dhe kuptim më të gjerë, përtej subjektit që thur gjithë rrëfimin, sado interesant dhe tërheqës të jetë ai.

RAPORTI MIDIS REALES DHE STRUKTURËS KUPTIMORE

A duhen lexuar situatat e veprës si reale ? Romani “Parisi vret” të tërheq, në lexim të parë, si ndërtim situatash, ngjarjesh të një kohe dhe hapësire reale, që brezi im e ka jetuar qartazi, por, mbas kësaj ‘konkretësie reale’ sfida e leximit tonë është kuptimi i brendshëm i këtij realiteti artistik. Kjo na risjell në mëndje parimin krijues se figura artistike-personazh e shkrimtarit Martin Gjergji, ndonëse lexuesi e identifikon lehtëzi me person real, nuk është thjesht riprodhim i tij, formë e tij, por një zhvillim artistik. Të shijosh zhvillimin e intrigës, subjektin, raportet midis personazheve, pa depërtuar në thelbin e këtij raporti, do të thotë që vepra nuk është lexuar ! Kur themi se kuptojmë romanin, kjo do të thotë se kemi zbuluar një marrëdhënie të qartë midis këtyre dy botëve: botës reale dhe botës trilluese, prandaj thelbi dhe vlera e kësaj veprë është sfida midis reales, që është e fuqishme, e drejtpërdrejtë, dhe nënkuptimit, filozofisë së saj. Raporti midis dimensioneve të realitetit shqiptar, në pragvitet e shembjes së diktaturës, dhe atyre të romanit përcakton atë që mund të quhet “densiteti referencial” i tekstit ; në këtë raport konvencioni është kategori e rëndësishme e njohjes artistike, që përcakton marrëdhënien e brendshme dhe

të mprehtë midis ngjarjeve të romanit dhe strukturës së brendshme kuptimore të tij.

Ka një lëvizje të jashtëzakonshme në vorbullën e mendimeve të Martin Gjergjit, një dilemë që shpartallon çdo ndjenjë e qetësi... Pas brendësisë së figurës ndjejmë diçka më shumë se ç’shprihet në mendimet apo dhe në veprimet e drejtpërdrejta. Rimodelimi në një person-figurë, i një personi real të ditëve tona, e bën të veçantë këtë raport, duke e vënë lexuesin në një sfidë shumë më të fuqishme se ç’ndodh në vepra të tjera të letërsisë dhe të po kësaj autoreje, ku trillimi i personazheve është thelbësor dhe më i sofistikuar. Rreziku qëndron te realja, e cila është e fuqishme, e prekshme dhe imponuese në kuptimin e drejtpërdrejtë. Ajo sikur është e rrethuar nga një sferë e ndërmjetme-asociative që zgjeron mundësitë e saj... Pikërisht në këtë sferë ngjizet, zhvillohet dhe zbulohet një formë e tillë komplekse e konvencionit artistik si nënteksti i mendim të figurës, që shprehet drejtpërdrejtë në një mënyrë paksa të ‘paqartë’ (të rimishërohet!). Por kjo lind përtej caqeve të figurës, si konkluzion i thelbësor në ndërgjegjen dhe përfytyrimin tonë, gjatë leximit të veprës. Nëse është thënë se çdo figurë-personazh është unitet origjinal i objektivës dhe subjektivës, i së përgjithshmes dhe të veçantës, bazën e brendshme konkrete të së cilës e përbën konvencioni artistik, atëherë mendoj se një aspekt thelbësor i romanit është kaluar paksa përciptazi: është qasja që nuk lidhet thjesht me kuriozitetin e rrjedhës së subjektit, por më thellë, me filozofinë e romanit “Parisi vret”. G.Lukac thoshte se nuk ka rëndësi nëse synimi në veprën e artit është vizatimi i së tërës së shoqërisë ose vetëm i një ngjarjeje të izoluar artificialisht; synimi do të jetë, gjithësesi, të vizatojë pafundësinë intensive të subjektit. Kjo do të thotë se shkrimtarja kur synon të krijojë faktorë ‘realë’ të realitetit shqiptar, apo dhe francez, që lidhen me perceptimin e personazhit, realizon idenë ekzistenciale, universale të dëshirës për një jetë të lirë, në një botë të lirë, në një dashuri të lirë.

Romani i Mira Meksit konfirmon thelbin e letërsisë së mirë, se ka rëndësi jo çfarë është e vërtetë por çfarë është fiksjon. Me këtë kuptojmë se figura artistike-personazh e Martin Gjergjit, nuk është thjesht riprodhim i jetës (personi i njohur real), formë e saj, por një pafundësi artistike, e pashtershme, si rezultat i pashtershmërisë së vetë letërsisë. Leximi i romanit, si i çdo teksti letrar, e ve kritikun përballë sfidës thelbësore që provokon letërsia : të depërtojë në strukturën e brendshme kuptimore, për të nxjerrë atë që është e ndryshme nga vepra të tjera, ku trajtohet e njejtë temë, për të depërtuar në sistemin filozofik të procesit krijues të autorit.

Ndryshe nga prirja ime e zakonshme për të interpretuar poetikën e ndërtimit artistik të një veprë letrare, pra edhe për “Parisi vret”, ku mund të flitej për format rrëfimtare, raportin me mitologjinë, detajin e figurëzimit të personazheve, mjeshtërinë e vizatimit të mjedisit, shfrytëzimin me një masë të përkorë të ëndërrës dhe halucinacionit, pasurinë ligjërimore (si një nga vlerat më të çmuara të stilit krijues të M.Meksit), përjetimet e brendshme të pashprehura, referimin në histori, etj. : këtë herë u përqëndrova në interpretimin e dy boshteve themelore kuptimore të romanit “Parisin vret”, për të zbuluar vlerën thelbësore të saj: filozofinë që përcjell te lexuesi. Mund të mos jeni dakort me interpretimet e mia ? Edhe mund të ndodhë, sepse, në fund të fundit, çdo lexues ka qasjen dhe kuptimin e vet (por deri aty ku interpretimi mos të varfërojë kuptimet e strukturës së brendshme kuptimore).

Ishte hera e parë që më ndodhte. E nisa leximin e librit nga kopertina. Më goditi mendimi se askush nuk e mendon vlerën reale të një fotografie në momentin që e shkrep. Një shkrepje jetëson çastin, të shkuarën, por jo të ardhmen. Por ja që ardhka një çast tjetër kur një shkrepje e dikurshme i rrëfen së sotmes për të djeshmen dhe zë vend në kohë për të udhëtuar nga një e ardhme në një tjetër. Pafundësisht. Kujtdo që ka kënaqësinë ta “dëgjojë” nga afër veprën “Vikama e Tingullit” (botuar nga “Onufri”), do t’i mbetet në sy, figura e gjenit të muzikës shqiptare, Fehim Ibrahim, i përkulur mbi piano, i përhumbur mbi pentagram, me një laps në dorë, që prej atij çasti ka fituar privilegjin të jetë një objekt i çmuar, që e ka shoqëruar kompozitorin në ditët e netët e tij të frymëzimit, të mundimit, të ankthit, të triumfit, të zhgënjimit... Dhe prapë të triumfit, se veprat e gjenive nuk njohin rrugë tjetër... Ndërkohë që duke lexuar ende kopertinën, si një fillim dhe si një finale madhështore të veprimtarisë së kompozitorit, më vizatohen si krahe fluturash mbi flokët e tij, shkronjat e emrit të një gruaja që, në një fat të ndërsjellë për të dy, u bë jo vetëm dashuria e tij, por dhe bashkudhëtarja e brengave dhe gëzimit dhe tashmë rrëfimitarja e mrekullueshme e një jete, bukurinë e së cilës nuk mund ta tjetërsojë asnjë dhimbje. As ikja pa kthim...

Shfletimin e librit e nisa me idenë se po mbaja ndër duar një monografi. E nisa dhe me dilemën, nëse do t’ia dilja ta përballoja dhimbjen e dikujt që e njihja dhe e doja, që në bankat e shkollës së mesme, në korridoret e së cilës përcillte ngrohtësinë e emrit që mban. Por dhe ideja dhe dilema u shkërmoqën lehtësisht që në faqet e para. E gjeta veten të përpirë nga valët e një veprë letrare, që kërsërinë e fillimit ma kishin shndërruar në bindje. Vera Ibrahim ka shkruar një roman. Autorja endet në një retrospektivë të detyrueshme, duke ruajtur koherencën e rrëfimit, ndërsa ngjarjet ushqejnë njëra tjetrën, si në një lojë mozaiku, duke qëmtuar me kujdes copëzat e tij për të formuar të tërën. Jo më kot ajo ka përzgjedhur një titull që jo vetëm evokon veprën muzikore të një gjenit, si Feim Ibrahim, por edhe kohën në të cilën u krijua ajo. Duke qenë vikamë, thirrja nuk mbetet në dridhjen e një tingulli të vetëm, por as nuk shfaqet si bashkësi tingujsh. Sepse vepra shkon shumë më larg. Ajo është si një thirrje për të njohur njeriun bashkë me vlerat që mbartte, por dhe tallazet e egra, me të cilat ai u përball, në betejat për t’i mbrojtur ato. Sepse vlerat janë një pasuri e çmueshme, që nuk i përkasin vetëm kohës në të cilën u jetësuan. Në këtë kuptim “Vikama e Tingullit” del përtej kufirit vetjak. Në këtë kuptim, “Vikama e Tingullit”, kapërcen dhimbjen e bashkëshortes për humbjen e parakohshme të shokut të jetës. Të tronditin, domosdo, skenat ku ankthi përzihet me shpresën se “një mrekulli mund të ndodhë” dhe ata do të jenë përsëri bashkë edhe për shumë vite të tjera. Autorja nuk mund ta shmangë hidhërimin, që më vonë do të bëhet ngasja e fuqishme për të hedhur gjithçka në letër. Ama me mjeshtëri, ajo, nuk na le gjatë mes vuajtjeve të saj. Sepse ka ditur t’i “qepë” me maturi të gjitha etapat e lundrimit të përbashkët, me njeriun që i kishte blatur shpirtin dhe të cilit ajo i kishte falur veten. Këtë e ndien në çdo fjalë që Vera derdh në libër. Por ama dallon një

Një Vikamë Tingulli për Jetën, Dashurinë dhe Përjetësinë

PËR IKJEN SI NJË RIKTHIM

Raimonda Belli Gjençaj

dritë më shumë, kur në jetën e tyre hyn Etri, bija e tyre e vetme, që i dha ndjesi të reja kompozimit dhe dashurisë së çiftit. Deri atëbotë ia kishin dalë të ëndërronin edhe mes muresh të bodrumit ku jetonin. Por ëndrra me foshnjën e sapo ngjizur, ngrihej mbi përmasat e dhomës, që për adresë kishte “Pallatet e Shallvareve”. Duke shkruar, Vera Ibrahim nuk rreket të ndryshojë gjë. As të heqë e as të shtojë. I pandryshuar mbetet emocioni i saj edhe tashmë, pas kaq e kaq vjetësh...

- Feim, ti je? – m’u duk sikur fola. Nuk po njihja as zërin tim.

- Ej, Vera?! Ç’ke, ç’ke kështu? – dhe u sul drejt meje. Me perkedheli, por djerset me kishin shkruar deri ne rrenje te flokeve dhe u alarmua.

- Nuk jam mirë...më merren mendtë..., më përzihet..., mos u shqetëso..., do të më kalojë...! Kam frikë..., kam frikë se...jam shtatzënë...

Ai ngriu në vend për disa sekonda, pastaj:


- Oh, çfarë lajmi! Po ky është lajmi! Po kjo është një mrekulli! Vera, është një mrekulli!

Lexuesi hyn kështu në valën e gëzimit të çiftit që pret fëmijën. Duket si kontradiktore “frika” që shfaq gruaja. Por ajo ka të drejtë. Cila nënë do të donte ta rritte foshnjën e vet në një hapësirë bodrumi, pa dritë dhe plot igrasi? Vera ende nuk e di, por as lexuesi, jo, se torta dhe shishja në duart e të shoqit janë shtetësi për shtëpinë e re që po i pret. Etri po vjen këmbëmbarë...

Lexon dhe harron njohjen reale me njerëzit që frymojnë në libër. Pena e autores i sjell si personazhe të një rrëfimi, mirëfilltazi romanor. Të tillë shfaqen figurat e kompozitorëve, shkrimtarëve, poetëve, miqve, dashamirëve, brenda dhe jashtë atdheut, të atyre që e vlerësuan veprën e gjenit, por edhe të atyre që nuk ia dolën ta vrasin zilinë dhe tundimin për t’i vënë shkopinj nën rrota, fluturimit të muzikës së Feim Ibrahimit. Janë të gjithë aty, si dëshmi të pamohueshme të një miqësie të thellë me Njeriun, por edhe si forcë vitale e shpirtit të tij për të mos u përkulur ndaj padrejtësive. Kjo e dyta është një vlerë e spikatur për librin, por edhe për vetë autoren. Ndodh jo



rrallë, që njeriu, i lodhur prej betejave të jetës, zgjedh të mbajë pranë qetësinë shpirtërore, duke mos i cekur kujtimet që do t’ia cenonin atë. Por Vera Ibrahim dëshmon se është një prerje tjetër. Tregon që është një luftëtare e lindur, sepse ka zgjedhur t’i shkojë me guxim, deri në fund të vërtetave të jetës, që i përkasin jo vetëm kompozitorit. Ajo nuk mund ta “tradhtojë” atë. Ndaj autorja e sjell figurën e tij, në lartësitë e ngjitjes, por edhe me plagët e rrëzimeve, me një vërtetësi të tejskajshme, që trondit me përmbajtjen e saj, duke e zhbërë përfytyrimin mbi “jetën fjollë” të gjenit. Është turbulluese, por dhe mahnitëse, të mësosh se sa shumë e kanë luftuar dhe me sa fuqi mbinjerëzore i ka përballuar të gjithë dhe të gjitha. Është si një mësim i vyer për këdo që rreket jo vetëm të mos i humbasë vlerat, por t’ia dalë dhe t’i nxjerrë në dritë, pavarësisht se me kë dhe me çfarë i duhet të përballlet. Në këtë këndvështrim, Vera Ibrahimin e shohim edhe si një “guru” për lexuesit e librit, tek të cilët përcillen në heshtje jo vetëm përmasat e talentit të njeriut, të cilit ajo i qëndroi në krahe, deri në fund, por edhe mençuria dhe fisnikëria me të cilat ai përballoi sfidat e vështira, që jeta me shumicë, nuk ia kurseu. Krahas kësaj, lexuesi i ndien ditët dhe netët e artistit si nota muzikore, ku gjallojnë të gjitha veprat e tij. Që Vera Ibrahim i njeh si rrahjet e zemrës së saj. Kjo e bën librin të ndihet si një ndërthurje e natyrshme e fuqisë së ndjenjës me forcën e tingujve, që pasqyrohen edhe si burim e refleksë të vetë asaj. Ato rezonojnë nga faqja e parë, tek e fundit dhe lexuesi mjaft mirë mund të humbasë në sprovenë e tij për t’i matur. Sepse dashuria e guas është njësoar tashmë, me gjithçka që gjenialiteti i kompozitorit ka nxjerrë në dritë. Pavarësisht kësaj, gruaja e ka të pamundur ta fshehtë dhimbjen. As kur fjala e prek drejtpërdrejt, as kur e shohim si një stërpikje mes radhëve. Pengu i saj nuk është personal. Më shumë se kushdo tjetër, ajo e di se sa shumë kishte ende për të dhënë Feim Ibrahim. Por gruaja e di edhe se si do të donte ta shihte ai atë, kur fizikisht të mos ishin më bashkë. Ndaj pena që ka shkruar veprën “Vikama e Tingullit”, është ngjyer jo vetëm në dhimbje. Muzika është një balsam për plagët që hap humbja. Por muzika është magjia që të hedh në kohërat e krijimit dhe si e tillë, gjeneron gëzimin. Ndaj nuk është rastësi që në libër pulson e madhërisht dashuria, lajtmotiv që e përshkon dhe e shfaq ikjen e mbrame si një rikthim për të qëndruar përgjithmonë. Mbase edhe poeti i madh Xhevahir Spahiu këtë ka ndier, kur shkroi poezinë “Artisti”, kushtuar Gjenit Feim Ibrahim. Kështu i ndjeva dy vargje të saj: ...ti buzëqesh pa thënë asnjë fjalë, Tingujt i kthen nga fllad në rrebesh;



Zbres Kodrën e Panteonit, ku prehen mendjet më të mëdha të Francës, nga Alexandre Dumas, Marie Curie dhe marr përgjatë rrugën ku ndodhet Fakulteti Juridik i Sorbonne University, për të përfunduar në bulevardin "Saint Michel". Për herë të parë, shëtis në lagjen mitike latine të Parisit dhe më krijohet përshtypja sikur po marr në revistë statujat e mbretëreshave, duke mos shkëmbyer asnjë përsëritje, jo vetëm me ato, por as me "mbretëreshën e tyre" franko-italiane Marie de` Medici, krijuesen e kopshtit me emrin "Jardin du Luxembourg". Vej e vij në hapësirat e tij piktoreske, ku janë të vendosura lagjet e shkrimtarëve dhe artistëve me famë botërore që iu dhanë emër edhe kafeneve dhe më në fund, gjej "Eifelin tim", Kafe Rostand, studioja e punës e të madhit Kadare. Gjithçka ndodh bash në momentin kur dal nga njëra prej portave të kopshtit, me drejtim trotuarin përballë. Që kur kam lexuar "Mëngjese në Kafe Rostand", kam kureshtje deri në ëndërr të zbuloj e të vizitoj atë kënd si studio moderne, atë kafe misterioze, të mbushur jo vetëm me klientë realë, por sidomos me personazhe të krijuara nga kolosi i letrave shqipe. Janë më shumë këta të dytët që më joshin e më krijojnë atë ndjesi që di ta krijojë vetëm arti kadarean. Ajo botë, lindur nga fronti i brendshëm i kafenesë, ka dhënë, por sidomos për mua dhe lexuesit e planetit Kadare, jo vetëm famë, por edhe frymë, deri në pavdekësi. Ndërsa pres të shuhet ngjyra e kuqe e semaforit, dalloj një zinxhir të gjelbër shkronjash antike. Lexojnë "Le Rostand". Përnjëherë më shkrepi në tru rituali i dasmës në sokakët e Gjirokastrës. Sytë më kthehen në dy kërcimtarë, të mbetur të vetëm në sheshin "Saint Michel", duke u hedhur gëzueshëm në atë sini të mbushur me tabela me shkronja të alfabetit francez. Përnjëmend koka më ngjan si një tabaka mbushur me gota shkronjash, të prodhuara mjeshtërisht nga dora e Kadaresë dhe unë ndiej që bebëzat dredhin shtatin brenda zgavrës së tyre në një kërcim të çuditshëm. Ja ku është! Pesë metra larg meje. Ndodhem midis hyrjes së kopshtit, ku fillon dhe mbaron një ngushticë trotuari. Përballë shfaqen vija të bardha që të drejtojnë te godina e cila, si byzylyk, mban zinxhirin e gjelbër të shkronjave antike. Po përjetoj sikur kam në krah Patrick Modiano-n. Nuk e kuptoj pse po përipiqem ta ndihmoj që ai të kalojë atë vijë fatale trotuari, pikërisht unë, sot, në këtë prag pranvere 2024. Nuk po kuptoj ende çfarë ka ngjarë dhe çfarë e mban atë të bllokuar, të mos e harxhojë ftesë-propozimin për një kafe në "Le Rostand" me Kadarenë. Dua ta ndihmoj të kapërcejë për herë të parë, që nga viti 2011, atë brez vijash të bardha, të dalë pastaj në trotuarin përballë e të ulet atje, në atë kthinë, ku imzot

NJË KAFE NË "LE ROSTAND"

Nga Arben Velo

Kadare vijon ta presë për një kafe, pse jo deri në vitin e largët 2036. Dua ta ndihmoj që kjo të ndodhë sot, në fillimpranverën e vitit 2024 dhe të jem unë një nga dëshmitarët e rrallë, në mos i vetmi, i këtij takimi, si një shkes prej Shqipërie. Si shpërblim, nuk dua këpucët që merr kështu një mbles, por dua të më rrëfejnë të dy për kafenetë e Parisit. Ia tregoj këtë përfytyrim Idës, bashkëshortes.

Ajo vë buzën në gaz dhe hedh vështrimin në anën tjetër të rrugës. (Pak çaste më vonë, është ajo që pyet kamerierët e "Le Rostand" për tavolinën-studio të Kadaresë, fillimisht në anglisht dhe më pas në një përpjekje për të ngjallur e për t'i dhënë jetë frëngjishtes së saj.) Përipiqemi së bashku të shkrepim disa selfie me celular dhe nga padurimi, më duket sikur i jap urdhër të më shkrepë disa foto, ku unë të jem i vetëm, përballë kafenesë. Hedh kokën anash me frikën se kam humbur vegimin e Modiano-s. Por ai qëndron ende aty.

"Z. Modiano, ju kujtohet Kadareja?"

"Excusez-moi, à qui je parle?" - më duket sikur më pyet ai.

"Jam një shëtitës shqiptar në Paris".

"Oh oui bien sûr", - më kthen përgjigje të dyfishtë, duke buzëqeshur. Nuk do që të përballet me askënd, as të përsëndetet dhe të harxhojë kohën e vet, veç të marrit me letërsi. Le më pastaj të komunikojë me një të panjohur si unë i cili, jo vetëm nuk di frëngjisht, por për herë të parë sheh Parisin. Jam duke pritur përgjigjen kur befas shoh atë të kthehet drejt hyrjes së Kopshtit të Luksemburgut, shpejton hapat, kapërcen livadhin e barit, nën hijen prej rreshtim ushtarësh të pemëve në brendësi, pastaj ngadalë treset duke shkruar në Montparnasse, në rrugën "Fleuris" nr. 27. Është mesditë, fillim pranvere 2024. Edhe sot ai, pavarësisht dëshirës time, nuk shkoi në "Le Rostand".

"Oh oui bien sûr!" - më tingëllon vazhdimisht në vesh. - "Oh oui bien sûr!"

Bëhem gati për një telefonatë. Një turmë njerëzish që kalon mbi vijat e bardha sikur kalon përmbi mua. I nis disa foto në WhatsApp Bujar Hudhrit. Pas pak bie zilja e telefonit.

"Ku është tavolina e Kadaresë në 'Le

Rostand'?" - e pyes shpejt e shpejt

"Sapo hyn nga një deriçkë e vogël, është një kënd në krah të djathtë. Ngjitur me dritaren. Nuk bie shumë në sy. Aty ndodhet, - përgjigjet Bujari, - por mos harro të pyesësh kamerierin", përfundon bisedën ai.

Mbyll telefonin. Në hyrjen e jashtme të kafenesë, radhitur në pritje të klientëve, qëndrojnë tavolinat. Kureshtja më shoqëron hap pas hapi. Dy klientë dalin nxitimthi nga dera në momentin kur unë dua të hyj. Nuk di pse më ngajnë si dy personazhe ende të paskalitur mirë prej penës së Kadaresë, që edhe vetë s'e dinë pse duan të arratisen.

"Të marrë! O ju jeni të marrë që ikni kështu, nëse jeni lindur për t'u bërë personazhe prej tij!" - sa nuk thirra me zë! - "Ju mund të ikni, maskuar dhe veshur me fraza, imtësi, ngarkuar me rituale e përsiatje, shqetësime e biseda, heshtje e drama, emra groteskë perandorësh, diktatorësh, fraza të ëmbla e të hidhura femrash e të dashurash, por nuk mundeni të merrni me vete bërthamat e librave të ardhshëm, mbështjellë me mëshikëzën e ajrit që avullon nga ekspresi i kafesë. Nga ato bërthamëza, krijuar nga mollëzat e gishtërinjve të gjenit tonë, do të çelin çdo fund dite të tjera shkrime, libra, veshur me aromën e çokolllatave, kroasanëve dhe me sqimë përsëritjesh fine franceze: "Bonjour Chérie!" "Bonjour mon amour!"

Ky është përfytyrimi im. Në të vërtetë, ata të dy janë dy klientë të zakonshëm, të veshur çuditshëm të cilët, pasi kanë shijuar kafënë e shoqëruar me ëmbëlsira, nxitojnë të kapin metronë që ndodhet disa qindra metra prej aty.

Sërish i imagjinoj si personazhe, teksa kalojnë rrethrotullimin e sheshit "Saint Michel", që më ngjan si një sini gjirokastrite (tashmë e kuptova sekretin pse mes qindra kafeneve Kadareja ka zgjedhur "Le Rostand". Panteoni, Saint Michel, Gjirokastra) e nga xhepat e tyre fillojnë të derdhen shkronja, rreshta, që kthehen si në letërsi në dhjetëra trolejbusë, autobusë, që kalojnë me galop përmbi kopshtit me luks e burg nga pas, e pasi ngjiten drejt kodrës, shkroftëjnë përballë memorialëve e nderojnë shkrimtarët që

prehen në Panteon. Një duhmë ajri e mbushur me zhurma të lehta bashkëtingëlloresh e zanoresh, krijuar sa nga aroma e eksprisit dhe e parfumeve, aq edhe nga oinat fonetike hundore franceze, të klientëve të shumtë, të pranishëm, sapo hap derën, hyn në flegërzat e hundës dhe më sjell në vete.

Më pret një kameriere e hijshme, e cila pyet me një frëngjishte të këndshme. (Më krijohet një bindje që çdo kameriere e bukur patjetër që flet bukur dhe këndshëm.)

"Ils recherchent M. Kadare!"

"Zotin Kadare? A nuk ju... thua se ne nuk e dimë vendin se ku ndodhet duke shkruar?" - pyetpërgjigjet një banakier. Nga brendësia e kafenesë pastaj bën ballë kryekamerieri. Kam dëshirë të vë një lloj basti me veten time. A do të mundem të arrij të zbuloj atë vendin, studion tjetër, ku punon aktualisht Kadareja?

"Urdhëroni! Ju jeni nga...?"

M'u duk sikur më uron dhe njëherazi më pyet, me një gjuhë flake që rri ndezur në sytë e atij burri.

"Jemi nga Shqipëria, nga vendlindja e Kadaresë", - më përmend bashkëshortja.

"Oh, sa bukur!" - thotë i ngazëllyer. "Ah sa shumë që na mungon Kadareja!" - përsërit, duke drejtuar dorën nga tavolina-studio e shkrimtarit tonë të shquar.

Vërtet? Të jetë e vërtetë? Tani, oh, po, po, më së fundmi po gjej atë strehë të mbuluar me mister, kthinën, studion më të çuditshme në botë, ngritur brenda një kafeneje. Shoh një karrige të thjeshtë, një tavolinë të rumbullakët si planeti tokë, aty ku kolosi i letrave ka ndjellë, lëmuar, zbutur, butësisht e gjuhësisht, shkronjat e gjuhës shqipe, për t'i dhënë botës perla artistike. Dua ta ndiej atë tavolinë, të ulem, por aty qëndron një grua e moshës së tretë (dalohet që është një shkrimtare, teksa përipiqet të qetësojë me mollëzat e gishtave një stilolaps tejet të nervozuar me letrat e bardha). Ta marr inat? Pse? Joooo! Me atë kthinë, me atë qoshëz, që rrok e mban mbi shpinë të saj universe, mijëra vjet histori dhe letërsi, po çmallem, sikur të kemi shekuj pa u parë dhe pa u takuar.

"Na mungon shumë Kadareja! Ka kohë që nuk është dukur këtej" - pëshpërit kryekamerieri.

M'u duk shumë i afërt teksa përmend këtë emër...

Sytë e kamerierit janë të thellë, me një ndriçim të pafund. Më shoqëron të ulem në tavolinën përmbi. Para meje ndodhet ajo karrige ku dikur është ulur Kadareja. Ulësja është e zbkuruar me ngjyrat e tokës, e kaftë e çelur, me tri brazda jeshile. Mbi karrige tani qëndron një grua e panjohur. Ndërsa mbi tavolinën e rumbullakët rrinë të hapura disa letra që duket sikur s'kanë lidhje me njëra-tjetrën.



Ka një humanizëm në artin dhe letërsinë postmoderne, që përmes asaj që njihet si Pastich, e që është performatorizim i një modeli të letërsisë, rikthen dhe e bën të gjallë modelin, stilin, apo letërsinë e shkrimtarit të cilit i qaset.

Eric Faye njohës shumë i njohur i letërsisë së Kadarese, në romanin e tij "Parij" arrin të performojë letërsinë Kadareane me mjaft besueshmëri, përmes disa prej karakteristikave më të thella të njohura të saj. Në të vërtetë Faye ka zgjedhur të luajë në letërsinë e tij karakterin e psikologjisë (Shekspiriane) të letërsisë së Kadarese; gjithashtu në këtë roman zhvillohet me shumë sukses edhe grotesku Kadarean (ndërsa Kadare është i njohur për këtë si influencë nga Kafka dhe shkrimtari rus Gogol); dhe aq më shumë Eric Faye është tejet i suksesshëm në ndërtimin e trillit të drithërimës politike, të skenarëve dhe të dramave të politikave të larta në të cilat Kadare ishte unik dhe tejet i arrirë. Dhe aq më shumë të Kafkianës së individit të marrë nga absurdi i tiranisë së pushteti shumë të njohur në letërsinë Kadareane.

Ngjarja në romanin e Faye zhvillohet në një Paris "rus" që njihet si Parij. Po ky Parij është i ndarë nga një mur i njëjtë si gjatë kohës së ashtuquajtur Perdja e Hekurt të vetë qytetit të Berlinit, ndërmjet anës së demokracisë dhe të tiranisë komuniste. Gjë që është një ide unike dhe tejet interesante e këtij autori. Në të vërtetë kjo zhvendosje shpjgohet në hyrjen e veprës së Faye nga vetë autori si ide mbi zhvendosjen, ndryshimin dhe krijimin e një historie imagjinare, të cilën ai e shpjegon si - ukroni, që do të thotë imagjinatë mbi atë se si do të mund të ishte një shoqëri!

Kjo zhvendosje në të vërtetë, edhe pse nuk është e ndërrijshme, na shfaq në një dritë të dukshme dhe lehtë të pranueshme por edhe të paimagjinueshme për Perëndimorët e Evropës, tërë atë që ka ndodhur në këtë kohë të Perdes së Hekurt të civilizimit. Në të vërtetë me zhvendosjen e këtij kufiri, ne që nuk e jetuam Shqipërinë e tiranisë komuniste, as Berlinin dhe Bashkimin Sovjetik, dhe të kësaj hapësire, ne sikur e ndiejmë më reale dhe më afër lëkurës dhe frymës sonë këtë çnjerëzi. Gjë që do të thotë se kalimi i një tiranie në një reale të imagjinuar, në të vërtetë e bën shumë më të vërtetë vetë këtë tirani për atë që nuk e ka përjetuar të njëjtën.

Më tutje ky roman i autorit Faye është një "Dr Jekyll dhe Mr Hyde" i Stevenson sipas bashkëkohësisë sonë, apo një ritual i përhershëm, ndërmjet shkrimtarit/personazhit të quajtur Morvan, i cili është i ndërtuar në bazë të ritualit të raportit - të shkrimtarit të madh brenda këtyre tiranive siç ishin Boris Paternak me Stalinin e Bashkimin Sovjetik, dhe të Ismail Kadarese me Hoxhën e Shqipërisë Komuniste - dhe të hijes së tyre, Sigurimit shtetëror, e që këtu është personifikuar në një agjent të emëruar në këtë roman si Nervin.

Ngjarja e romanit është një lojë e përndjekjes së agjentit Nervin të çdo të bëre dhe çdo hapi e edhe të korrespondencës shkrimtarit Morvan, ku i tërë sistemi tiranik dhe i diktaturës është i vënë në alarm për të kapur tërë atë që shkruan po ky shkrimtar, e sidomos atë që nuk e ka të botuar. Në të vërtetë këtu fillon dhe tërë ngjarja e romanit ndërsa agjenti Nervin e kap një korrespondencë të shkrimtarit, dhe me këtë për vite të tëra e përcjell Morvan shkrimtarin, duke qenë se është një prej rreziqeve më të mëdha të këtij sistemi duke qenë se ky shkrimtar me pushtetin e tij global artistik dhe autorial që e ka mund të zbulojë tërë atë që në të vërtetë është publike dhe e publikuar në përmasa ditore!

Mirëpo kjo përndjekje në romanin "Parij", duke performuar tërë kohën

Romani "Parij" – Eric Faye, Botoi BUZUKU

RITUALI I LUFTËS SHKRIMTAR - TIRANI

Nga Ballsor Hoxha

karakteristikat e letërsisë Kadareane brenda tij, gjatë depërtimit tejet të thellë psikologjik të të ligës që e përfshin deri në palcë agjentin Nervin, të cilit i është caktuar të zbulojë çdo gjë që ka të bëjë me shkrimtarin Morvan, e posaçërisht me veprat e tij të pabotuara, ka një krijim tejet interesant të Faye, ndërsa po i njëjti agjent i diktaturës "Lindore" kalon kufirin e personit të tij në një të depersonalizuar, aq më shumë në skizofreni. Me kalimin e kohës, agjenti Nervin fillon të xhelozojë shkrimtarin dhe korrespondencën e tij me një grua tejet të bukur (megjithëse vetë është një person aseksual në këtë aspekt). Sa më shumë që përfshihet agjenti i sigurimit ai aq më shumë vuan jetën e shkrimtarit të cilin e kërcënon vetë ai, dhe aq më shumë fillon ta dojë jetën e tij, dhe në fund edhe të ndihmojë në procesin e ruajtjes së veprës së shkrimtarit Morvan.

Në anën tjetër, shfaqet një groteskë gjigante në artin e saj dhe aq më shumë në përmasën e saj, megjithëse jo dhe aq thellë e ndërtuar apo përcjellë gjatë

narrativit, meqenëse narrativi orientohet diku tjetër. Fjala është që lumit Sena të Parij të Faye, këtij që jeton i ndarë po sikur Berlinit i Perdes së Hekurt, t'i ndryshohet kahja dhe me këtë që, gjithnjë sipas Numrit Një, Stalinin të këtij Parij, të merret tërë qyteti nën pushtetin e po të njëjtë. Aq më shumë dërgohen punëtorë të mjerë, mblidhen qytetarët e pjesës lindore, dhe në anën tjetër kemi qytetarët e pjesës perëndimore të cilët vëzhgojnë si çudi të radhës po këtë fenomen. Në të vërtetë, autori e komplekson këtë groteskë gjigante duke e ndërthurur atë me përpjekjen dhe qëllimin e pushtetit e që është ndërtimi i një mauzoleu të varrezës së Numrit Një të Parij lindor.

Autori me mjeshtëri krijon deziluzionimin e të gjithëve, prej pushtetit, e deri tek lexuesi, kur me gjetjen e dorëshkrimit të shkrimtarit (që e quajtmë ritual i pushtetit me shkrimtarin kundërshtar të tij, si Pasternak dhe Kadare) së pari, shohim se po i njëjti ka shkruar në kodet e tij personale dhe ai është i



padeshifrueshëm. E më pastaj kur edhe muri ka rënë dhe njerëzit kanë filluar të jetojnë një jetë, për të cilën shkrimtari Morvan nuk është i bindur se është më e mira mundësi, kur edhe gjendet po i njëjti dorëshkrim në liri, kuptojmë në dialogun e shkrimtarit me ish-të dashurën e tij, se dorëshkrimi nuk ka qenë asnjë fshehtësi tjetër përpos përpjekje për të ruajtur dhe dëshmuar ndaj vetvetes njerëzinë personale përmes një dorëshkrimi të marrëdhënies që e ka pasur Morvan me këtë grua. E që në të vërtetë është dëshmi e jetës së tij personale, pra asaj që e ka bërë gjatë tiranisë së diktaturës.

Romani postmodern i Eric Faye "Parij" është një përpjekje shumë interesante e ngërthimit të karakterit të Boris Pasternak dhe të Ismail Kadarese, apo e zhvillimit dhe të hetimit të ritualit të pushtetit tiranik me shkrimtarin e njohur dhe kundërshtar të saj. Në të vërtetë pikërisht kjo e shfaq madhësinë, artin por edhe mallkimin e një shkrimtari siç është Kadare, të jetosh nën një tirani e të mos i bindesh po të njëjtës, të krijosh një art kundër kësaj tiranie dhe aq më shumë ta shfaqësh si bishë që është, dhe po ashtu, ta jetosh këtë tirani nën mallkimin e pamundësisë së arritjes së plotë dhe të menduar të shkrimtarit ndaj një pjese të madhe të globit e cila as nuk mund ta imagjinojë këtë mënyrë letërsie dhe arti dhe mallkimi.

Këtu dhe shfaqet humanizmi dhe arti i Faye kur ai e zhvendos po të njëjtën në një skenë të njohur për këtë pjesë të globit të papërfshirë dhe të papërvojë në këtë lloj tiranie. Andaj, duke iu kthyer kësaj zhvendosjeje, dhe aq më shumë projektimit të kësaj tragjedie globale dhe të këtij mallkimi të gjatë, shumë të gjatë në një pjesë të madhe të njerëzimit, shfaqet dhe në të njëjtën kohë zbulohet si tirania e diktaturës Staliniste dhe e Hoxhës, por edhe tirania e lirisë së jetës e cila jetohej në Perëndim ndërsa tiranohej një pjesë e madhe e Evropës, së paku.

Në këtë postmodernizëm të Eric Faye si autor i "Parij" të robëruar nga tirania komuniste, ai dialogon me veprat kryesore të këtyre shkrimtarëve. Aq më shumë e shohim Kadarenë në arkivat e shtetit të Shqipërisë komuniste, duke hetuar dialogët e të "mëdhenjve" të Shqipërisë komuniste gjatë shkëputjes nga Traktati i Varshavës, gjegjësisht armiqësisimit me Bashkimin Sovjetik. Aq më shumë këtu, në të njëjtën skenë ndodh dhe një dialog i shkrimtarit (ritual i raportit tirani-shkrimtar) me vetë Hoxhën. Në këtë e shohim Kadarenë, në personazhin e Morvanit duke u munduar jo aq shumë për jetën e tij sa për pasionin e letërsisë së tij, jo që nuk është në rrezik, por aq më shumë është në rrezik të tërë në shkrimtar të oborrit të tiranisë së Hoxhës. Në të vërtetë në një pjesë të madhe të monologëve të tij ne e shohim atë gjithnjë duke u përpjekur që të ruajë më parë nderin e më pastaj edhe rrezikun që i kanoset në çdo hap të tij. Por këtë herë nën mjeshtërinë postmoderne të Faye në romanin e tij. Këtë herë nga një palë sy prej jashtë këtij ferri dhe humnere të tiranisë komuniste që përjetuan të gjithë këta njerëz e posaçërisht këta shkrimtarë.

ÉRIC FAYE
ROMAN
PARIJ



Përktheu nga frëngjishtja
BLERTA HYSKA

BUZUKU

Në ekranin e televizorit u shfaq numërimi mbrapsht, me solemnitetin, me logon dhe muzikën që ftonte në fillimin e aktivitetit. Nuk kisha menduar se pjesëmarrja virtuale në Maratonën Muzikore do ish kaq emocionuese. Gjithmonë mendoja se artet pamore, ekspozitat, ofronin avantazhin e madh të shijimit të momenteve të promovimit dhe ekspozimit nga krijuesit, madje emocionet në të tilla evente ku performanca nuk kish varësi nga çasti i interpretimit më ishin dukur absurde! E mësuar me rëndësinë e faktorit kohë, që i bën interpretimet muzikore të ndryshme midis tyre, emocionet e krijuesve të arteve të tjera më dukeshin të tepërta. Ky konkluzion i interpretimeve në vite u rrëzua befasisht nga kjo pjesëmarrje në festivalin e Hartfordit (Women Composers Festival), një festival 23 vjeçar që i kushtohet, studimit, përzgjedhjes, vënies në skenë të krijmtarisë së femrave në muzikë anembanë globit, gjatë historisë e deri në kohën e sotme. Me imagjinatë u zhvendosa në sallën e Universitetit Shtetëror të Connecticut-it ku po shfaqej Simpoziumi shkollor dhe Maratona Muzikore, ndërsa koha që kalonte deri në paraqitjen si krijuese dhe interpretoese e "4 Capriccio-ve për violinë solo", po dukej më e gjatë se ajo pritja pas kuintave të skenës, apo krahasuar me periudhën tre mujore të përzgjedhjes që nga momenti i aplikimit e derisa u bëra pjesë e festivalit. Paraqitja virtuale dhe prezenca fizike në Tiranë, mungesa e hapësirave apo vizitave në qytetin e vjetër të Hartfordit me të shkuar historike, takimet, kontaktet, vizitat, fotot në qytetin e artit me muzeun më të vjetër pamor, shtëpinë e Mark Twanit të madh, më fokusuan te Shqipëria, në një krahasim të pashmangshëm me atë që ndodh me muzikën serioze. Kjo çështje që përfshinte krijmtarinë muzikore ish shndërruar si një referen, me ide që përsëriteshin e pas tyre shfaqeshin tok me të tjera mendime, konstatime deri në atë konkluzion të çuditshëm që nuk e kisha menduar asnjëherë më parë, se numri i kompozitoreve femra në Shqipëri ishte thujtë i barabartë me numrin e notave të muzikës!!! Si një refren kënge konstatimet duheshin shprehur, shkruar, komentuar, përsëritur, derisa kjo "melodi" e panoramës së krijmtarisë muzikore të dëgjohej, të tërhiqte vëmendje, e në pamundësi reagimi të ekzistonte e shkruar. Dikur, kontaktet si instrumentiste me botën përtej Shqipërisë transmetonin të tjera mendësi interpretimi, apo bashkë me aktivitetin, konkursin, koncertin, shërbenin për interpretime premiera të veprave të panjohura në skenën shqiptare, Festivali i femrave kompozitore të Hartfordit në USA, në këtë fillim marsi, muajt historik të përkujtimin të kontributit femëror kudo, shpaloste ide, platforma, mendësi dhe konstatime që nuk i kisha menduar më parë. Prezenca fizike në Shqipëri sikur më fokusonte në këtë botë shqiptare, e cila jo vetëm nuk njihet festivale të tilla të krijmtarisë së kompozitoreve femra, jo vetëm nuk njihet metoda të përzgjedhjeve tejet profesionale e transparente për promovimin dhe vënien në skenë të veprave muzikore, apo fenomenin krijues dhe interpretues (performer- composer), po dukej se çdo ditë po tkurte dhe mendimet për krijmtarinë muzikore serioze. Debatohet, diskutohet për letërsinë, për dramën, për artet pamore, ndërsa krijmtaria muzikore serioze me shaka duket apo ngjan me ato batutat e diktatuarës, ose shprehjet e tipit "me kleçkë në biografi". E vetmja "kleçkë" ishte mosnjohja, pamundësia për të



Mbresa nga Women Composers Festival në Hartford

Rruga e mundimshme e grave kompozitore

Nga Ina Kosturi

kuptuar një gjuhë tjetër, indiferenca e medias dhe ajo që ish më e keqja një ngatërresë gati vrastare e krijmtarisë me interpretimin, e performancës me krijimin. Tok me shkrimtarin qëndronte performuesi, ashtu si në gjininë më të thjeshtë muzikore, tek kënga, ku atributet e suksesit i merr thujtë tërësisht këngëtarit. Në muzikën serioze, apo "klasike" nëse e specifikojmë për një publik të gjerë, notat muzikore përfaqësojnë krijmtarinë, kompozitori është shkrimtar, poet, piktor, skulptor. Interpretuesi i jep jetë, e lartëson, e shfaq krijmtarinë muzikore. Është një marrëdhënie krijues-interpretues, që tek ne thujtë e ka eliminuar rolin e më të rëndësishmit, krijuesit, kompozitorit. Krijmtaria muzikore apo format e mëdha erdhën vonë në muzikën shqiptare, gati me detyrimin e aktiviteteve të programuara, ndërsa hapja me botën pas viteve 1990, sukseset dhe inkuadrimi i instrumentistëve jashtë vendit krijuan mendësinë se muzika shqiptare është tejet e suksesshme. Siç ngatërrohet në Shqipëri roli i solistit instrumentist me orkestrantin, ashtu dhe krijmtaria muzikore, krijimi u mbështoll me suksesin e performancës. Interpretuesi i mirë luan veprat muzikore, nuk ka kombësi dhe i tillë mund të bëhet gjithkush me talent, aftësi dhe shkollë. Kompozitori mbetet deri diku ashtu si shkrimtari si pjesë e klasifikimit në biblioteka, me emrin e shtetit të cilit i përket. Nëse performuesi ka identitet gati të pacaktuar, (nëse mund të shprehemi kështu) se

kornizon veprat muzikore, i vë në skenë, kompozitori është unik, ai është përçues i mendësive, formimit, ai jo vetëm krijon, ai përçon dhe përfaqëson muzikën e një vendi me karakteristikat, veçoritë. Nëse performuesi vesh kostumin e kompozitorit, veprën e të cilit interpreton, kompozitori mbulohet me kostumin e vendit të tij prej nga frymëzohet, me tiparet që edhe pse të padukshme kanë ritmet, frymëzimin, vallen, intonacionet e të parëve. Kompozitorët i gjen rrallë në media, në panele, në debate, analiza për problemet reale që ka krijmtaria muzikore sot. Pjesa më e madhe e aktiviteteve që nxisin krijmtarinë mbartin mentalitetin e një vendi të vogël, ose realizohen për studentë, ose janë shumë të specifikuara, shpesh dhe më përfundime të pasuksesshme, ose mbyllën me ankesa të pjesëmarrësve. Krijmtaria muzikore është po aq e rëndësishme sa gjithë llojet e tjera të artit, ajo identifikon, përfaqëson, është autentike dhe me vlerë. Në këtë harrim për mungesë politikash në gati tre dekada, bashkuar dhe me domosdoshmërinë e digjitalizimit të krijmtarisë muzikore, krijuesve nuk u mbetet tjetër vetëm reklamimi me forcë i sukseseve apo vënies të pjesëve jashtë Shqipërisë. Si një refren i përsëritur me shprehjen "C thotë bota "duk se armata e kompozitorëve tek ne është një forcë që besohet pak. Duhet patjetër konfirmimi për interpretimin jashtë vendit të veprave, që ato të mund të marrin fare pak vëmendje, shpesh dhe aspak, edhe pse mund të jenë

vërtet të niveleve të larta. Tok me këtë indiferentizëm, e gati një lloj shmangieje brenda Shqipërisë edhe për vepra vërtet të mira lind një tjetër pyetje. Kemi një tjetër realitet përtej atij që shpalosin individualisht kompozitorët me veniet e veprave në skenat jashtë Shqipërisë. Përtej rasteve të mbështetjes së shqiptareve që gjenden ngado në botë si interpretues e kryesisht të punësuar në orkestra, cili teatër europian apo dhe më gjerë ka vendosur në programin e koncerteve një vepër të madhe, ndoshta një simfoni po dhe koncert instrumental apo gjini të tjera muzikore? Nëse në orkestrat më të mira apo dhe kudo në botë gjenden muzikantë shqiptarë të inkuadruar tashmë, krijmtaria muzikore apo suksesi i saj jashtë vendit mbetet i inkuadruar apo përkrahur nga shqiptarë, pa mundur të depërtojë në sfera të larta. Situata e krijmtarisë muzikore brenda vendit në tre dekada, mbyllja e dyerve apo fakti se kompozitorët mundohen pafundësisht për të vënë krijmtarinë në skenë, ka vështirësuar pikërisht dhe këtë qasje me botën jashtë. Kjo tablo është më e rëndësishme se çdo intervistë, sukses herë i vërtetë, e herë imagjinar që serviret në lajmet kulturore të medias shqiptare. Institucionet e rëndësishme duhet të jenë iniciatorë të stimulimit dhe vënies në skenë të krijmtarisë shqiptare, jo për të plotësuar një kuotë apo në nivele miqësish, kjo situatë është emergjencë dhe kërkon politika e projekte afatgjata edhe pse të vështira për kohën që jetojmë sot. Nëse kthehemi në festivalin e Hartfordit, apo dhe shumë festivale që promovojnë muzikën e femrave kompozitore, krahasimi me Shqipërinë bëhet akoma më i vështirë. Rruga e krijmtarisë së femratve në art gjatë gjithë historisë ka qënë e mundimshme, edhe sot mbetet më e vështira midis profesioneve të tjera në muzikë. Femrat dirigjente po bëhen dalëngadalë pjesë e skenave më të rëndësishme botërore. Festivalët që përkrahin krijmtarinë e femrave kompozitore në Amerikë, Kanada, Zvicër e vende të tjera, studimi dhe përkrahja nëpërmjet interpretimit, botimit, konfirmojnë vështirësinë e vënies në skenë të kësaj krijmtarie. Festivali më kish detyruar të bëja një kërkim mes emrave të njohur dhe konstatimi se numri i kompozitoreve femra në gjithë historinë e Shqipërisë është thujtë i barabartë me numrin e notave muzikore është gati shokues. I tillë është dhe fakti se kjo krijmtari është inekzistente në skenat e institucioneve të rëndësishme kombëtare të artit tek ne. Edhe këtu interpretueset ngatërrohen me krijueset dhe prezenca femërore në performanca mbulon këtë mungesë gati të frikshme të krijmtarisë serioze. Si refreni i një kënge që përsëritet kjo mungesë së pari duhet të evidentohet e konstatohet. Krijmtaria muzikore nuk realizohet as si fushatë e as si detyrim, që bëhet me aksion. Cdo përpjekje shtreson në një kohë të gjatë, gati padukshëm. Krijmtaria muzikore është frymëzim dhe si e tillë nuk mund të komandohet. Politikat e përkrahjes së talentit, evidentimit që fëmijë, nxitjes së improvizimit e krijimit, organizimi i konkurseve për instrumentistë e krijues të vegjël, aktivitetet kombëtare të krijmtarisë, politika afatgjata dhe vlerësimi i kësaj kauze si pjesë e identitetit tonë do ndikonin në ndryshimin e kësaj situatë në të ardhmen. Një klimë dashurie midis krijuesve në të mirë të muzikës shqiptare do ish dhe melodia e vyer që kërkon e sotmja dhe e ardhmja.

OBORRI I KUMBULLËS

Me të lënë pas krahësh zhurmërimën e Pazarit të Ri, në të hyrë të rrugës "Hoxha Tahsim", në krahun e majtë të saj, ndodhet rrugica "Jani Vreto". Ajo ka formën e një U-je, ku njana brinjë kurbëzohet lehtas e mbaron pikërisht në derën e oborrit të Kërçikve.

Dera e madhe përbëhet nga dy flatra, ku metali i ngjyer ka zënë vendin e drurit të ngrohtë të dikurshëm.

Oborri ka një formë të papërcaktuar e shtëpitë, me mure qerpiçi, katër gjithsej, janë të lyera në të bardhë. Përpara hyrjes së çdo njanës prej tyre, ndodhen tre shkallare të mbushuna nga të dyja anët me vazo me lule të stinës. Dyert e xhamta lejnë dritën të hyjë lirish. Pranë kovës së lidhur me çikrikun e pusit, kuqëlon një vazo me mullaga, që i bën shoqëri maces së shtëpisë, e cila shtriqet e dembelosun nën diell. Manushaqet kanë çelë në shtrojën e kaftë të dheut midis udhëzave dhe trëndafilat që zgjaten sipër tyne, kundrojnë gjithkënd me hijen e atij që e din kush është më i bukri i oborrit. Në krye të oborrit një kumbull e hershme lulëzon çdo vit. Ajo ka qenë mbjellë para shtëpisë së parë të Kërçikve, e cila nuk i shpëtoi furisë djegëse të Haxhi Qamilit. Ironia e fatit deshi që më vonë të ishte Sulejman Kërçiku, i cili pas kryerjes së shkollës ushtarake në Stamboll, nën funksionin e nënprefektit të Tiranës e të shefit të policisë, arrestoi Haxhi Qamilin në emër të qeverisë shqiptare së atëhershme.

Shtëpia e vjetër nuk është më, por kumbulla vazhdon të çelë në kujtim të saj.

Vizitori, nëse "ka ngut", gjen në të djathtë të oborrit banjon e bardhë me çesmën e ulët.

Ditëve të pazarit, oborri mbushej me thirrma katundarësh që zbrisnin me shit mallin e tyne në treg dhe gomerët i lejshin për disa orë në oborr, përkundrejt një shpërblimi të vogël. Kujdesi për me i dhanë ujë këtyne vizitorve me sy melankolikë, si dhe lopës së shtëpisë, i ishte ngarku Ditës. Në ato kohë uji nxirrej nga pusi e Dita shtatëvjeçare, dimër e verë, vesh me një fustan të hollë, i ndruhej etjes së lopës që pinte nga govata e drunit, teksa shikonte me sytë e saj të butë e mirënjohës vajzën me gërshetat e gjata deri në bel. Lopa kishte "dhome" e saj në fund të oborrit, në të djathtë. Më tej, ndodhej edhe gropa, ku hudheshin bajgat që me kalimin e kohës fermentoheshin e shndërroheshin në pleh shumë të kërkum.

Jo larg prej aty, në një kënd të shtrum me rrasa, ishte vendi ku një herë në javë ndizej zjarrmi për të la "lëveret". Mbi zjarrm, një pirusti e bame si prej duar titanësh mbante pa u dridh peshën e kazanit të madh, ku ziheshin çarçafët. Para se të futeshin në kazan, çarçafët shtroheshin një nga një në një arkë, në fundin e së cilës ishin hap disa bira. Mbi çdo njanin prej tyre shtrohej hi vatre dhe në fund u hidhej disa herë uji i përvlum, e liheshin me "u zbrujt".

Kazanin e soj-soj enësh të tjera bakri të punume me mjeshtëri i kishte sjellë nga Stambolli Musa beu, i ati i Sulejmanit.

Në një nga ato enë monumentale, më e moshumja nga gratë, nusja e Sulës, për ditë feste gatuate hallvën, për të cilën ishte e njoft që "e qante me lot". Në një tepsi bakri që shndriste, u vente hallva e bame në formë lulesh dhe komshijtë u ftojshin me shiju hallvën e nonës, duke e marrë me dorë!

Nona, gjyshja e mëmës sime, ishte e pashkollë dhe ishte ba shkak, midis të tjerash, për një "zullum" të madh në historinë e familjes. Kur turqit kishin

DANTELLA KUJTIMESH

tregim nga Gentiana Kone



ardhë me ba regjistrimet e para të popullsisë, djali i vetëm i Musa beut ndodhej në Stamboll. Kur nëpunësit e pyetën për mbiemrin, nona dha mbiemrin e saj vajzëror Kërçiku dhe jo mbiemrin e të shoqit që ishte Bargjinolli! Gurët e vorreve dëshmojnë që deri te Musa beu është mbiemni Bargjinolli e, më tej, fillon Kërçiku.

Mëma ime e dashun kujton me kënaqsi rrëfimet e kësaj gruaje, si dhe merakun e saj "për çunat që ja ka marrë menien një rruspi e quajtur Ollga, e cila ja hongri gjithë lekët". Me "çuna" u thërriste edhe nipave, të cilët përjavë merrshin kushërinat e tyne e shkojshin të gjithë bashkë tek "Vollga" për me kërcy. Provat më parë i bajshin në mesin e oborrit të shtrum e improvizum si pistë vallzimi. Sapo gjilpana e hollë prekte pllakën e gramafonit, nuk mbetej çun e gocë Kërçiksh pa vallzu. Me harenë, humorin e energjinë që rinia dhe rritja së bashku në një oborr të jep, harrojshin për disa orë gjithë çfarë jashtë derës ndodhte. Oborri kishte dy hyrje. Një të madhe tek rrugica "Jani Vreto" dhe një kapexhik në anën tjetër, që të nxirrte tek rrugica e jevgjëve. Nuk dihet kur disa familje jevgjish ishin vendos në atë rrugicë, por në sajë të tyne rrugica quhej e tillë. Ishin të pastër, vetëm se kishin një "sifat".

Për ditë pushimi dilshin me një stol të vogël e u ulshin para portës së tyne. Kija përballë Sabries, fillojshin me u sha me kuç e me maç me za të naltë. Ligjëratat e mallkimet vijshin nga kohë t'vjetra dhe zani i tyne merrte tonalitetin aktoresk që kërkonte kjo skenë e luajtur para gjithë komshinjve të dalë e ulun edhe ata ndër stola, duke ba sehir.

Kur u lodhshin, merrnin stolin e futeshin nëpër shtëpitë e tyne, për t'u nis natën së bashku me fshi rrugët e Tiranës.

Kur kolektivizimi i morri çdo gja fshatarëve, nuk ngeli më gja me u shit në treg e gomerët e lopa u zhdukën edhe ata. Dhoma e kësaj të fundit u shndërrua në një guzhinë të përkohshme, ku motra e vetme e katër vëllezerve Kërçiku, që kishte mbaru studimet në Vienë, gatuate pasi u kthy nga vite të gjata internimi. Ajo u vendos në një nga katër shtëpitë, bashkë

me dy fëmijët e saj të mitur, që kishin mbet pa të atin, të pushkatum pa gjyq për një bombë të hedhun në një ambasadë.

Nga katër vëllezërit, vetëm i madhi nuk kishte ikur jashtë shtetit. Njani prej tyne, arkitekti, mbeti fatmirësisht në Austri. Nji tjetër, doktor i nderum, e la Vienën e jetoi e punoi me shkul me rrënjë sëmundjet foshnjore dhe ngjitëse të lëkurës në mbarë Shqipërinë. Vdiq herët, vetëm disa muaj pas vdekjes së gruas së tij të dashur e, mbase, më mirë që ndodhi kështu, sepse nuk dihet ç'mund të kishte ndodhur, kur orteku i kuq u përplas sërish me zhurmërimë llahtarie.

I katërti, im gjysh, iku e u arratis në Amerikë, e në letrat e dërgume fshehtas porosiste tre bijat e tij të dashura që të lexojshin e të baheshin të dijshe, sepse vetëm "dija mund ta shpëtojë atë dhë dhe atë popull". Bibliotekën me gjithë numrat e "Hylli i Dritës", "Visaret e Kombit", e gjithë revistat shqiptare që ishin shtypur ndër vite në shtete të tjera, i kishte merak dhe lutej që t'ja ruajshin bashkë me librat e shumtë të literaturës botërore në anglisht e italisht.

Në fillim të viteve 70, kur hija e një zezone të re u rishfaq në llumin e filxhaneve të kafesë, mëma ime e dashur me dhimbje e ngashërim ndezi për herë të fundit zjarrin në oborr e dogji gjithë librat e të atit. Rreth zjarrit ajo e një nga kushërinjtë ndejtën bashkë të kap për dore, derisa ai u shua. Vetëm një libër rrëmbeu dora e kushërinut para se ta merrte zjarri, "Lahutën e Malcisë".

E fshehu, por kur erdhën pas disa muajsh me e arrestu, ja gjetën dhe me atë si provë e dënuan për 15 vjet, të cilat i kaloi në Burgun e Burrelit.

Natën që doli nga burgu, ishim mbledh të gjithë tek oborri me e prit. E kalum atë natë, duke e ndigju deri në ag. Kishte hy djallë i ri, jetim nga i ati dhe doli jetim edhe nga mëma, që u shujt pa e pa të lirë. Dhimbja për të shoqin në gropën e përbashkët pa emër dhe djalit të vetëm në burg, e mori para kohe motrën e vetme të katër vëllezërve.

Vitet kalojnë si yje që bien e lejnë pas tyne një fllorë rrëzëllitise kujtimesh.

Tashmë oborri është i paqte dhe

aroma e luleve sjell kujtimet e hershme.

Nuk ndihen më zëra fëmijësh, as zani i gramafonit, por kumbulla e bukur shpërndan petalet mbi rrasat e gurta e në çdo njanën prej tyne shoh fytyrat e dashuna.

Kam mall...

MANJOLA

Në një nga rrugët që kryqëzohen me Rrugën Mbretërore, pasi len mbrapa shtëpinë e Turdinjve, pa mbërritur tek shkolla "Fan Noli" në të djathtë ndodhej manjola më e vjetër e Tiranës. Nuk dihet kush e ka mbjellë atë pemë, por në fëmijërinë time një nga lojrat e preferuara ishte ajo ku u jepja emra të rinj disa prej rrugëve të Tiranës. Kështu, ajo rrugë që emrin ja kishin ndërruar shpesh, pa e pyetur, dhe në atë kohë mbante emrin "Qemal Stafa", nuk besoj të prekej nga emri i ri, që i vura unë, Rrugë e Manjolës!

Udhët e vjetra me emrat e butë, mbushur me nanuritje mjeshtërisht të ndryshme, si:

Rrugë e Rrobaqepsëve,

... e Hasrave,

... e Kripës,

... e Argjendarëve,

ishin fshirë me kohë, me dhunë, nga zemra e qytetit dhe pak nga pak harresa e fundme po binte edhe në kujtesën e banorëve të tij.

Aty ku sot ndodhet shkolla "Fan Noli", në katin përdhes të një shtëpie që prindërit e mi e kishin marë me qera, në një ditë të ëmbël tetori, sytë më bënë dritë mbi dhë. Mundet që të kisha pritur edhe pak për të ardhur në këtë jetë, nëse mëma ime e dashur nuk do të kishte ngritur e t'ja ndërronte vendin një lavamani të gurtë që ndodhej në dhomën e bukës. E papërtuar e me imagjinatë të pasur si uji, qenie që i vinte dore çdo gjë, ishte ngritur me natë për të bërë atë zhvendosje që guzhinën e bënte më praktike. U tha, u ba! Lavamani u vu në vendin e ri dhe menjëherë pas tij unë erdha në këtë botë me të qarat e një bebeje me mushkëri të shëndetshme dhe një tufë të dendur flokësh të ngritura përpjetë, një iriq i vërtetë!

Dyzet ditët e para i kalova në gjumë të thellë e netët duke qarë pa rreshtur. Këto të qara i dëgjoj pema e manjolës dhe zbuti petalet e saja në shenjë dhimbshurie, e gjetet i lëmoi në shenjë dashurie për flokët e mia të iriqta. Me aromën e saj më vinte në gjumin e ëndrrave të qumështa e me degët e rrethonte trupin tim në lojrat fëmimore. Fati e pruri më pas që të kisha një shoqe që quhej Manjola e ajo më dukej sikur ishte metamorfoza e manjolës së dikurshme që e prenë, sepse aroma e saj i jepte alergji kryetares së komitetit ekzekutiv, që banonte aty pranë.

Në katin përdhes të shtëpisë, më parë se ne, kishte banuar një jevg i quajtur Hasan, që punonte në fabrikën e tullave, ku edhe mëma ime punonte. Prindërit më parë banonin në një apartament të vogël, përtej Kinostudios dhe kishin bërë çmos të ndërronin shtëpi e të afroheshin më në qendër.

Një mik tiranas, plak nga familja e Derhemve, e kishte ndihmuar mëmën për të gjetur Hasanin. Ky i fundit që i lumtur të shkonte në apartamentin me dy dhoma e guzhinë që mëma e kishte bërë si nuse me tela dhe t'i linte prindërve të mi katin përdhes, ku dyshemeja ishte e pashtuar dhe muret të nxira nga tymi i zjarrit që Hasani e kishte zakon ta ndizte në mes të odës.

E lumtur me këtë shpërngulje, mëma ju vu punës e shtroi dyshemetë

me çimento, mbylli vrimat e çatisë aty ku rridhte dhe zbardhoi mure e tavane me gëlqere. Në oborrin e shtruar më së shumti me kalldrëm, zgjodhi një pjesë të pashtruar dhe e mbolli me lule nga ato që bukursonin çdo oborr tiranas. Lule solli edhe plaku i Derhemve, nga oborri i shtëpisë së tij që ishte larg sa të hidhje një kokërr molle. Një rastësi e bukur që një kumbull në mes të oborrit, që i ngjante asaj të oborrit të Kërçikve, derë e vjetër tiranase, nga e cila mëma vinte.

Disa hapa larg shtëpisë, në rrugën e Manjolës, ndodhej edhe një çerdhe e vendosur në një shtëpi të ndërtuar në kohë të Italisë. Shtëpia është edhe sot, por shërben si hotel dhe restorant. Hyra një ditë, ndërsa kaloja andej, dhe dyshemeja ishte po ajo, e parmaku i drunjatë përgjatë shkallës së mermertë, shndriste nga fërkimi i duarve gjatë viteve. Në heshtjen përqafuese, një fytyrë e qeshur mu shfaq, ajo e edukatores sime të parë dhe djalit të saj, që ishte më i rritur se unë dhe që ajo e mbante përherë pranë.

Çerdhja kishte një kopsht dhe kur dielli i butë i Tiranës, gicilonte degët e pemëve, ne të vegjlit na nxirrnin herë pas here në të. Aty miku im me palçeta, shpesh më jepte dorën, thjesht që të më ndihmonte për të ecur ose më hidhte petale lulesh mbi flokë e unë qeshja me shpirt.

Puhiza e ardhur nga Dajti sillte valë-valë edhe aromat nga Pazari i Ri. Aroma mollësh të sheqerosura, mollat e Gegës, mjaltit te përzim me arra nga Qaf Molla e aroma djathnash e bulmetnash, që sillnin katundarët nga Shën Gjergji. Në enë të mëdha balte ata mbanin edhe kosin që ishte si ta prisje me thikë!

Aromat kanë vetinë me hy të parat në kujtesë e aty mbesin, derisa të tjera aroma vinë e trokasin në dyert e mbyllyna e të harrueme prej vitesh.

Kështu kaluan vitet e para të feminisë time, pa ndonjë ngjarje me vlerë për t'u shënuar.

Një ditë tetori, erdhi lajmi që shtëpisë do i binte plani bashkë me shtëpitë e Derhemve dhe Këllicëve dhe në vend të tyre do ngrihej një shkollë, pallate e punishte. Zhdukja e Pazarit të vjetër dhe kishave e xhamijave që hijeshonin zemrën e qytetit, kishte ndodhur ndërkohë dhe rradha u kishte ardhur lagjeve me shtëpija e kopshtije.

Disa ditë para ditëlindjes sime, atin tim e transferuan në një fermë të humbur, përtej malit të Krujës, aty ku kishte edhe shumë familje të internuara.

Në të njëjtë kohë, mëmës i diagnostikuan turbekuloz në të dy mushkëritë dhe u shtrua me urgjencë në sanatorium në Korçë. Aty banonte edhe daja i saj që ishte një doktor i njohur.

Atë ditëlindje, deri në tjetrën e kalova në një jetimore të Korçës. Si blatim lashë flokët e mia të gjata në ngjyrë mjalti, të cilat m'i prenë sapo mbërrita, nga frika e parazitëve.

Nuk di nëse imazhi i një salle të madhe të mbushur me shtretër të vegjël metalikë, ka ekzistuar vërtet apo është fryt i mendjes sime feminare. Ajo që kujtoj është ndjesia e turpit sa herë zgjohesha në errësirë dhe ndjeja që kisha lagur sërish shtresat.

Shpejt, ndalova së kërkuari me sy mikun tim të femijrisë dhe aromat e dashura u zhdukën diku në thellësi.

Vetëm ajo e manjolës më të vjetër të Tiranës, herë-herë më vinte ndër ëndrra, si për të më kujtuar që dikur do të kthehesha në qytetin e bukur me kopshtije ku dikur paqja mbretëronte.

FYTYRA QË UNË SHOH

poezi nga Nurie Emrullai



HISTORI E DËGJUAR

Unë po vdes etjeje,
ngase nuk ka ujë
ku s'ka pirë hëna...

Thonë se poetët u helmuan,
ngase u munduan të pinë dritën e saj,
ngase u munduan të fshihnin marrëzinë.

Por, unë, tani, po vdes etjeje
për pak ujë me dritë hëne,
e veç njëherë çmendurinë ta mbërthej në
krahë.

Kurorë vdekjeje m'u bëftë dritë e saj!
Jeta ime n'sa faza duhet të shuhet,
që rishtazi të mbushet?

(Sipas Li Po-es
dhe Ezra Pound-it)

VRIMA E ZEZË

Zbrazëtira:
(midis fjalës që thua,
dhe asaj që pret të thuhet):
thithen të gjithë yjet,
pihet gjithë drita e hënës,
pëlcet dielli në galaktikën e vjetër...

Rruga e qumshtit ndodhet atje
ku shputat e femijëve të sapoformuar
rrëshqasin si në park të lojërave
e presin thithjen për në vrimën e zezë.

Retë bien prej qielli,
fillon festa e pizhamave në të gjithë
spitalet,
ku jastëkët janë mbushur me pambukun e
reve të rëna.

Dhe bie shiu në formë sherbeti dhe
i zbut të gjitha retë,
të cilat zvogëlohen e shkrihen mbi
pëllëmbë si pambuk sheqeri...

Dhe pacientët ndjehen femijë kur provojnë
se si goja e tyre shkrihet në një.

Vazhdojnë të gjitha të thithen në vrimën e
zezë, e cila merr macen me gjithë lisin ku
kruhet,
merr rrënjet e rrënjëve të cilat jetojnë mbi
eshtrat e të parëve...
"Boll më!" - thuaj diçka!

Ajo thotë:
"Të gjithë në këtë jetë e kanë një djegë..."
Dhe secilit në dhomën e botës fillojnë
t'i pikojnë nga një pikë djerse
që thithet në vrimën e zezë,
me të cilën formohet uji amoniak i
fetuseve që presin lindjen.

"Po, s'ke çfarë bën."
Dhe është ajo koha pra
midis fundit të fjalës
dhe fillimit të një tjetre,
është si të kapërcesh
nga një shekull në tjetrin të zgjohesh,
dhe buçet simfonia
ku në të njëjtën kohë luhet
kaosi me rendin
dhe era thithet që të thithë
gjethet - ngjallen, aty kalben, aty rriten
para syve të mi.

Bien zogjtë në tokë,
secili mban në qafë emrat tanë,
emrat e atyre që do të lindin.
Këtu brenda e nxe tërë botën,
këtu brenda nxe të gjithë luftrat,
Por, vrima e zezë
nuk thith tradhtarët,
nuk thith mëkatarët që mëkatuan me
jetë...

Ndaj do rrimë këtu
e do të vrasim mendjen...

Si mbyllet biseda ndryshe?
"Të gjithë e kanë një djegë të hapur në këtë
dhé."

LIQENI I DRITËS

Të shohim se si luhatesh midis dy qyteteve
ti ke zgjeruar shtatin,
ti je i të dyve,
dhe i askujt s'je,
përveç se i dritës që me miliona vite në
thellësi të vetes e ruan.

Liqeni i dritës
në natë të errët linde,
n'këtë tokë pa truall,
pa emër jetojmë të dy bashkë,
por të dy notojmë brenda vetes.
Unë thellësinë time
e mas në reflektimin e fytyrës
mbi valet që ma godasin ko(k)hën
liqen i dritës.

SA ZGJAT JETA?

Jeta s'është ma e gjatë se një ditë.
Brenda asaj dite lindim ditën tjetër.
Brenda asaj dite terrsojmë veten.

Jeta s'është ma gjatë se një ditë.
Përditë ne jemi
n'boshtin e vetvetes
dhe duhet të mbahemi n'të.

Veç ata që s'janë t'vërtetë në ditën e tyre
humben dhe jeta u duket e gjatë,
si përrallat të cilat nuk mbarojnë edhe pasi
të gjithë flejnë..

Jeta s'është ma e gjatë se një ditë,
e ajo ditë një shenjë në ballin e tokës lë.
Një gur.

FYTYRA QË UNË SHOH

Në pak fytyra që mbaj mend
gjithmonë imazhi i parë i tyre
më shfaqet nën hijen tënde,
Secilave prej tyre fillojnë
t'u bien kaçurrelat mbi fytyrë
dhe unë atëherë ua largoj prej syve
E shoh veç dy zgavra të një
"na ishte një moti-moti..."

Në pak fytyra që mbaj mend
gjithnjë n'kujtesën time
e qeshuna e tyne më vjen me buzëqeshjen
tënde (sa e ëmbël që qe!)
dhe kur afrohem për ta prekur
bahet greminë e një kohe që
m'tërheq në vetminë e saj.

Në pak fytyra që mbaj mend,
(oh, sa pak fytyra që mbaj mend!),
jeni ju duart e Adamit, që në një natë
kur Zoti na dha mendjen,
atëherë grisëm lëkurën
për të parë ç'fshihet nën të...
E kërkujmë dhe sot, sa larg Parajsës,
ku nuk njihemi, e nuk vihemi re.

EROS

Kur ti je afër meje
unë notoj nëpër qetësinë e ujërave
si lotus shpërthej mbi gjoksin tënd...

Si pilivesë notoj në cektësinë e ndjenjës
dhe mjaftohem me aq pak hapësirë...

Kur ti je afër meje dielli me rreshk ngadalë
si mjellmat kur nxjerrin kokën nga uji
e lajnë shpinën e njeri-tjetrit... zgjatem
drejt teje.

Por kur ti nuk je...

Unë mbetem Ofelia gjithnjë e pagjetur...

1.

Mbrëmë jemi kthyer vonë me Myrvetin nga Llixhat e Elbasanit, ndërsa sot po e nisi ditën duke parë thirrjet dhe mesazhet në telefon dhe në llaptop, të cilët i kemi lënë me qëllim, që gjatë shtatë ditëve sa qëndruam atje, të mos jemi të shqetësuar nga thirrjet dhe mesazhet.

Me vete morëm vetëm Prozat e Franc Kafkës (Myrveti) dhe prozat e Zija Çelës (unë). Gjatë atyre ditëve Myrveti përpiq qindra faqe të Kafkës, ndërsa unë mezi lexova një vepër të Zija Çelës.

Ti lexon tepër shpejt dhe prej këtij leximi vetëm fabula e tekstit kapet, - i thosha, duke mbajtur mes gishtave një lapës kimik për të nënvizuar fjalë, shprehje, përshkrime personazhesh dhe mbase për ta arsyetuar dembelinë time.

Ti lexon tepër ngadalë, - përgjigjej ajo. - Jo çdo vepër është *Mesjar* i Gjon Buzukut, që duhet ta nënvizosh - dhe përmbyste faqen e re, pa e zgjatur.

Si të mos mjaftonte kjo, një dosje e kërkimeve të fundit arkivore më kishte mbetur në bagazhin e makinës dhe gjendja e tyre e parregullt po më pengonte t'i sistemoj në dollapin e vitrinës. Dosja m'i mori dy ditë sistemimi e leximi, aty-këtu: mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në fushë të arsimit; qëndrimin e disa intelektualëve rreth këtyre raporteve, pas vitit 1981; për informacionin shumë të plotë të Fjalës së Profesor Dhimitër S. Shuteriqit në Lidhjen e Shkrimtarëve të Serbisë në Beograd (1945), dosjen e organizimit të Konferencës së Lidhjes së Prizrenit (1978); projektin e panjohur prej gjysmë dekadë (1981-1985) për veprën e Josip Broz Titos dhe gjëma e madhe akademike për vdekjen e tij; dokumentet me interes nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës dhe Zyra Krahinore për përkrahjen e veprimtarisë shkencore, në të cilën për herë të parë gjeta recensionin për përkthimin e veprës së Jeronim de Radës "Milosao" në gjuhën serbokroate nga Esad Mekuli; nënshkruesit e vërtetë të referatit të Sinan Hasanit në ASHAK, për të cilin është folur e përfolur gjatë në mediat tona; reagimin e Akademisë për presionin policor serb të vitit 1989/1990 me theks të veçantë ndaj akademikëve Rexhep Qosja, Ali Hadri dhe Gazmend Zajmi; mbi projektin e botimit të veprës së plotë të Androkli Kostallari në Prishtinë (1980); të dhënat e reja për veprimtarinë shkencore të profesorëve: Idriz Ajeti, Rexhep Qosja, Hasan Mekuli, Gazmend Zajmi, Mark Krasniqi, Rexhep Ismajli, Besim Bokshi, Hilmi Agani etj., të cilat do të më hyjnë në punë për *Historinë e albanologjisë* dhe kapitullin e *Historisë së popullit shqiptar* mbi zhvillimin e mendimit shkencor në Kosovë, 1945-2008 etj.

2.

Tek shikoj mesazhet në telefon shoh se nuk kam shumë. Është kohë vere dhe të gjithë duan të pushojnë, por ka edhe të tillë që pikërisht në këtë kohë ndërmarrin nisma planetare, si Profesor Edgar nga Koreja Jugore, i cili ka filluar një projekt të madh për Mësimdhënien si përçuese e paqes në botë. Më paska thirrë dhe më paska dërguar disa paragrafë orientimi në projektin e tij si dhe më paska dhënë disa porosi. Nuk e di a do të mund t'i përgjigjem shpejt, ashtu sikur dëshiron ai.

Pa përfunduar leximin e mesazheve më thërret Fatoni, nga Instituti Albanologjik. Dëshiron të më jep librin e tij, i sapodalë nga shtypi, dhe të pimë një kafe. Më thërret edhe dr. Eljisa Fazliu. Kam dalë të pi një kafe te Amare, më thotë.

Nuk mundem, u them të dyve. Kemi munguar në shtëpi prej disa ditësh dhe më duhet t'i kryej disa punë familjare.

Kam menduar se më ka munguar kafja e kësaj zone universitare, - më thotë dr. Eljisa,



KEMI NEVOJË PËR NJË HERO TJETËR

Nga Begzad Baliu

- por ajo që dëgjoj e shoh në këtë mëngjes më bën të trishtëm, prandaj po mendoja që me ju do ta tejkaloja këtë atmosferë zhgënjimi. Dhe vazhdon rrëfimin tutje...

Ke të drejtë, - i them duke qeshur. - Aty, te kafet rreth rrugës me emrin e madh të Profesor Eqrem Çabejt, e përballë institucioneve më të rëndësishme shkencore e arsimore, për fat të keq ulen profesorë universitarë të ri e të vjetër. Shkencëtarë me shumë vepra dhe shkencëtarë që shumë, shumë kanë nga një gjysmë vepreje (magjistrature a doktorate), por që thonë, "bëjmë politikën tonë kombëtare, rajonale, europiane dhe madje planetare!" Aty, në ato ambiente të bukura e të qeta, shkencëtarët tanë, universitarët tanë, "politikbërësit tanë", "planetarët tanë": hanë dreka e darka të pasura me pagesat e institucioneve qeveritare e organizatave joqeveritare (një grup i parë); përshtatja demagogjine e tyre intelektuale nën aureolën e "Refuzimit estetik, të frymës rugoviste" (!), (një grup tjetër); ndërsa nxjerrin harpallakun feudal pas faljes së drekës, një grup i tretë. Viteve të fundit e kohëve të fundit, në këto ambiente dhe sigurisht jo vetëm këtu, pinë kafe edhe disa individë 'profesorë universitarë' e 'shkencëtarë', të cilët prej mënyrës se si ulen, prej mënyrës se si flasin dhe prej mënyrës së si hapreshen, tregojnë diletantizmin dhe gjendjen në institucionet tona arsimore dhe shkencore. Do të më duhet, jo një ditë, do të më duhen shumë ditë, për të mos thënë, do të më duhen disa muaj, do të më duhen Niçja e Frojdi, Konica, Kuteli, Bulka e Koliqi, Qosja e Agolli, për të shpjeguar natyrën e sjelljes së tyre, diskursin e komunikimit të tyre, përmbytjen e leksikut dialektor të tyre, kuptimin e të cilit nuk e shpjegon dot duke qenë vetëm etimolog, vetëm antropolog, vetëm sociolog a siciologuist, në të vërtetë më shumë se kaq, duhet t'i kesh të gjitha këto cilësi.

E kuptoj shqetësimin e dr. Eljisait. Ka vizituar, studiuar e specializuar, në disa qendra universitare: Tiranë, Sarajevë, Beograd, Shkup. Ka vizituar dhe njohur shumë qytete të Europës e Amerikës. Ka një njohje të gjerë kulturore të këtyre shoqërive. E kuptoj dhembjen e tij.

3.

Dalim me Bardhën, vajzën e madhe, me makinë, sa në një pikë, sa në një pikë tjetër. Në të shumtën e rasteve e pres pranë rrugës, brenda makinës. Ende nuk jam liruar nga biseda me dr. Eljisanin.

Shoh anash në xhepat e dymëve të

makinës të lexoj ndonjë faqe libri, sa për të kaluar kohën. Nxjerr *Antologjinë e rok poezisë amerikane*, prej të cilës disa poezi i paskam lexuar madje disa herë.

Nuk më shkon.

E lë atë dhe e marr librin *Gjuhët e parajsës*, përkthyer nga studiuesja Ledi Shamku.

Nuk më ecën pa një laps në dorë.

E lë.

Nuk e kanë fajin librat, po padëshira ime për të lexuar! A e kam humbur unë dëshirën për të lexuar! A çka mbetet në jetën time, nëse e kam humbur shijen e leximit!

Ndërroj valët 94.2 të Radio Kosovës së Lirë, emisioni i së cilës duket nuk është për momentin tim. As Radio Kosova nuk ma plotëson egon!

Valët ndalen te Radio Mitrovica dhe menjëherë pas një kënge të zgjedhur dëgjoj një reklamë, frymën e së cilës mund ta kem dëgjuar si fëmijë në Radio Tiranë e Enver Hoxhës, madje kryesisht në Ditët e Majit apo Muajin e Kongreseve. Turfullon zëri, tipik stalinist: "Kosova ka malet, fushat, brigjet... Kosova ka edhe veprat e Nexhmedin Spahiut!"

Kuku nanë, kuku nanë!

Në fillim të shekullit XXI, në Kosovën e lirë, në Kosovën e frymës euro-amerikane, - do të përsëriste kushedi për të satën herë, Ibrahim Rugova, - reklama, në të vërtetë parulla tipike staliniste.

Aspak e rastësishme dhe aspak e habitshme!

Duke bërë reklama për koncepte të vonuara, që glorifikojnë të ashtuquajturin identitet kosovar (një identitet krahinor, i sforcuar nga pushteti serb në vitet '60, për t'iu kundërvënë identitetit panshqiptar në ish-Jugosllavi), nuk është e rastit që edhe mënyrën e bërjes së tyre t'i kenë të vonuara: realsocialiste, staliniste dhe më tej enveriste.

Valët kapin më tej Radio Dukagjinin. Muzikë e bukur por tepër nostalgjike për disponimin tim. Pastaj Radio 21; Pastaj Gllam Radio; Pastaj, pastaj... Asnjë, nuk plotëson kërkesat, të cilat në këtë paradite, si duket nuk i kam të stabilizuara.

Hapi telefonin dhe e lidhi me radion e makinës. Do të gjej e dëgjoj diçka nga interneti. Provoj këngët e Ilir Shaqirit, pastaj të Andrea Bochelit, Luciano Pavarottit dhe ndonjë prej këngëve arvanite, që më sjellin sa krenari aq edhe emocijon. Gishtat, pa më pyetur, shtypin koncertet apo këngët e grupit *ABBA*, *Bony M*, *Tina Turner*, *Bee Gees*, *Queen*, *Bryan Adams*, *Bruno Mars*, *Phil Collins*, *Frank Sinatra*, *The Rolling Stones*. Cilin ta dëgjoj?

Përsëri, gishtat nuk më pyesin dhe trokasin mbi këngën e Tina Turnerit, *The Best*. Nuk më zhgënjnë. Çfarë kënge, çfarë interpretimi planetar? Të zgjon jo nga gjumi, po edhe nga varri- thosha dikur duke rrotulluar këmbët në vend. Nuk më paska dalë nga kujtesa titulli i këngës së saj "Ne nuk kemi nevojë për një hero tjetër". Tek kënga vazhdon, më sjell në kujtesë një dialog të tre studentëve të familjes sime të viteve '80.

Me këtë këngë të Tina Turnerit, vet i 30-ti e kisha pushtuar Beogradin, - mburrej nipi im Muharremi, student i makinerisë, që lakmonte Akademinë e Aviacionit, jo pse i pëlqenin fluturimet, po pse lakmonte që me fluturimin e tij të parë të bombardonte Beogradin!

Jo me Tina Turnerin, po me Dervish Shaqen e kisha kallë Beogradin tejprtejt, ndërhynte vëllai im - Shabani, student i albanologjisë, tek fuste gishtat mes flokëve dhe zgjeronte farmerkat shizi, thua se po bëhej gati të nisej.

Lene more Beogradin, me Tina Turnerin, "i kisha ra bregdetit të Dubrovnikut", - ndërhynte kushëririn im, misi i studentëve - Nexhati, i cili nga babai im e kishte marrë nofkën "Doktori", ende pa i mbaruar studimet.

4.

Dje kemi biseduar me Profesor Tefë Topallin, që sot të flasim në telefon dhe të diskutojmë për disa aspekte të veprës së tij *Leksikoni i albanologjisë*.

Profesor Tefa po e përgatit, jo një vepër, po një monument për Albanologjinë. Një Monument, i cili i ka munguar botës sonë shkencore, kulturës sonë. E veprat e tilla nuk përmbillen lehtë dhe nuk përfundojnë vetëm. As në kohën e internetit, as në kohën e globalizimit, as në kohën e komunikimit bashkëkohor, ku informacioni për dijen nacionale në shumë shtete dhe shumë qendra leksikografike jepet i saktë dhe i plotë, ndërsa tek ne ende është i huaj dhe i varfër. Për më tej, kolegët tanë japin informacione gjysmake, të pavërteta, të njëanshme. E profesori Tefë Topalli, që është shpirti i së mirës, ju ka besuar, i ka pranuar sugjerimet e tyre si të vërteta dhe si të besueshme, prandaj e kam vështirë të heshtë dhe t'ia shpjegoj sugjerimet e mia.

Ka shumë pyetje, kryesisht për gjuhëtarët në ish-Jugosllavi, apo në Kosovë e Maqedoni, sikur më thotë ai, ...dhe në Mal të Zi, - sikur e plotësoj unë. Flasim për Selman Rizën, Idriz Ajetin, Hilmi Aganin, Besim Bokshin, Latif Mulakun, Remzi Nesimin, Xhevat Gegën, Haki Ymerin, Rushdi Ushakin, Fadil Sulejmanin, Fadil Rakën, Rexhep Ismajlin, Tafil Kelmendin, Bahjtari Kryeziun, Ragip Mulakun, Shefkije Islamajn, Qemal Muratin, Asllan Hamitin, Izmit Durmishin, Mustafa Ibrahimin, Ismet Osmanin, Ajten Hajdarin etj. Flasim për personalitetin e tyre shkencor, por flasim edhe për situatat në të cilat jemi njohur dhe raportet që kemi pasur apo kemi. Flasim më tej për Profesor Shefki Sejdiun, Rexhep Doçin, Mehmet Halimin, Isa Bajçincën, Zijadin Munishin, Skënder Gashin, Abdulla Zajmin, Abdullah Zymberin, Sylejman Drinin, Ibrahim Goçin, Mehmet Ahmetajn dhe për studiues më të veçantë, pa të cilët nuk mund të merren me mend shumë institucione arsimore e shkencore dhe shumë projekte të fushës së albanologjisë. Bisedojmë edhe për shumë studiues të ri, të cilët duke qenë autorë të më shumë se dy a tri veprave, mund të përfshiheshin në *Leksikonin* e tij, por koha nuk pret, sepse data e dorëzimit të dorëshkrimit është 20 gushti i këtij viti. Flasim në mënyrë të veçantë për Profesor Dhimitër S. Shuteriqin dhe Profesor Rexhep Qosjen.

Biseduam edhe për shumë studiues anekënd botës, të cilët do të ishte mirë të

përfshihen sa më të plotë në këtë vëllim. Për të gjallë e për të vdekur: për Henrik Bariçin, Vojsllav Dançetoviçin, Victor Fridemanin, për Eric Hampin, për Aleksandër Rusakovin, për Rusanu Bejlerin, Hasan Kaleshin, Petar Skokun. Biseduam “poshtë e përpjetë”, do të thoshte Adem Demaçi, deri sa i thash se të shtunën do të jem në Tiranë dhe do të bisedojmë shtruar për më shumë çështje, autorë e vepra albanologjike. Dhe për ju, - e përmbylli bisedën Profesor im i dashur - Tefë Topalli!

I premtova ta ndihmojë për biografinë e Profesor Shefki Sejdiut, Skënder Gashit, Rexhep Doçit, Vilson Bicit, Mehmet Halimit, Isa Bajçincës etj., dhe u ndamë duke i uruar njëri-tjetrit një natë të freskët verore.

Pasi i kam premtuar Profesor Tefës se do të përgatiti një zë për Vilson Bicin, i shkruaj Eduard M. Dilos, për shkak të lidhjeve të tij familjare me Vilsonin. Pas pak,

ai më orienton te miku im në Gjirokastrë, Kristaq Shabani, ndërsa Kristaqi, si Kristaqi, pas pak kohësh më mbulon me të dhëna. Kisha harruar se ai ka shkruar një vepër për Profesor Vilsonin, me titull që vetëm ai di ta vë: *Jetari!*

5.

Deri vonë punova për të përmbyllur portretin prej studiuesi e sidomos prej pedagogu të Profesorit të ndjerë Vilson Bicit, ndërsa disa herë më zuri syri mbi tavolinë veprën e Profesoreshës Sala Ahmetaj, *Teoria dhe praktika e gjymtyrëzimit...*, botuar kohë më parë. E kam ndarë për lexim, jo për shkak se po merrem me probleme të sintaksës, po pse dua të shkruaj për veprën e asistentes së lëndës së vitit të parë në Fakultetin e Filologjisë së Universitetit të Prishtinës, *Kulturës së gjuhës*. Në të vërtetë, këtë lëndë

në Grupin e Gjuhës, ku isha unë student, e mbante Profesori Isa Bajçinca, ndërsa në ushtrimet e kësaj lënde shkoja edhe te *Grupi i letërsisë*, ku mbante ushtrimet Profesoresha Salë! Shkoja atje sa herë e kisha të mundur sepse Profesoresha Salë, përmes shembujve të zgjedhur në fushë të kulturës së gjuhës, fliste për historinë, patriotizmin individual e kolektiv, si dhe përmasën atdhetare të flijimit të Familjes së saj, në kohën kur shumë profesorë, sikur do të thoshte Profesor Qosja “e kishin humbur zërin”. Ajo fliste dhe shprehte si rrallë të tjerë, mes nesh, krenarinë e zëshme të saj.

Ishte mesi i viteve '80. Çfarë kohe e guximit qytetar dhe intelektual. Ishin tepër pak ata që kishin guxim të shkruanin e flisnin, si Profesor Qosja, Profesor Agim Vinca, Profesor Zekiria Cana, prandaj ata kishin fituar jo vetëm respektin e inteligjencies shqiptare, po edhe asaj propperëndimore,

kryesisht në Slloveni e Kroaci. Kishte edhe të tjerë që shkruanin më shumë e më pak flisnin, po që e paguan rëndë, si Profesor Rexhep Ismajli, juristi e intelektual Kolë Berisha, gazetari shqiptar i të përditshmes së Zagrebit “Vjesnik”, Ibrahim Osmani, apo të rinj që as nuk flisnin as nuk shkruanin, por punon natë e ditë kundër pushtuesit serb, si: Nasim Haradinaj e brezi i tij.

6.

Më duket që nuk është koha për lexim, ndërkohë që tekstin e porositur të Profesor Tefë Topallit për pedagogun e studiuesin e ndjerë të Universitetit të Gjirokastrës Vasil Bici, sapo ja kam nisur përmes internetit.

Iku edhe kjo ditë, do të thoshte miku im i motshëm nga Shkodra, Blendi Kraja.

Karikaturë nga Arben Meksi



MEKSI

Titulli i përmbledhjes *Ku e di unë*, që në italisht është *Boh* (1975, Bompiani) futet në kategorinë e shprehjeve tipike lokale (pra vetëm italiane) që shpreh të pakuptuarit e diçkaje. Zakonisht shoqërohet edhe me një mimikë të fyturës që shpreh pasigurinë mbi çka flitet, po aq sa me mbledhjen e supeve, gjesti - tregues më elokuent për t'u futur në ajrinë e këtij libri të pazakontë. Bëhet fjalë për një përmbledhje me tridhjetë tregime, të cilat shpalosin tridhjetë profile psikologjike grash, secila syresh unike në llojin e saj. Interesi i Moravias ndaj universit femëror ka qenë konstant, i pandërprerë, duke filluar nga *Karla e romanit të tij të parë Indiferentët* e deri te *Nora e romanit të papërfunduar Gruaja leopard*, por ai intensifikohet edhe më shumë në sezonin e fundit të krijimtarisë së tij që përkon me vitet '70 të shekullit të kaluar e deri në prag të viteve '90 kur ndahet nga jeta. Tri përmbledhjet me tregime *Il Paradiso* [1970], *Un'altra vita* [1973] dhe vepra që po vjen sot në shqip *Boh* [1976], formojnë një bashkësi të vetme organike, një galeri fotografimesh të personazheve femërore, forca artistike e të cilave jepet jo aq nga një përfaqësim i vetëm i një karakteri, se sa nga shumtorja dhe mbivendosja e karaktereve të ndryshme femërore që mbushin skenën. Kjo triadë krijon një galeri prej 95 zërash femërore ku Moravia ua lë timonin vetëm atyre. Janë ato protagonistet absolute të një galerie karakteresh që ngjan me një labirint të cilit vështirë se arrin t'ia shohësh fundin.

Dy janë karakteristikat stilistike që bien në sy në këtë përmbledhje: përdorimi i vetës së parë të zërit tregues dhe, modelimi i personazheve përmes një karakterizimi trupor si shpërfaqje fizike e psikës së tyre, por po aq edhe i përkatësisë shoqërore. Përdorimi nga ana e Moravias e vetës së parë, i ka rrënjët në leximin e soneteve të Gioacchino Belli-t, nga të cilat ai mëson teknikën e «fincionit përmes impostimit të zërit»¹. Aplikimin e parë të kësaj forme të vetës së parë ai e vendos te romani *Romania* (1947), më pas te *Çoçarja* (1957) dhe, bazuar në këtë model të këtyre shembujve të parë të "unit" femëror artistik, ai ndërton edhe triadën e nëntëdhjetë e pesë zërave femërore duke na furnizuar identikite tejet të pasura të vizionit femëror të krijuesit të tyre. Janë ato vetë që përshkruhen, që na japin detaje të vetat sa estetike aq edhe psikologjike. Në raste më të rralla, karakterizimi i tyre merr formë nga informacionet që lexuesi i përfton përmes dialogjeve dhe aluzioneve që u vihen në gojë bashkëprotagonistëve. Ky element i fundit i ndërtimit të personazheve nga ana e Moravias, bazohet te metoda e Tomasevskij, në punimin e tij *Ndërtimi i subjektit*, ku ndalet më në veçanti mbi një tip karakterizimi të quajtur "procedura e maskave". Një metodë fort e dashur edhe për Moravian siç do të vihet re edhe në vijim të krijimtarisë së tij. Procedura e maskave konsiston në përpunimin e përshkrimeve të jashtme sipas karakterit psikologjik të personazhit, ku futet aspekti estetik, ai i veshjes, i mobilimit të banesave si dhe ai i emrave të përveçëm.

Figura e gruas në këtë përmbledhje me tridhjetë tregime *Ku e di unë*, është kapur në një moment historik, atë të shndërrimit femëror në Evropë mbas revolucionit seksual të 1968, i cili shenjohej mbi të gjitha nga çlirimi seksual. Por pavarësisht këtyre transformimeve të dhunshme e shpesh sipërfaqësore e ekzibicioniste të këtyre grave, ato mbeten personazhe që nuk ia dalin të integrohen në pëlhurën sociale të re të Italisë që ka ndryshuar, duke mbetur përgjysmë në rrugëtimin e tyre: nga njëra anë tradita mijërvjeçare që i parasheh gratë ekskluzivisht vetëm në rolin social të gruas e të nënës, nga ana tjetër format e reja të përftuara nxitimthi pa një interiorizim të ndërgjegjshëm. Kësodore, një pjesë e

1 Laura Lilli, *Tanti occhi di donna per vedere il mondo*, «La Repubblica», 20 prill 1976. (Il mondo femminile nei racconti di Alberto Moravia).

Në librin me 30 tregime "Boh" – "Ku e di unë"

UNIVERSI FEMËROR I ALBERTO MORAVIAS

Nga Diana Kastrati



këtyre personazheve shpërfaqin neurozat karakteristika të atmosferës sociale të neokapitalizmit me dëshirën për të braktisur bashkëshortin a të dashurin, të tjera që kërkojnë të afirmohen në punë, të tjera që nuk aspirojnë tjetër veçse hakmarrjen, të tjera akoma që aspirojnë dashurinë por eksperimentojnë vetëm seksin, por që të gjitha të zëna ngushtë në një kontradiktë të përhershme e konstante: nga njëra anë dëshirën e fshehtë për ndryshim e, nga ana tjetër, pamundësinë për ta realizuar. Kjo kontradiktë kushtëzohet edhe strukturën e narrativës së këtyre tregimeve duke i dhënë asaj impulsin fillestar, por duke mos e kapërcyer asnjëherë pragun e realizimit konkret. Nga ana tjetër u jep tregimeve një tonalitet ironik që pavarësisht se mbart një pamundësi tragjike, nuk i rëndon. Ky tipar i teksteve moraviane spikat që në fillim të daljes së tij në skenën letrare ku pena e tij thyen një skemë të gjatë të melodramacitetit narrativ, karakteristikë e shpeshtë dhe e spikatur e tregimtarisë italiane. Shumë prej këtyre personazheve janë gra të vetmuara, të shkëputura nga realiteti, të cilat vuajnë nga një simptomë që shkenca e sotme e psikologjisë do ta quante si "problemi i gjetjes së identitetit të Vetës". Ky perceptim i shtrembëruar i realitetit nga ana e tyre, si dhe depersonalizimi që derivon nga kjo, e transformojnë lidhjen midis Vetës dhe trupit. Moravia, me një aftësi "sadiste" i fut në trup këtyre personazheve gra bulëzimin e parë të një ndërgjegjësimit që iu sjell atyre vuajtje e dhimbje, por nuk iu ofron asnjë alternativë. Sipas vetë tij, kjo përmbledhje me tregime, ashtu si dy të tjerat të cituara që përbëjnë edhe triadën, fotografajnë shqyerjen e brendshme të gruas, e cila është e paafte të gjejë zgjidhjen e kontradiktës të prodhuar nga shoqëria tashmë kapitaliste dhe e asaj të postrevolucionit seksual. Në dallim me burrat, të cilët janë programuar nga kultura maskiliste shumëshekullore për të patur një pozicion social të përcaktuar, gruaja moraviane aspiron për barazi, për integrim në këtë shoqëri të ndryshuar tashmë, por prapë mbetet e mënjeluar, e përjashtuar për shkak të diversitetit biologjik që prodhon edhe inferioritetin social që bota mashkullore ua atribuon atyre. Ndaj edhe përpjekjet e saj për adaptim janë nevrotike, të pahijshme, qesharake, të shtrënguar siç janë për të pranuar në mënyrë pasive ose ekstremiste funksionin e detyruar të tyre si objekt. Por, pavarësisht këtyre përpjekjeve të saj për adaptim, trupi nuk mund të edukohet. Te trupi gjen shprehje konflikti që e përshkon. Moravia mban një qëndrim të kthjellët ndaj këtij konflikti, të cilin e sheh si derivat jo vetëm të dallimit të rolit social që i është atribuar historikisht burrit dhe gruas, por edhe te ndryshimi biologjik, i cili nuk konsiston vetëm në ndryshimin e organeve seksuale, por te fakti që trupi femëror merr nuancat e "misterit". Pra, misteri që i ngjallin gratë dhe trupat e tyre, do të ishte fjala kyçe që ndriçon qëndrimin e Moravias shkrimtar në këto tregime, ashtu si në shumë vepra të tjera të tij. Trupat e shumtë që mbushin faqet e këtyre tregimeve (shpesh të lakuriqtë) janë ndërtuar në bazë kundërshtish si vitalitet/vdekje, lulëzim/tharje, egërsi/zbutje, spontanitet/falsitet.

Arkitektura e trupave femërore moraviane shfaqet me shumë forma, trupa të përsosur, trupa të shtrëmbët, të pahijshëm, trupa që nuk thonë asgjë, por po aq gjenden gra që kanë vetëm një dimension, trupin. Metaforat e përdorura në lidhje me trupin e gruas kanë origjinën nga bota e natyrës, ajo e egra, e padominuara. Sipas idesë së Moravias, në dialektikën histori/natyrë, gruaja akoma i përket natyrës, është një forcë që vështirë se kontrollohet duke i kujtuar kësaj burrit, origjinat e tij. Gjithmonë sipas Moravias, kjo vjen nga fakti se gruaja ka hyrë në rendin e historisë më vonë, por edhe nga lidhja e fortë e gruas me trupin e saj që përbën edhe fillesat e njeriut. Por, njëkohësisht, edhe vetë gruaja, nisur nga një ndërgjegje atavike e saj, kupton se trupi i saj është instrumenti i vetëm që mund të japë, në marrëdhënie me botën e burrave. Pra, gruaja deduktohet si irracionale e instiktive, përkundëjt burrit që rezulton racional, i llogaritur të cilat janë shprehje të një ndërgjegjeje vetjake.

Në lidhje me këto qëndrime letrare të Moravias, të rinjtë e revolucionit të 1968 e shndërrojnë këtë autor në idhullin e polemikës së tyre. Në fakt, ata i bëjnë "gjyqin" në faqet e gazetës "Espresso"² duke e akuzuar për bashkëpunim me sistemin borgjez. Po kështu, një grup feministesh të Milanos, në 1974 e sulmojnë Moravian dhe të tjerë autorë si Vitaliano Brancati-n, Cesare Pavese-n, Carlo Cassola-n, Leonardo Sciascia-n, Giuseppe Berto-n e Dino Buzzatin, në një libër³ që asokohe ngjalli shumë debat e habi. Ky grup shkrimtarësh të spikatur të shekullit të XX-të, etiketohet nga dy autorët si "baballarët e fallokulturës⁴", përgjegjës për mënyrën raciste, poshtëruese e plot me paragjykimë me të cilën e kanë përshkruar botën e gruas. Ato arrijnë madje të shprehen se kjo mënyrë e të vënit të gruas në letërsi nga ana e Moravias, nxit mizogjeninë. I akuzuari Moravia nuk përgjigjet menjëherë, por e peshon mirë situatën dhe pas thuasë një viti jep një intervistë të gjatë ku përqëndrohet te tregimet e tij femërore ku pas një deklarate hyrëse të bërë nga ai mbi barazinë gjinore dhe bindjet e tij të forta në lidhje me këtë temë, ndër të tjera thotë se: "Ju e dini që jam sulmuar në një libër feminist duke u etiketuar si një 'baba i fallokulturës'. Autorët nuk e kanë kuptuar që unë kam shumë simpati për gratë, më shumë se për burrat madje; ato më ngjallin kureshtje, më stimulojnë më shumë dhe tekta i përshkruaj ndjehem edhe më i çliruar, më i lirë".

Te Moravia gjejmë si konstante seksin dhe trupin e gruas, që mbartin një ndikim të fortë frojdian. Me vullnet të tij, por po aq me bindje, ai e trajton seksin nën një optikë krejtësisht psikanalitike, psikike, ndaj kjo është një nga arsytet pse personazhet gra moraviane rezultojnë inafektive. Të bërit seks për këto gra, ka shkaqe që nuk burojnë aq nga dëshira reale, por shpesh nga padëshira, nga ambicia, nga psikopatia, nga perversiteti, nga të qenit ninfomane, nga të qenit hippy, nga të qenit provinciale, borgjeze, nga mosndërgjegjja, nga mërzia, veçanërisht nga kjo e fundit.

2 Espresso, *Processo a Moravia*, 25 febbraio 1968.

3 Bibi Tomasi Liliana Caruso, *I padri della falloccultura*. Milano, SugarCo Edizioni, 1974.

4 Termi i shpikur pas atij të fallokritikës, me të cilin cilësohen koncepte, qëndrime e pohime që pretendojnë të përligjin një pozicion të privilegjuar të burrit ndaj gruas në shoqëri, duke iu referuar simbolit të fuqisë së organit mashkullor, organit të tij gjenital.

Por pavarësisht kësaj konstanteje tematike të seksit te tregimet e kësaj përmbledhjeje ashtu si në dy të tjerat, duhet nënvizuar një tjetër fakt: seksi te këto gra nuk shkon baraz me erotizmin, pikërisht falë profileve psikologjike që Moravia zgjedh të tregojë. Është sensualiteti që gjendet më shpesh, por gjithsesi në përqindje shumë më të vogël se erotizmi. Por prania e tematikës seksuale në këto tregime, ashtu si në përqindjen e madhe të librave të tij, nuk mbështetet vetëm te era e re e ndryshimeve në Evropë pas revolucionit seksual, jo vetëm te vokacioni personal i Moravias, obsesiv thuasë, por edhe te një vizion i tij për botën në përgjithësi.

Si shkrimtar ekzistencialist, Moravia është i interesuar ndaj faktit individual, të brendshëm, psikologjik, të errët, ndaj ai mban me personazhet e veta një raport thelbësor ekzistencial. "Qasja ime [...] është ekzistenciale pra, premorale, preracionale, presociale: ose faktet sociale ndikojnë mbi emotivitetin dhe psikologjinë e individit duke u parë e analizuar në funksion të shndërrimit të tij të brendshëm, ose nuk më interesojnë; nënkuptoj që nuk më interesojnë si narrator"⁵. Kësodore, ai nuk mvesh petkun e moralistit, as të gjykesit (kjo, në të gjitha veprat e tij), por atë të observuesit neutral të një realiteti femëror të karakterizuar nga një shtypje e rëndë e pa rrugëdalje të menjëhershme. Ai punon me limae labor në nënvetëdijen e secilës grua artistike që plazmon, me sistematitet, këmbëngulje, duke gërmuar në psikën e tyre të errët e duke nxjerrë në sipërfaqe secilën shpërfaqje të patologjisë apo të "krisjeve" të brendshme të tyre të diktuar nga rrugëtimi shumëshekullor shtypës. Gratë moraviane veprojnë të shtyra nga diçka që iu rrëshqet ndërgjegjeve apo konjcionit të tyre. Thuasë të gjitha janë të reja, kanë një trup të dëshirueshëm, janë sensuale e një pjese të mirë syresh nuk iu mungon as inteligjenca, por që të gjitha janë të zëna në çarkun e vetvetes e të një mekaniciteti veprimesh. Falë edhe shkurtësisë së këtyre tregimeve, këto gra, të shtyra nga njëmijë motive të brendshme, të pakuptuara mirë nga vetë ato, ndiejnë nevojën e transformimit duke vepruar a marrë fjalën për të vjellë padurimin e vuajtjen e fortë e të gjatë sociale, por që gjithsesi, secila syresh përshkruhet nga autori në suazën e një patologjie. Nëse letërsia italiane deri para hyrjes në skenën letrare të Moravias, kishte sublimuar figurën e Nënës, te tregimet e tij nuk gjejmë as edhe një gjurmë të këtij sublimimi apo përkushtimi ndaj familjes apo fëmijëve. Në galerinë marramendëse të identikiteve letrare femërore moraviane, ndeshemi në gra që dalin nga skema e paravendosur sociale që e sheh gruan të përkushtuar me mish e me shpirt ndaj fëmijëve të vet. Gratë moraviane në këto tregime janë ose patologjike, hysterike, skizofrene, thuasë pa emotivitet, të ftohta, të përlllogaritura, që aspirojnë ose një bashkëshort (kryesisht ato që vijnë nga provinca në qytet), ose të mbajnë një bashkëshort si e vetmja çati që u siguron mbijetesën, ose janë perverse, të çinteresuara nga roli social i nënës apo i gruas, duke synuar një zgjidhje tout court për jetën dhe

5 *C'è un crisi del romanzo?*, botuar në "La fiera letteraria", 1927.

jo aq pse mbartin një ndërgjegje, por sepse i drejtohen idesë së familjes si reminescencë e historisë shekullore të shoqërisë njerëzore, ose si një instikt mbijetese. Duke përdorur një atribut të shpikur nga vetë Moravia në një tjetër roman të tij, ato janë të desublimuara. Pjesa më e madhe e tyre është dominuese në raport, agresive shpeshherë, në pak raste e nënshtruar, por shumë rrallë Moravia i mvesh ato me një ndërgjegje të mirëfilltë për veprimet që kryejnë. Nëse do ta thoshim me titullin e një filmi të Pedro Almadovar, ato janë "gra në prag të një krize nervash".

Shqipëria nuk ka ndjekur ecurinë e emancipimit femëror botëror për arsye historike e kulturore. Nëse lëvizja feministe në nivel botëror ka njohur deri tani të paktën katër faza, të cilat ndryshin brenda korrente nga më të ndryshmet e madje edhe kontradiktore mes tyre, në Shqipëri asnjëra syresh nuk ka qenë as lineare, e as e thelluar. Nëse faza e parë që identifikohet me atë të të drejtës kushtetuese të votës e të arsimimit të grave, në Shqipëri kjo u arrit jo falë luftës së bërë nga vetë ato, por falë vendosjes së saj me forcë nga ana e regjimit komunist. Pra, ndërgjegjësimi i grave për të drejtat themlore të tyre, ishte thuajse inekzistent përse kohë që ato arsimoheshin, votonin, dilnin nga shtëpia për të punuar, por kur ktheheshin brenda mureve të banesës, përballëshin me situatën e absurdit ku vetë ato nuk ishin në dijeni të të drejtave të tyre e, aq më pak burrat e tyre. Nëse faza e dytë në botë përkon me lëvizjet e fuqishme të revolucionit seksual të 1968 e me pasojat e tij ndër vite si çështjet e seksit, martesës, amësisë, abortit, divorcit, punësimit, ku mund të inkuadrohen edhe protagonistet e tregimeve të këtij libri, në Shqipëri kjo fazë ndërgjegjësimi që absolutisht inekzistente. Nëse edhe në Perëndim kjo fazë pati efektin më të fortë të saj, edhe atje mass mediat nuk ndihmonin realisht këtë ndërgjegjësim. Televizioni e publiciteti të diktuar nga industria editoriale, propozonin vetëm imazhin e një gruaje familjare të realizuar nga konforti ekonomik, të cilat ngrinin në qiell funksionin biologjik të saj duke vendosur madje edhe standartet estetike të bukurisë ku duhej të aspironte secila syresh, pa e përfshirë në zhvillimin tashmë marramendës të financës apo politikës. Nëse faza e tretë e lëvizjes botërore për të drejtat e grave futi tashmë koncepte si gender studies, kundër dhunës duke u institucionalizuar madje me lëndë studimi në universitete të ndryshme, në Shqipëri kjo fazë e viteve '80 - '90 të shekullit të kaluar, përkon me atë të kalimit historik të vendit nga sistemi komunist në atë të ashtuquajtur kapitalist. Por, pavarësisht bulëzimit në fillim të viteve '90 të shumë shoqatave jo qeveritare, atyre kundër dhunës apo rrjetit që po tentohej të krijohet që punonin me këtë fokus, fillimit të familjarizimit të publikut me artikullimin e një ligjërit të mbarsur me këto koncepte të panjohura më parë, efekti i tyre në nivel ndërgjegjësimi kombëtar, që i dobët. I ashtuquajtur çlirim femëror shqiptar ndodhi pa rrregulla dhe në një atmosferë të egër e të dhunshme, duke prodhuar jo pak viktime. Nëse sot po përjetohet faza e katërt botërore e kësaj lëvizjeje emancipuese që i detyrohet përdorimit masiv të internetit dhe rrjeteve sociale, duke përhapur një seri të pafundme konceptesh e realitetesh e lufte të drejtash për gender fluidity etj, të përzier me ato të racizmit e të homofobisë, në Shqipëri kjo ka gjetur një jehonë e cila, akoma nuk gjen një zë të konsoliduar. Debati publik mbretërohet akoma nga zëra që nuk krijojnë idenë se është arritur qartësia apo ndërgjegjësimi edhe nga vetë gratë. Ndaj, introspeksioni i domosdoshëm për secilën grua, nëse realizohet përmes artit, letërsisë, mund të konsiderohet si një nga format më efikase për të mbërritur më së fundi në vetëdijësimin aq të aspiruar. Ndaj, përtej intrigimit personal ndaj autorit, përtej 25 viteve studimi të produktit të tij letrar, vjen edhe ky shkrim. Ndaj Moravia mbetet klasiku modern.

BORËBARDHË RELIKAT E MIA

poezi nga Eljesa Kraja

Lindi më 24. 05. 2007 në qytetin e Shkodrës.
Studion në vitin e dytë, në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia", Shkodër.
Pjesëmarrëse në shumë aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore. Fituese në disa çmime në prozë, ese, poezi dhe interpretim.
Më të dalluarat janë:
Çmimi i parë në Olimpiadën e Gjuhës dhe Letërsisë
Çmimi i tretë në interpretim në konkursin "Talentet në Medrese" mes të gjitha medreseve në Shqipëri.
Çmimi i parë në projektin "Nxitja e talentëve të reja", me poezinë "Kush tjetrin gjeti?" Biblioteka "Marin Barleti", Shkodër 2023.



DUA TË PROVOJ

Fillojnë zogjtë të fluturojnë
Fluturimi nis atje larg zhgjetuar
E unë si zog i trembur i vërej
Me kokën lart duke ëndërruar
Mbi turmën pa kapur të parin
S'munda të mund botën e udhëtarit

Zogjtë tregojnë dihatjen e guximit
Brenda brendi të ngrohtë në të ftohtë
Veç prap largohen atje mes sfulqesh pa kufij
Ku triumfi e di historinë e një bote plot befasi

Sa mungon ky zog i lirë në këtë dritare
Ku brenga duhet me u nda
E me u ba tok, shok me atë
Veç duke u pa

Atje larg ku zëri shtegton
Dhe buçet shkulli i erës nga turma
Vazhdon furishëm-furishëm ndihet
Gjersa, fare bosh
Shtigjeve asnjë harabel
Nepër agime nuk mbeti

Ajo që mban nuk është vetëm ajër
Se zogu do dritë kur të pret
Por njeriu nuk e pret vetëm me verë

Zogu s'ndalet në fluturim hedhur
Në çdo orë unë e pres heshtur
Se mos mua më sheh në atë agim
Ndoshta vjen tek një përqaftim

Nga dritarja e shatorres
Kur unë t'a shikoj në vendin tim
Dije se do jem me duar hapur

Dhe shok me zogun
Tërë jetën pa asnjë dyshim

PA FRE

Rrkaq derdhen
Drejtëzat e kënaqësisë
N'sa drithtime
Shkrepen e përtërihen
Posi dy shkndija
Në dritën e synit
Qashtu luajnë ritmin e andrrimit
Nën hijet e shpijave mbulu me ar
Nën hijet e shpijave t' tymueme të zeza

Ato nuk flasin po unë i përtërij për tjetrin
gzim
Që të kem dellin e gazit
Shfaqjen e marazit
Në një grusht të fuqishëm
Të rreckum
Nga letrat e ndyra të avazit

Ah të gjeja gjithkund këtë pjesë
Do thurja tinguj t'argjantë
Të mbytur për një simfoni
Simfoni që të mbyllt sytë
E rreh prej fellsinës pa marrun frymë

BORËBARDHË RELIKAT E MIA

Thellë në shtëpitë përdhese
Luajnë bindshëm shirat e dëborës prap
vjen te pragu
Thellë mbulu relikat e mia afër tokës
sikurse edhe fëmija

Të cilat qëmoti s'i zbuloi nëna e as babai
Të cilat dëgjojnë në gjumin e tyre të
pabindshëm
Thellë brenda meje më kërkojnë njëherë
dhe dy
Në këtë natë po sidomos në këtë ditë
gjëmueshëm
Mendimet
Të cilat shpërthejnë në një anë tjetër
Në një shtëpi të re në majë të një shpati
Të përqaftun me diellin për së gjati
Andje e përplasun
Ku fle njëherash dimri që s'kuptohet
Ku gjeli këndon si pranverë që vjen
Thuajse mirësi e fatit
Veç unë i njoha ato kërcëllima
Vazhdojnë më ndjekin si fëmija nënën
Oh edhe shirat përpara meje ndodhen
Kështu relikat e mia të pafat
Mbushin oborrin me vargjet e të bardhës
"Borë në këtë rrugicë shiu të shikon apo
jo?"
Lindja është afër më thonë kur ti shkrin
Por lindja gjëkund s'duket dhe në
pranverë
Sidomos "A të mjafton pritja?"
Shikimet e molisuna pastaj
Lamshet ngadalë-ngadalë më mblidhen
ndër fytyrë
E ti përsëri-borë nuk shkrin së prapthi
Luan me stinët e jetës që ngelën
Një lojë me emër "Borëbardhë relikat e
mia"
Por unë nuk të dëgjoj mirë
Veçse në formën e vesës
Ndaj vazhdo
Mos e freno hapin në asnjë mal
Ti vazhdo lundro me hope
Unë po largohem
Dhe pritja sendet t'i mbështjellë
Deri atëherë..

KUSH TJETRIN GJETI?

Vjeshta që erdhi
Humbi pa u turrë
mbi tokën zverdhur
Që arratisje mbi gurë

Mbi tisin e vakët
Shushatja e pemëve
Në të ëmblën fytyrë
Shushat jo pak dhe jetën

Në cepëzat e syrit
Dallohet malli
Dallohet e para n'radhë
Loja kukafshehti "kush tjetrin gjeti?"

Dikur zërat çuqërasin
Dikur lulet i njom edhe shiu
Largohet dhe vapa
Përmbyllet edhe shfaqja

PËRBALLË KA NYJE

Afër botës ulun
Më kundron aroma pranverë
Se aty gjej trëndafila të paçelun
Trëndafila pa erë
Të pushtum në oborrin e heshtun
Ku të gjithë dalëngadalë a shpejt
përnjiherë
T'ishim aq të njoftun
Si unë dhe ti aherë pa u njoft
Ndoshta në të thatin trëndafil
Do kridheshin petlat
Sikurse në ditë me erë
Ku rrezet vrullojnë
Dhe s'asht habi me i ndje
Në strukat ma t'bluta mes tynë
Dale prit edhe pak në atë parvaz
Se mos ndoshta edhe në vallëzim
Me sytë mbyllur do ndryshojmë
Si herën e parën tuj pyt

PLATONI I THOTË

platoni i thotë
atij se nuk mund
t'i besojë (jezus

i thotë atij se
nuk mund t'i besojë)
lao

tsze
i thotë atij
i sigurtë dhe
në përgjithësi
(po

mam)
sherman;
ndonjëherë
(i beson
ose

jo) ti
i thua atij; unë i them
atij; ne i themi atij
(ai nuk e beson këtë, jo

zotni) kjo tërheq
dhe kureshtjen
e një gjashtëvjeçari

avenue
el; e ka në majë të gjuhës; për t'i thënë

atij

SEPSE TË DUA) NATËN E SHKUAR


sepse të dua) natën e shkuar
e mbështjellë e tëra me alga
m'u shfaqe
mendja jote shkoi me
mbetje perlash, koralesh, gurësh
lart u ngrite dhe (para syve të mi
re dhe u fundose) brenda në ujë trupi yt
drithëronte; butë
fytyra jote lëshoi një të qeshur si gargarë
prej vdekjes; e mbytur fillikate
përsëri prej thellësisë me shumë kujdes
ngrite duart
këmbët ngrite
dhe u zhduke
duke nxituar butësisht, duke shkarë si me
platinje, pastaj humbe me shpejtësi
në ëndrrat e mia të fundit
natën të gjitha janë të tuat
trupi dhe shpirti yt notojnë
mbështjellë me
shkulmet monotone të baticës

pëlqej trupin tim kur bashkohet me trupin
tënd. dhe kjo duket si një gjë krejt e re.
muskujt bëhen më të bukur dhe nervat
gjithashtu.
pëlqej trupin tënd. pëlqej çdo gjë që i
përket atij,
pëlqej si janë krijuar hiret e tua, pëlqej kur
të prek shtyllën kurrizore
dhe kockat aty -këtu, brinjët e gjata, te
lakuara dhe rrëqethem
me fortësinë dhe butësinë dhe s'ndalem
duke prekur dhe shtrënguar gjithçka
dhe përsëri dhe përsëri dhe përsëri
të puth, pëlqej kur të puth dhe pëlqej kur ti
më puth, aq butë, aq ëmbël, dhe befas
ndizemi në një trallisje e molisje të ëmbël
trupi yt elektrik sikur bëhet fir dhe
trupi im gjithashtu
dhe ç'vjen pas puthjeve as vetë s'dimë
ç'është..
dhe sytë e mëdhenj shqyer prej një
dashurie të madhe

E MBAJ ZEMRËN TËNDE

poezi nga e. e. cummings

Përktheu Roland Gjoza



ne ato të çara të vogla blu

e
ç'mund të pëlqej më tepër se këtë
drithërimë të bukur?

nën trupin tim trupi yt një gjë krejt e re

DHE E PARA ËSHTË NDJENJA

dhe e para është ndjenja
kush ka kujdes të tepruar
për një sintaksë të bukur
kurrë thellësisht s'ka puthur

tregohet veç idiot
ai që s'vë re
se pranverën i dha bota

gjaku ma provon këtë gjë
puthja është më e fortë
se dija e filozofit
zonjë, të betohem për të gjitha lulet, mos
qaj
vargu im më i bukur është më pak i
rëndësishëm
se dridhja e qepallës tënde, e cila sikur më
thotë

ne jemi për njëri- tjetrin; pastaj ti qesh
më hedh duart në qafë
për jetën ky s'është paragraf

dhe vdekja nuk është parantesë.

profesioni im është të jetoj, thotë
dikush (i cili nuk mund të sigurojë bukën
ngaqë të shesë kokën nuk mund)

pret me durim një pergjigje polemi
dy bilion morra publikë brenda
në një palë pantallona (që kanë vdekur)

dinë të nxjerrin lule prej çdo gjëje
gishtërinjtë e tu
që me preken e parë

dhe flokët e tu dinë të krijojnë orë
dashurie
të shumta
me një ëmbëlsi të madhe
që s'është parë kurrë
dhe këndon dhe reciton
kaq bukur
(megjithëse dashuria zgjat një ditë)
s'ke më frikë, sot është festë perëndish

hapi yt i bardhë si kristal humb e përhum
gjithmonë
sytë e tu me lot mësojnë lojën e puthjeve
kaq të çuditshëm duken kur të shikojnë
këndojnë dhe recitojnë
(megjithëse dashuria zgjat një ditë)
për artin e vajzës që di të sjellë prej gjërave
lule

buzët e tua gjëja më e ëmbël dhe më e
madhe në botë
ndonëse kaq të vogla duken
vdekjen do thërras sikur t'i kërkoj një lutje
nëse shtrëngimi yt
më mungon
(megjithëse dashuria zgjat një ditë)
dhe jeta s'është asgjë, po që se s'ka më
puthje

jo shumë kohë më parë
apo në një tjetër jetë
duke ecur në errësi
takova Krishtin

jesusin) zemra
më shpërtheu nga kraharori
e lashë në ajër
gjersa ai kaloi (dhe

ishim afër si unë me ty
fare afër ishim
s'ndodhi asgjë
përsëri vetmi

nuk janë të bukura zonjat e Kembrixhit,
ato jetojnë
me ritet tradicionalë dhe kanë mendje të
shkathët
(bekojnë vajzat në kishat protestane

pa aromë spiritualiteti, në dalli pasioni)
besojnë në Krisht dhe në Longfellou, të dy
të vdekur,
dhe kanë interes të përhershëm për gjëra
të tilla;
përpiqen të gjejnë se cila dorë e fshehte
dhe e mprehte
ka shkruar për atë polakun dhe kështu
ngrihet thashethemnaja
mbi skandalin e zonjës N me profesorin D
... zonjat e Kembrixhit nuk pyesin fort
për Kembrixhin dhe në qoftë se kur e kur
në rutinë e qiellit pa fund prej livandoje
kërkellin hëna si një copëz sheqerke e
flakur

mbaroi
Buffalo Bill¹
ai
që përdorte për vrapim një
bukuriujërash- të argjendta

hamshori
dhe mbyste njëdytrekatërpesë
pëllumbatëngjashëm

me Jesusin
ai ishte një burrë i bukur
dhe ajo që dua të di është
si i pëlqeu aq shumë ata sytëblu aq të
qeshur prej foshnje
Mister Vdekja

DIKUSH JETON NË QYTETIN E BUKUR

dikush jeton në qytetin e bukur
(bashkë me kambanat që bien me kumb)
pranverë verë vjeshtë dimër
ai s'ka dhe kërcen dhe ka pa fund

gra dhe burra (bashkë me të vegjël dhe
pleq)
kujdesi për ta nuk është siç duhet
ata mbjellin dhe s'bëjnë të njëjtën gjë
diell hënë yje shi

fëmijë iluzionist (pak prej tyre
harrojnë që një ditë do të rriten
vjeshtë dimër pranverë verë)
askush s'do t'i dojë aq dhëmbshurisht

prej këtij çasti dhe prej një flete në pemë
ai qesh dhe gëzon ai qan dhe trishton
zogu në borë qe ende flatra s'hap
është si dikush që shumë i ngjan

dikush martohet me atë që do
të qeshura qarje dhe kërcime me def
(gjumë zgjim shpresë dhe të tjera) ata
kurrë s'fleenë që të shohin ëndrra

yje shi diell hënë
(dhe vetëm bora e di sesi
fëmijët harrojnë fëmijët kujtojnë
bashkë me kambanat që bien me kumb)

një ditë dikush do vdesë kur t'i vijë
(dhe askush s'do ndalet të puthë fytyrën e
tij)
njerëzit janë të zënë, nga një vend në
tjetrin
nga i vogël më i vogël, ishte dhe s'është

të gjithë si të gjithë dhe thellë e më thellë
shumë e më shumë ëndërrojnë të fleenë
asnjë dhe dikush toka dhe prilli
bekuar nga shpirti që thotë po

¹ kjo poezi mjaft e njohur e e.e. cummings,
është mbështetur te legjenda Buffalo Bill, (emri
i vërtetë William F Cody) një kauboj i famshëm

gra dhe burra (bashkë me ding dang ding)
verë vjeshtë dimër pranverë
sërish fillojnë të mbjellat dhe ata shkojnë
e vijnë
diell hënë yje shi

E MBAJ ZEMRËN TËNDE NË ZEMRËN TIME

e marr zemrën tënde me vete (e mbaj në
zemrën time) nuk harroj asnjëherë ta mbaj
në zemrën time

(kudo që shkoj unë, shkon dhe ti, e ëmbla
ime, çdo gjë që bën ti
e bëj dhe unë, e ëmbla ime, nuk kam frikë

nga fati (ti je fati im, e ëmbla ime,) nuk e
dua

botën (ti je bota më e bukur, kjo është e
vërteta)

ti je çfarë ka ëndërruar gjithmonë hëna
çfarë ka ëndërruar dielli të bëjë, ti je kënga

këtu është sekreti më i thellë që askush
nuk e di

(këtu është rrënja e rrënjës dhe sythi i
sythit

dhe qielli i qiellit të një peme që e ka emrin
jetë, e cila rritet

më lart se sa shpirti dhe mendja mund ta
fshehtë dhe

kjo është mrekullia që i mban yjet larg

e marr zemrën tënde me vete (e mbaj në
zemrën time)

DIKU KU NUK KAM UDHËTUAR ASNJËHERË

diku ku nuk kam udhëtuar asnjëherë,
gëzueshëm dhe përtej
çdo përvojë, sytë e tu ruajnë heshtjen e
kësaj të panjohure,
në gjestin tënd më të imtë janë gjërat që
më kanë robëruar
të cilat nuk mund t'i prek sepse i kam fare
pranë

vështrimi yt më i pavëmendshëm do të më
mbyllë brenda
megjithëse unë e kam mbyllur veten si
gishtërinjtë
ti përherë më hap petale pas petalesh
ndërsa pranvera shfaqet
(duke prekur vrullshëm dhe misteriozisht)
trëndafilin e saj të parë.

në qoftë se ti dëshiron të më mbyllësh, jeta
ime
do të shuhet në mënyrën më të bukur dhe
krejt papritur
si zemra e këtij trëndafilu teksa imagjinon
dëborën
kur bie prej lartësisë me heshtjen e
fantomës

asgjë që ne shohim në këtë botë nuk është
e njëlojtë
pushteti i fuqisë tënde është kaq i brishtë;
sa kjo
më detyron me gjithë ngjyrat e vendeve që
i përkasin kësaj bote
të jap vdekjen time për ty në çdo
frëmëmarrje

(unë nuk e di çfarë të pëlqen që më mbyll
dhe
më hap; vetëm diçka sigurisht unë e kuptoj
zëri i syve të tu është më i thellë se të
gjithë trëndafilat)
dhe askush, madje as shiu, nuk ka duar
kaq të vogla.

Librat e jetës sime, *The Guardian*

OLGA TOKARCZUK:

Leximi i Frojdit ishte hapi im i parë për t'u bërë shkrimtare

Përktheu: Granit Zela

Nobelista polake flet për problemin me leximin e Xhejms Xhojsit,
frëmëzimin nga Yuval Noah Harari dhe për librin e parë të vjedhur.

Libri që jam duke lexuar

“Homo Deus” i Yuval Noah Hararit.
Ky është i dyti i tij që kam lexuar dhe
ka shumë fragmente frëmëzuese në të
– nuk është as më shumë dhe as më pak
se një koleksion idesh shumë të mira
për tregime të çuditshme. Kam botuar
dhjetë në Poloni dhe tashmë mendoj se
duhet ta kisha lexuar Harari-n përpara
se t'i shkruaja.

Libri që më ndryshoi jetën

Lexova për herë të parë “Përtej parimit
të kënaqësisë” të Zigmund Frojdit kur
isha vajzë e re dhe më ndihmoi të kuptoj
se ka mijëra mënyra të mundshme për të
interpretuar përvojën tonë, se gjithçka
ka një kuptim dhe se interpretimi është
çelësi i realitetit. Ky ishte hapi i parë
për t'u bërë shkrimtare. Është autori që
ndikoi te mënyra si shkruaj.

Mendoj se në Poloni shumë

shkrimtarë do të jepnin të njëjtën
përgjigje: Bruno Schulz, tregimet e
tij shumë të bukura, të ndjeshme,
domethënëse, të cilat e ngritën gjuhën
polake në një nivel krejtësisht tjetër.
Unë e dua, por edhe e urrej sepse nuk
ka asnjë mënyrë për të konkurruar me
të. Ai është gjeniu i gjuhës polake.

Libri që është më i nënvlerësuar

“Kukulla” i Bolesław Prus-it, një
histori dashurie e mbështetur në klasën
shoqërore në Poloni në fund të shekullit
të 19-të. Është letërsi e bukur nga tradita
letrare polake e asaj periudhe, dhe kur e
krahason me atë që shkruhej në vende
të tjera të botës asokohe, e kupton se sa
mençuri mbartte.

Libri që më ndryshoi mendjen

Do të zgjidhja dy emra, në vend të
librave të veçantë, nga bota e poezisë.
Kur isha adoleshente rashë në dashuri
me T.S. Eliot-in. Fillimisht vodha një
libër të tij nga biblioteka, pastaj fillova
të mbledh të gjitha veprat. Poema ime
e parapëlqyer është “Kënga e dashurisë
së J. Alfred Prufrock-it”. I dyti është
Czesław Miłosz, i cili ishte poet por
dhe eseist i madh dhe ishte ai që më
ndryshoi mendjen për të shkruarit.

Libri që më bëri të qesh

Mua më dukej shumë për të qeshur
“Dëgjoje trumpentën” e Leonora
Carrington-it. Është një roman i
mprehtë, i paparë, me një tregimtar
92-vjeçar jo të besueshëm i cili ka
ndikuar në romanin tim “Kaloje plugun
mbi kockat e të vdekurve”. E kam lexuar
në kohën e komunizmit dhe më bën të
kuptoj se sa me fat ishim në atë kohë që
kishim kaq shumë letërsi të përkthyer
në polonisht.

Libri që nuk arrita ta përfundoja

“Zgjimi i Fineganëve” i Xhejms
Xhojsit. Kam shumë njohuri për librin,
por nuk më ngjit leximi.

Libri që më vjen më shumë turp që
nuk e kam lexuar

“Unazat e Saturnit” është një nga dy
librat e WG Sebald-it që kam ende në
listë.

Libri i parë që mbaj mend të kem
lexuar e vogël

E para punës, prindërit më lexonin
kur isha vajzë e vogël, dhe jo vetëm
përralla, por libra të mëdhenj si romanet
historike të Henryk Sienkiewicz-it,
të cilat i mbaj mend që kur isha rreth
gjashtë vjeç.

Lexime për qejf

Më pëlqen t'i kthehem fantashkencës
së Stanisław Lem-it. Ai është qetësues,
por edhe argëtues, dhe megjithëse i njoh
librat e tij, gjithmonë ka diçka të re për
të zbuluar.



Me vëllimin “Të mbyturit dhe të shpëtuarit”, botuar 40 vjet pas “A është, vallë, njeri...?”, Primo Levi përbush dëshminë dhe reflektimet që kishin nxitur e frymëzuar librin e tij të parë. Ky vëllim me ese, për shkrimin e të cilit iu deshën dhjetë vjet, u botua nga shtëpia botuese Einaudi në pranverën e 1986-ës; ai është përkthyer në të gjithë botën dhe tashmë njihet si një vepër e jashtëzakonshme mbi natyrën e së keqes dhe atë të njeriut. Tashmë, më së fundi, është botuar edhe në gjuhën shqipe falë përkthimit të Aida Baros.

Në faqet e këtij libri zënë vend shqetësimet e shumta, të lindura nga ndryshimet që Levi vërente në botë dhe që i kishin pushtuar mendjen në periudhën e fundit të jetës, peshën e së cilave mund ta kuptojmë sot fare mirë: zbehja e kujtimit të Aushvicit; mosnjohja dhe mungesa e kujtesës historike të nxënësit dhe studentët që Levi ka takuar nëpër shkolla, të cilët e presin me skepticizëm thjeshtëzues dëshminë e tij, sikur shfarosja e hebrenjve të ishte diçka që i përket një kohe tejet të largët; dalja e historianëve negacionistë dhe revizionistë, që vënë në dyshim ekzistencën dhe veçoritë e gjenocidit hebre dhe të Lagerëve; së fundi, irritimin e tij ndaj retorikës që përpiqet t'i ngurtësojë figurat e viktimave dhe të xhelatëve në rolet e tyre respektive.

“Të mbyturit dhe të shpëtuarit” është shkruar si ese, gjë që nxjerr në pah distancën me të cilën autori përpiqet ta trajtojë këtë çështje, e cila, ndonëse ka kaluar shumë kohë, mbetet sërish plot tensione dhe tepër aktuale; por nuk mungojnë pjesë rrëfimesh me ndjeshmëri të lartë, që vetëm një shkrimtar i madh si Levi mund t'ua ofronte lexuesve. Sa i përket idesë përmbledhëse të librit, mjafton të rikujtojmë pasazhin e shkruar në kopertinën e librit, në botimin e parë: “Ka ndodhur, ndaj mund të ndodhë sërish: ky është thelbi i gjithë asaj çka mund të themi”. Por mund të shtojmë: “Primo Levi i rikthehet përvojës së Lager-it nazist për ta analizuar jo si një fakt të kryer tashmë, një ngjarje të paparashikueshme e të kufizuar, domethënë si një aksident të Historisë, por si një ngjarje shembullore përmes së cilës mund të kuptojmë deri ku mund të arrijë njeriu në rolin e xhelatit dhe në atë të viktimës. Levi, me një ekuilibër dhe kthjelltësi të jashtëzakonshme, u përgjigjet pyetjeve që përballen me problematikat e sotme, por edhe ju flasin brezave të ardhshëm, për të cilët parabola naziste sa vjen e bëhet më e largët. Cilat janë strukturat hierarkike të një sistemi autoritar dhe çfarë teknikash përdorin për të asgjësuar personalitetin e një individi? Çfarë raporti krijohet mes dhunuesve dhe të dhunuarve? Cilat janë qeniet që enden në “zonën gri” të bashkëpunimit (me persekutuesit)? Si formohet një përbindësh? A ishte e mundur të kuptohej nga brenda logjika e makinerisë së shfarosjes? Kishte gjasa që të ngrije krye ndaj saj? Dhe sërish: si funksionon kujtesa gjatë një përvoje kaq të skajshme? Çfarë dinin, apo donin të dinin, gjermanët?”

Levi nuk kufizohet vetëm në sqarimin e aspekteve të dukurisë “Lager”, që deri më sot kanë mbetur të errëta. Ky është edhe një libër “militant”, që lufton kundër çdo falsifikimi dhe mohimi të realitetit, kundër përbaltjes së sensit etik dhe faktit që njerëzit mësohen me atë lloj degradimi njerëzor, që mbush kronikat e këtyre dekadave. “Të mbyturit dhe të shpëtuarit” përbën një kontribut të rëndësishëm në krijimin e një ndërgjegjeje të re kritike.

“Të mbyturit dhe të shpëtuarit” ndahet në tetë kapituj, plus një parathënie e shkurtër dhe një përfundim. I pari i kushtohet “Kujtesës së poshtërimin”, shtrembërimeve dhe mangësive të saj. Levi duket se do të vërë në provë atë mjet – pra, pikërisht kujtesën – që, më shumë se kujtudo tjetër, i ka shërbyer atij, dhe pak të mbijetuarve si ai, për të përcjellë te të tjerët përvojën

“TË MBYTURIT DHE TË SHPËTUARIT” – LIBRI DHE NGJIZJA E TIJ

nga Prof. Fabio Levi*

Përktheu: Aida Baro

Fabio Levi (1949), është profesor nderi i Historisë Bashkëkohore në Universitetin e Torinos. Aktualisht është president i Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve Primo Levi. Ka qenë një ndër nismëtarët e themelimit të kësaj qendre në vitin 2009 dhe e ka drejtuar atë për tri mandate. Në fazën e parë të karrierës së tij shkencore, ai është marrë me historinë shoqërore dhe atë të industrisë. Qysh nga fundi i viteve '80, duke ndihmuar në fillimin e një linje të re kërkimi që deri atëherë ishte lënë plotësisht pas dore, ai studioi veçanërisht ngjarjet e persekutimit anti-hebre në Itali, duke botuar libra të ndryshëm mbi këtë temë.



e internimit nazist. Përmes fjalëve të tij, ai na lë të kuptojmë se ndërgjegjësimi për kufizimet e kujtesës mund të na ndihmojë të zbulojmë edhe më mirë potencialin e saj të jashtëzakonshëm dhe tepër vendimtar krahas fakteve.

Por strumbullari i librit përbëhet nga kapitujt e dytë dhe të tretë, të titulluar respektivisht “Zona gri” dhe “Turpi”. Levi argumenton që hapësira mes kategorisë së viktimave dhe të xhelatëve nuk është bosh, por “aty ka figura të poshtra ose mjerane (ndonjëherë i zotërojnë të dyja cilësitë njëkohësisht), që është e domosdoshme t'i njohim nëse duam të njohim specien njerëzore”. Është një temë e vështirë kjo e formave të bashkëpunimit të fshehtë apo të pranimeve të heshtura mes viktimave dhe dhunuesve: *Kapot*, *Prominenten*-ët dhe të gjitha figurat e tjera groteske të privileguara në Lager dhe në getot hebraike, por edhe gjestet e rralla të mëshirës, shoqëruar me frikë, nga ana e popullsisë civile gjermane. Levi heton dhe përshkruan, por nuk gjykon; me bistrurinë e tij verbale, rrëmon në mishin e gjallë të fakteve. Dhe arrin ta bëjë vetëm pas shumë vjetësh, sepse distanca e largët tashmë nuk do të prekte dhe aq ndjeshmërinë e shokëve që i mbijetuan shfarosjes.

Në kapitullin e tretë, hetimi i tij nxjerr në dritë një ndjenjë paradoksale: “turpin e të mbijetuarit”, ndjenjën e fajit të “të shpëtuarit”, i cili arrin deri aty sa të besojë që ka mbetur gjallë në vend të një tjetri, më të dobëti, më fatkeqi e më të ndershmi se ai, të cilit me sa duket, i ka marrë diçka.

Ose turpi që nuk i ka dhënë ndihmë shokut përbri në momente të skajshme rreziku. Apo edhe turpi që i përket një race si ajo njerëzoria, që është përlyer në krimet më të tmerrshme, faji i të cilave bie mbi të gjithë e mbi secilin. Levi heton ndjenjat e veta dhe ato të të mbijetuarve të tjerë, duke u dhënë atyre ndjenjave një trajtë konkrete, të destinuar për t'i shtyrë lexuesit të reflektojnë për pasojat e pashlyeshme të tragjedisë së Lager-it.

Nuk mund të përmbledh me pak fjalë pasurinë e një reflektimi të gjerë, të saktë dhe me origjinalitet të madh, që shkon përtej dy kapitujve që përmenda. Por ndoshta ia vlen të shtojmë dy gjëra për të tërhequr vëmendjen tuaj. Në kapitullin me titull “Komunikimi”, ndër të tjera, autori tregon që në Auschwitz ishin mbyllur mijëra e mijëra të burgosur të ardhur nga vende të ndryshme, atje flitej në gjuhë të pakuptueshme me tyre, prandaj dhe ishte e pamundur të flisnin dhe të merreshin vesh. Dhe në një vend, ku mungonin fjalët për të komunikuar, thahej edhe aftësia e të menduarit dhe në këtë rrugë, rëndohej procesi i asgjësimit të të internuarve i shkaktuar nga persekutuesit.

Për sa i përket kapitullit me titull “Dhunë e padobishme”, tekta kujton shtazëritë vrasëse të kryera mbi të burgosurit, Levi thekson teprimin, fyerjet e padrejta, pra rrjedhimisht edhe të *padobishme*. Ato nuk shërbenin për asnjë qëllim. Kishin vetëm një synim: të shkaktonin vuajtje të pafundme, të poshtëronin dhe të përdhosnin viktimat. Nuk kishte asnjë arsye të përcaktuar qartë.

Ose ndoshta kërkimi i arsyes, apo i arsyeve, të atyre sjelljeve çnjerëzore përbën një prej pyetjeve të mbetura ende pa përgjigje që na ka lënë Lager-i dhe që Levi na ndihmon ta formulojmë. Sepse ai ishte i vetëdijshëm se përballë një tragjedie me përmasa të tilla, në vend që të kërkohen përgjigje të mjaftueshme, por të pamundura të gjenden, është më mirë të vazhdojmë të ngremë pyetje. Të ngremë pyetje për Lager-ët nazistë, por edhe për qeniet njerëzore në përgjithësi, pra, për ne vetë.

Ndonëse ka larmi temash, “Të mbyturit dhe të shpëtuarit” është një libër i thukët stilikisht dhe me një ton tepër të përmbajtur; nga ana tjetër, duket qartë që është i trazuar nga gjendja psikologjike dhe konjitive së cilës i detyrohet forma e tij; është libri i një antropologu që përfshin veten në fushën e hetimeve; është libri i një njeriu që do të donte të dialogonte me indiferentët, me skeptikët, ish-xhelatët, por ndien drojë dhe neveri njëkohësisht (shihni kapitullin e fundit, “Letra gjermanëve”, ku autori tregon dhe komenton letrat e marra nga Gjermania pas botimit atje të librit “A është, vallë, njeri...?”

Është libri i një njeriu që për të kuptuar xhelatët e vet, përpiqet të arsyetojë me mendjen e tyre, të shohë thellë në këndvështrimin e tyre dhe kjo lojë e tmerrshme rolesh i shkakton një vuajtje të padurueshme. “Të mbyturit dhe të shpëtuarit” ia detyron madhësinë e vet edhe kësaj, të qenit një ushtrim çnjerëzor objektiviteti.

Tani që përshkruam veçoritë thelbësore të librit, do të doja të thosha diçka se si lindi dhe u rrit në mendjen e autorit. Bëhet fjalë për një çështje me rëndësi, sepse për “Të mbyturit dhe të shpëtuarit” shpesh flitet si për një lloj testamenti, të cilit i vënë në dukje një damar pesimist, thuajse si një parashikim i fundit të afërt të autorit. Kur në fakt, duhet vënë në dukje lidhja mes shkrimit të librit dhe një linje mendimi që i ka rrënjët e veta të largëta qysh tek “A është, vallë, njeri...?”, shkruar më 1946 dhe që ndjek një rrugëtim kompleks, të cilin këtu vetëm se mund ta përmend.

Në krye të kapitullit “Letrat e gjermanëve”, i fundit i “Të mbyturit”, Levi shkruan: “A është, vallë, njeri...?” është një libër me përmasa modeste, por si një kafshë nomade, tashmë prej dyzet vjetësh lë pas vetes një gjurmë të gjatë dhe të ndërlikuar.” Kjo frazë, jo rastësisht shfaqet këtu, duke qenë se ai kapitull i tetë dhe i fundit përbën bërthamën më të vjetër të veprës – kujtojmë që botimi gjerman doli më 1961 – ai është pikënisja e një reflektimi të destinuar të shoqërojë autorin gjatë gjithë jetës pas luftës. Por, thënë këtë, lind pyetja se kur apo në çfarë intervali kohor ideja e një *post scriptum* për “A është, vallë, njeri...?” u shndërrua në idenë e një libri të ri.

Në një shkrim me titullin “Përvjetor”, botuar më 1955, në një revistë jo fort të njohur, atëherë kur për Shoah-në nuk flitej pothuajse fare as në Itali, as në Europë, Levi ngrinte pyetje mbi heshtjen e të mbijetuarve të Lager-it. Me kurajë, Levi vinte gishtin mbi arsyen e asaj heshtjeje: “Është turp. Jemi njerëz. I përkasim së njëjtës familje njerëzore, ku bënin pjesë edhe xhelatët tanë. Përpara tmerrit të fajit të tyre, edhe ne ndihemi qytetarë të Sodomës e të Gomorrës, nuk arrijmë t'i largohemi akuzës që një gjykatës mbitokësor, bazuar në vetë dëshminë tonë, do të ngrinte kundër gjithë njerëzimit.” Ai turp ishte shtysa për një reflektim të ri. Pak më pas do të shtoheshin të tjerë.

Në vitet '70-të, Levi përkthen në italishte *La notte dei girondini*, një roman që flet për shfarosjen, shkruar nga Jacob Presser, historian holandez, që është marrë gjatë me deportimin nazist në vendin e tij. Në parathënie, duke folur për Lager-

in, ai shkruante: “Ka ardhur momenti të eksplorojmë hapësirën mes viktimave dhe persekutuesve”. Ndonëse këto fjalë thënë më 1976, kthehen thuhajse identike, dhjetë vjet më vonë në kapitullin “Zona gri”, termi i ri “zonë gri” nuk ekzistonte ende. Por mund ta rigjejmë në një letër personale drejtuar mikeshës së vet, Gabriella Poli-t, shkruar mes fundit të '75-s dhe fillimit të '76-s, pikërisht për librin e Presser-it: “Hapësira mes xhelatëve dhe viktimave është një zonë gri, nuk është e zbrazur”.

Historia e botimit të librit të Presser-it në Itali gërshetohet me ngjarjet politike të atyre viteve, gjatë të cilëve ndihet, në Itali dhe Europë, kërcënimi i një fashizmi të ri. Levi e denoncon në mënyrë të prerë dhe këmbëngulëse këtë kërcënim, në një editorial me titull *Così fu Auschwitz*, botuar në *La Stampa*, të Torinos, më 9 shkurt 1975. Ai vit është vendimtar; por edhe për një arsye tjetër. Botimi shkollor i “A është, vallë, njeri...?” ishte bërë gati qysh më 1972, por vetëm më 1975 Levi vendos të shkruajë një tekst të ri për t’iu përgjigjur pyetjeve më të shpeshta të lexuesve të tij, sidomos atyre të fëmijëve që kishte takuar nëpër shkolla, fëmijë 11-12-vjeçarë, adoleshentë të shkollave të mesme apo atyre teknike: si dëshmitar endacak që ende nëpër shkolla, ky është publiku i tij i vërtetë, ai që e pasionon dhe e fut në ankth. Në fillim të 1976, “Shtojca” për librin “A është, vallë, njeri...?” është gati. Në fillim u shtua vetëm në botimin shkollor, por pas disa vjetësh u shtyp në të gjitha botimet e librit, përfshirë ato të destinuara për publikun e gjerë. Tetë pyetje-përgjigjet e përgatitura nga Levi përpigjen të ofrojnë një kuadër historiko-politik të përgjithshëm, por sjellin edhe jetën e tij morale pas botimit të veprës së parë: dy pyetjet e para kanë të bëjnë me faljen e mundshme të xhelatëve (që Levi nuk ka asnjë qëllim ta bëjë) dhe njohjen e historisë së vet nga ana e popullit gjerman. Por një pjesë e madhe e “Shtojcës”, i kushtohet atyre që te “Të mbyturit dhe të shpëtuarit” do të përcaktoheshin si “stereotipa”: qysh në ato përgjigje ndaj studentëve, Levi angazhohet t’i përshkruajë dhe t’i demontojë me forcën e logjikës dhe me saktësinë e informacionit historik.

Arsyetimi i tij vijon kështu: “sidomos duhet refuzuar interpretimi më naiv sikur nga njëra anë gjendet vetëm dhunuesi i vërtetë, pa dyshime metodike, pa ngurrime, dhe nga ana tjetër, viktimat, e shenjtëruar në rolin e saj prej viktime. Nuk është ashtu. Makinaria njerëzore, kafsha njeri është më e koklavitur. Ka faza të ndërmjetme. Ata që u quajtën xhelatë, nuk ishin xhelatë në stadin më të kulluar: ishin njerëz si ne, që hynë në rolin e xhelatëve për ndonjë arsye. Në librin e ardhshëm, kam ndër mend t’i shpjegoj këto motive”. Analizimi i “fazave të ndërmjetme” (një përcaktim qartësues, që nuk do të ritrajtohet te “Të mbyturit dhe të shpëtuarit”) nuk do të thotë të pranosh çdo gjë dhe të falësh çdo gjë; do të thotë të kuptosh dhe të dallosh me vëmendjen më të madhe morale.

Pra, në mes të viteve '70-të, nis procesi i ideimit që do të shpjerë në shkrimin e librit “Të mbyturit dhe të shpëtuarit”. Një proces që – si gjithnjë në punën e Primo Levi-t – nxitjen për të reflektuar e merr nga lëmi të ndryshme, por boshti kryesor mbetet përvoja në Lager, filtruar përmes asaj çka kaluar në jetën e tij personale, por edhe nga rrëfimet apo shkrimet e të tjerëve. Sidoqoftë, ajo përvojë duhet të ndërveprojë qoftë me një këndvështrim të kujdesshëm ndaj realitetit të sotëm dhe sinjaleve të rrezikut që vijnë prej tij, qoftë edhe me gatishmërinë, pengesat e vështirësitë që ndeshin këto ndryshime në ndjeshmërinë e brezave të rinj.

*Mbi Fabio Levi-n

Botim i ri nga Minerva

FITO BETEJAT ME VETEN

nga Darius Foroux

Këtë parathënie po e shkruaj fikse shtatë vite pas publikimit të parë të këtij libri. Shtatë vite. Është kohë e gjatë dhe shumëçka ka ndodhur. Kështu, kur vendosa që ta ribotoj librin me kopertinë të fortë, doja të sigurohesha që ajo çka shkruhej aty të ishte ende relevante.

A mendoj se janë akoma këshilla të dobishme? A ka gjëra që kam shkruar atëherë, por kam ndryshuar mendim? A ka ndonjë gjë që do të ndryshoj?

U habita që çdo gjë kishte ende vlerë. Në fakt, i kam parë efektet

afatgjata të qasjeve që këshillohen në këtë libër dhe kanë qenë fantastike. Nuk para gënjej. S’kam besuar kurrë në idenë “shtiru derisa t’ia dalësh.” Nuk është në tipin tim. E kam parë gjithnjë veten si njeri të sinqertë dhe të drejtpërdrejtë. Kur e shkrova këtë libër, e ruajta sinqeritetin. I besova aq shumë përmbajtjes sa që kam shkruar me bindje.

Dhe mësimi më i madh që nxorra atëherë ishte se përpara se të bësh çfarëdo në jetë, duhet të rregullosh problemet me veten. Ende e besoj këtë. Harro çdo këshillë jete apo

biznesi që të japin. Nëse nuk je në formë të mirë mendore, nuk do jesh i aftë që të jetosh një jetë të mirë. Sigurisht, ndoshta mund t’i arrish me sukses qëllimet që ke. Ndoshta do të garosh në maratonë, do të ngrihesh në detyrë, apo do të bësh para me bursën.

Asnjëra prej këtyre nuk do të të kënaqë nëse nuk je në gjendjen e duhur mendore. Kam parë kaq shumë njerëz që dëshpërohen dhe gati të gjithë janë të dashur, të talentuar dhe të mirë. Nuk meritojnë të jenë të mërzitur, apo të dëshpëruar. Nuk meritojnë të jetojnë vazhdimisht në atë që unë quaj “*gjendje funerali*.” Kjo ndodh kur mendja nuk është në rregull. Hidhi një sy jetës tënde. A ndihesh rregullisht keq me veten? Kjo s’është aspak normale. Një njeri i zakonshëm lodhet ose ndihet keq një apo dy ditë dhe e merr veten shpejt pas një gjumi të mirë. Kjo gjë mund të ndodhë ca herë në vit. Por nëse je një herë mirë e një herë keq çdo disa javë, atëherë është koha të ndryshosh, të jesh vazhdimisht i kënaqur me jetën.

Nuk ka pse të jesh i lumtur gjithë kohën. Jeta është shumë e vështirë për të qenë ashtu. Të duhet veçse një mendje mjaftueshëm e fortë që të ruash pozitivitetin. Ja ç’po mendoja dje gjatë vrapit.

Jeta është vërtet e vështirë. Kush nuk e pranon ose është delirant, ose është rritur si monark. Ne s’bëjmë pjesë në këto grupe, ndaj na duhet të përballemi me jetën.

Dhe po mendoja: për të jetuar një jetë të lumtur dhe të kënaqshme, të duhet të jesh pak më i ashpër se jeta. Kur jeta përpigjet të të ulë me problemet e punës, politikës, lidhjeve, shëndetit e të tjera, të duhet të ecësh një hap më tutje.

Jeta të godet vazhdimisht me sfida njëra pas tjetrës, dhe në vend që të qëndrojmë të fortë, ne tutemi mendërisht, heqim dorë. Nuk bëjmë dot të ecim përpara. Themi se asgjë nuk ka kuptim. Pse të bësh gjë? Madje, pse të zgjohesh në mëngjes?


Sepse nuk ka zgjedhje tjetër. Kur fitojmë betejat me veten, fitojmë energjinë që na duhet për të përballuar jetën. Ky është udhëtimi që kalova unë, dhe kërkon kohë. Edhe kur po shkruaja këtë libër, nuk isha aq i fortë mendërisht sa sot. Por kisha mjaftueshëm forcë mendore për t’ia nisur udhëtimin. Kaq të duhet. Shpresoj që pasi ta lexosh këtë libër, të kesh mjaftueshëm vullnet që ta bësh edhe ti. Nga ai çast, do të jetë thjesht çështje kohe përpara se të bëhesh aq i fortë mendërisht sa të përballesh me gjithçka që të sjell jeta.

Kujdesu për veten!

-Darius

FITO BETEJAT ME VETEN

Mposht armikun e brendshëm
dhe jeto me qëllim



DARIUS FOROUX

Minerva

Përktheu: Jola Tasellari

160 faqe / 900 lekë

Tolstoi do të shkruante një herë e një kohë se të gjitha familjet e lumtura janë të ngjashme, ndërsa secila familje e palumtur është e palumtur në mënyrën e vet. Një dramë të këtyre palumturisë, në mënyrën e vet, e ka sjellë çekja Tereza Boučková në romanin "Viti i gjelit". Ky roman autobiografik, i përkthyer nga çekishtja prej Ani Hafizit, është ndër prurjet e rishta të shtëpisë botuese "Ombra GVG" dhe sjell një shije të letërsisë çeke të ditëve tona.

Motivi i raporteve familjare është me gjasë më i përhapuri në historinë e letërsisë dhe më i lëvruari, po ashtu. Drama familjare shfaqet si në kryevepra letrare, qysh prej tragjedi greke, ashtu edhe në veprat më periferike të sistemit letrar. Në të tilla drama, raportet familjare herë krisen prej një krimi të tmerrshëm, herë prej një raporti incestor, herë prej ankthit të kompleksit freudian, herë prej mospërputhjes botëkuptimore mes brezave e herë të tjera prej pabesive a tradhtive, prej depresionit a psikopative, prej vështirësive ekonomike, sfidave sociale a personale.

Në një kohë kur ideologjia e epokës që po jetojmë, për fat, e do dhe e përkrah antiracizmin, Tereza Boučková rrëfen subjektin delikat të një familjeje, që është bërë e tillë – familje, pas birësimit të dy djemve, foshnja, të komunitetit rom. Mandej, falë providencës, krejt papritur dhe përkundër gjasave biologjike të shterpësisë pas dy shtatzënive të dështuara, familja shtohet edhe me djalin e tretë, kësaj here biologjik. Por me rritjen e dy djemve të birësuar, rrëfimtars dhe të shoqit të saj, Marekut, iu shtohen telashet, familja i ngjan një qelqurine, krisja e të cilës ka marrë udhë nëpër gjithë enën. As gjithë dhembshuria, përkushtimi, përkujdesja vetëmohuese e dy prindërve nuk mjaftojnë që dy djemtë e birësuar, romë të kenë një jetë normale dhe të jenë pjesë e një familjeje normale (çfarëdo kuptimi që vetë fjala normale mund të ketë).

Djali i madh, Patriku, përfundon i droguar, rrugëve, pa një punë, pa një letërnjoftim, i kërkuar nga shërbimet sociale, i kërkuar nga policia, pa adresë. Nuk e shpëton dot dashuria e prindërve, që e birësuan qyshse ishte foshnje, që të vetmen lidhje e kishte me biberonin e qumështit. Boučková shkruan: "E kujtoj shumë mirë gjendjen e mjerë të fëmijëve tanë, kur i morëm nga instituti. Nuk reagonin ndaj zërit njerëzor – sikur të ishin të shurdhët. Nuk kthenin kokën kur dikush ishte duke folur. Sytë e tyre nuk ndiqnin me shikim një njeri por vetëm biberonin e tyre. [...] E si të mos ndjesh mëshirë për ata? Si të mos i duash? Si të mos iu japësh dashurinë që u është mohuar?"

Djali i dytë i familjes, Lukashi, i ngjan fort Patrikut. Ai nuk shkollohet, nuk ndjek dot asnjë normë të imponuar nga rregulla e përgjithshme, madje ka dhe dorë. Terezës dhe Marekut iu duhet të fshehin çdo gjë, sepse ai vjedh çdo gjë me vlerë, që mund të gjejë nëpër shtëpi e të ruhesh prej dikujt brenda familjes është një makth i vërtetë. Me rritjen edhe Lukashi merr udhët drejt paudhësive, drejt drogës po ashtu. Ndërsa prindërit i gërryen lodhja sflitëse për ta kthyer në udhë të mbarë, për ta ndërgjegjësuar për njeriun e matur që duhet të bëhet. A janë Lukashi dhe Patriku, të tillë për shkak të racës së tyre? Çështja që ngrihet është e kahershme – në thelb kemi të bëjmë me debatin antropologjik nature vs. nurture¹. A bëhet fjalë për pasojat e rritjes, që me ç'tregon Tereza ka qenë e patëmeta sa u takon kushteve dhe përkushtimit ndaj fëmijëve? Apo bëhet fjalë për pasojat e prirjeve të natyrshme, që i dikton gjenetika e përkatësia racore? Përkundër dy djemve të birësuar, djali biologjik i familjes, Mateji, ka një sjellje krejt tjetër, për të rrëfimtaria shkruan: "Mateji është djali i mbarë si gjithmonë (i merr të gjitha 10-a notat në shkollë dhe kjo gjë më jep shumë kënaqësi)" (174). Diskutimi këtu

1 A përcaktohet personaliteti i njeriut nga gjenetika (natyra) apo nga mjedisi ku rritet (ushqyerja).

Roman nga Tereza Boučková, "Ombra GVG"

"VITI I GJELIT" NJË DRAMË FAMILJARE E LETËRSISË ÇEKE

nga Elsa Skënderi

është në të një qasjeje raciste. Por rrëfimi nuk duket se ka nota të nëntëshme djallëzie racore, përveçse lexuesi e di që romani është autobiografik, rrëfimtaria është thjesht një nënë e rraskapitur prej prapësive fatale të fëmijëve të saj të birësuar:

[Mami] duke na parë kaq të rraskapitur për shkak të Lukashit thotë: Nuk do të ndryshojë. E ka brenda. Romët janë të tillë, duhet ta marrësh ashtu siç është, ju duhet të dorëzoheni vetë. Nuk është e vërtetë! Jo të gjithë romët janë të tillë! Të dorëzohemi? A jetohet përgjithmonë me portofolin e fshehur nën shtetull, të mbyllësh gjithçka, të fshehësh gjërat nga frika se mos zhduken dhe të mos jetosh me zhgënjimin e vazhdueshëm që një djalë, të cilin e morëm në shtëpinë e fëmijës për t'i dhënë një jetë më të mirë, të na vjedhë dhe sakaq të ulët çdo natë në tavolinën tonë? [...] Ne nuk mund të dorëzohemi para kësaj jete që na imponon Lukashi, vetëm sepse romët janë të tillë. Nuk dua që djali im të jetë i tillë. Unë nuk dua të heq dorë! (248).

Ngjarjet në roman rrëfehen në formën e shënimeve të një ditari, pa data në krye të secilës pjesë, por me stilin e pastrukturuar tematikisht të një ditari. Rrëfehen ato që Terezës i janë dukur të rëndësishme, që i ka përjetuar si ndodhi, por duke i ikur rrëfimit

të detajuar, kronologjik të andrallave të çdo dite. Rrëfehët jeta siç ndodh dhe synimi i rrëfimit të tillë është çlirimi:

Të vetmet përjashtime janë këto shënime të mia, që i shkruaj me të shpejtë dhe i vë mënjane që mos të mbytem në to. Kuptoj që edhe pse ditët janë më të shkurtra dhe se çdo përpjekje e imja sado e fortë për t'u kapur pas punës për të shpëtuar familjen time të përbërë në mënyrë artificiale, është e kotë [...] (191).

Rrëfimtaria i ikën cerimangës së ndërlikët të jetës familjare, sa herë që ndjek ngjarjet e jetës kulturore të Pragës, filma, teatro, skenarë që lexon apo artikuj që shkruan vetë. Për këto, gjatë gjithë romanit jep në mënyrë të thukët përshtypje e mbresa, duke e bërë librin një album të këndshëm recensash, që vlejnë edhe si receta artistike për lexuesin bashkëkohor të veprës, i cili i ka pjesë të enciklopedisë së tij ditunore, ato vepra arti që cekën e gjykohen në romanin e Boučková-s. Këto recensa e ftillojnë edhe referencën kohore në veprë, teksa koha e dëshmuar qartë bën që të kuptohet më mirë konteksti i gjerë social dhe të aktualizohet një dramë familjare, e cila evokon përkritazi sprova të afërta a të ngjashme, që shumëkush i ka përjetuar dhe në familjen e vet.



Kësisoj, në veprë gjithë rituali i jetës sfiduese familjare, problemet me fëmijët, detyrat e përhershme për mirëmbajtjen e shtëpisë, gjendja e rënduar psikologjike ndërthuren me ritualet e një gruaje të angazhuar me art, çka qartësisht e ripohon idenë e kamotshme të artit si formë pastrimi shpirtëror.

Në Shtetet e Bashkuara po ndodh një uragan. Te ne është çdo gjë e qetë. Politikanët zihen gjithmonë në të njëjtën mënyrë. Ministri i Kulturës nuk ka bërë akoma asgjë për të mirën e kulturës, por është dobësuar, ka rënë disa kile dhe nuk duket më si një bonbon. Abonimin që kisha me gazetën e kam anuluar një vit më parë dhe tashmë i ndjek lajmet nga radio dhe televizori. Gjithçka duket e qetë përveç uraganit. Hapa sërish "Dëlat film"/ "Të bësh një film", librin e Federiko Felinit. Është një balsam për shpirtin tim. (71)

Një film në kinema a një libër është arratisja ngushëlluese prej realitetit të hidhur të përditshmërisë. Në shtjellën e vështirësive familjare, pasi ndihet e dështuar në rolin e saj të nënës, kriza depressive dhe tek e fundit jeta, që thjesht ndodh — siç i ndodh çdokujt, e bën rrëfimtaren të ketë nevojë për një mbështetje të shprehur, të qartë, inkurajuese:

A ka në këtë botë ndonjë që më mendon? Kush është? Le të vijë te unë. Të vijë të më shtrëngojë. (112)

Në një familje në krizë, pashmangshëm në krizë është edhe raporti bashkëshortor. Mareku, i shoqi i Terezës, shpëtimin e gjen te udhëtimet e stërgjata me biçikletë, ndërsa ajo ndjen që ka nevojë të thekshme për vlerësim prej tij. Për një kohë i bëhet se shpëtimin mund ta gjejë te një lidhje jashtëmartesore. Një flirt me një burrë më të madh në moshë dhe ideja ëndërrimtare e një dashurie tjetër, të ndaluar, që do t'ia kthejë emocionet për jetën.

Kur iu rrëfeva mamasë sime që edhe pse e doja Marekun, u dashurova me dikë tjetër, e pyeta: Si është e mundur të ndodhë kjo? Çfarë duhet të bëj? Ajo m'u përgjigj: Mos e moho, dashurinë nuk duhet ta mohosh kurrë. [...] Kam përbrenda dy forca kundërshtare, dashurinë për Marekun dhe dëshirën për t'u zhytur në një dashuri të re. Po vdes nga dëshira. (93-4).

... edhe jeta vijon, me të njëjtin ritëm të marrë ndërlikësjeje. Lukashi, në ecejake mes institutit social të riedukimit — shtëpisë (më tepër në raste festash) — rrugës (si destinacion i pashmangshëm magnetik), mësohet se ka lënë shtatzanë Evën 15-vjeçare. Tashmë Terezës dhe Marekut, të lodhur edhe ekonomikisht, iu shfaqet dilema e marrjes përsipër të një jete të re, detyra prej gjyshërish ndaj një foshnjeje, që ka për të ardhur në jetë pashmangshëm, pa u pyetur; një foshnje e hedhur në botë!

Fundja, siç thoshte filozofi Hajdeger, ne, të gjithë, jemi të hedhur në botë. Por ja që e njerëzishmja brenda nesh, na bën t'i mbajmë afër më të brishtët ndër ne, qofshin ose jo ata të gjakut tonë. E njerëzishmja mëton ta bëjë hedhjen në botë më pak traumatike. Por, edhe një herë një veprë letrare, i.e. "Viti i gjelit", e dëshmon në mënyrë fikzionale se individit gjithsesi i duhet të dojë të kapet e të mbahet, duke u treguar edhe vetë i njerëzishëm ndaj fijeve e lidhjeve, të cilat për fund shpiten te kuptimi i qenies në botë.



Kur shkrimtari Gabriel García Márquez, autori i “Njëqind vjet vetmi” dhe romaneve të tjerë klasikë, vdiq para thuajse dhjetë viteve, ai la pas një roman të papërfunduar, “Shihemi në gusht”. Romani u botua më 6 mars, duke sjellë një reagim të ashpër nga studiues, shkrimtarë dhe fansa, të cilët i janë kundërvënë jo romanit në vetvete, por asaj që e shohin si akt tradhtie që rrezikon trashëgiminë e García Márquez-it.

Para se të vdiste, García Márquez u kërkoi të bijve, Rodrigo-s dhe Gonzalo-s, ta shkatërronin romanin. Nuk e shkatërruan. Nuk mundën. E kuptoj.

Jeta e një veprë arti nuk përfundon kur vdes krijuesi. Artistët lënë shumë rrallë udhëzime të qarta se çfarë duhet të bësh me veprat e tyre, sidomos me ato të papërfunduarat, të cilat mund të çojnë në beteja ligjore kaotike. Edhe kur udhëzimet janë specifike, mund t'i vendosë ekzekutorët në një pozicion të vështirë. Trashëgimtarët kanë përgjegjësinë që të ruajnë dhe promovojnë trashëgiminë e artistit, që të vlerësohet për breza me radhë.

Imagjino të jesh ti që vendos nëse duhet ta shkatërrosh veprën e një artisti me ndikim, i cili gjithashtu rastis të jetë yt atë, dhe se si është të jetosh kur e di se njerëzit do të të shohin dhe gjykojnë atë që po bën sot, ndërsa ata në të ardhmen mund t'i vajtojnë veprimet e tua. E vërteta është se nëse djemtë e García Márquez-it do të kishin vepruar sipas kërkesave të babait, me siguri do të ishin kritikuar gjithsesi. Në të vërtetë, çfarëdo që të bëjnë trashëgimtarët, disa njerëz nuk do jenë të kënaqur.

Të gjithë përfitojmë kur vepra nga artistë të mëdhenj caktohen për t'u shkatërruar dhe në vend të kësaj ruhen. Prandaj mënyra se si djemtë e García Márquez-it kanë menaxhuar trashëgiminë e të atit, së bashku me botimin e “Shihemi në gusht”, duhet të lëvdohet dhe ndoshta të studiohet.

Ka gjasë se, që nga koha kur García Márquez filloi të punonte më intensivisht

VËRTET DO TË
ISHTE MË MIRË TË
MOS E SHIHNIM
KURRË LIBRIN
E FUNDIT TË
MARKEZIT?
Nga Álvaro Santana-Acuña

Z. Santana-Acuña është pedagog i sociologjisë në Whitman College dhe studiues i Gabriel García Márquez-it.

me “Shihemi në gusht” në vitin 2003, kujtesa kishte filluar ta linte. Pashë versionet e ndryshme të dorëshkrimit në arkiva. Ato ishin të çorganizuar, dhe shkrimi më hezitues në krahasim me veprat e kaluara. Sidoqoftë, vitin e ardhshëm ai përfundoi një bocë të plotë të papërsosur. Të bijtë, miqtë, dhe agjenti letrar u përpoqën ta ndihmon me redaktimin, derisa i avancoi demenca. Në atë pikë, duke menduar se s'bënte, García Márquez u kërkoi të bijve ta shkatërronin. Është e lehtë të dalësh në përfundime pasi dëgjon lajmin se të bijtë e botuan romanin pavarësisht urdhrave të babait. Padyshim është lajm tërheqës. Shumë kanë nxituar të akuzojnë të bijtë se e kanë botuar romanin vetëm për para – akuzat të ngjashme u bënë edhe pasi familja ia

shiti arkivin e shkrimtarit Qendrës Harry Ransom në Universitetin e Texas-it, në Austin, pasi i shitën gjithashtu Netflix-it të drejtat për të ekranizuar “Njëqind vjet vetmi”.

Por këto vendime e kanë bërë veprën e García Márquez-it më të disponueshme publikisht dhe globalisht. Arkiva e Gabriel García Márquez në Qendrën Ransom, e cila mban gjithashtu materiale nga William Faulkner dhe Ernest Hemingway, është një prej koleksioneve më të vizituara online dhe fizikisht.

Kur vizitova arkivat, lexova korrespondencën e tij personale, e cila ma bëri të mundur të shoh qartë se si e shkroi “Njëqind vjet vetmi”, gjë që më vonë formoi bazën e kërkimit për librin tim mbi të shkruarin e këtij romani.

Sigurisht, jo të gjithë trashëgimtarët veprojnë në mënyrë të admirueshme. Për dekada, Maria Kodama, e veja e Jorge Luis Borges, hodhi në gjyq këdo që e pa të arsyeshme për keqpërdorimin e veprës së të shoqit. Shpesh u akuzua se ishte shumë protektive. Vdiq në vitin 2023 pa – në mënyrë të pakuptueshme – lënë një testament apo një trashëgimtar të caktuar. Tani të afërmit e saj – pesë nipër e mbesa me të cilët kishte pak kontakt – janë trashëgimtarët e veprës së Borges-it.


Askush nuk e mohon se “Shihemi në gusht” është vepra e papërsosur e një mjeshtri që po plakej. Si e tillë duhet të lexohet. Trashëgimtarët e artistëve duhet t'ua plotësojnë dëshirat, por edhe të mbrojnë trashëgiminë e tyre, që ndonjëherë i mbrohet më mirë duke ua vënë në dispozicion veprat, sado të papërsosura, brezave të ardhshëm.

Veprat e papërsosura të artit janë më të dobishme se të shkatërruarat. Ditë para se të vdiste në vitin 1852, shkrimtari rus Nikolai Gogol, dogji disa dorëshkrime, mes tyre, pjesën e dytë të asaj që do të ishte trilogji, “Shpirtra të vdekur”. Studiues dhe fansa e kanë vajtuar shkatërrimin e tyre.


Kur veprat e artit vihen në dispozicion, artistët mund të vazhdojnë të jetojnë e madje dhe të përjetësohen në mënyrat më të bukura: në veprat e artistëve të ardhshëm. Franz Kafka, në ditët pranë vdekjes, urdhëroi mikun e tij Max Brod t'ia digjte veprat e papërfunduara. Të gjithë e dinë se Brod nuk e bëri këtë. Kjo tradhti ndryshoi historinë e letërsisë dhe të një rioshi i cili, pasi lexoi “Metamorfozën”, vendosi të bëhej shkrimtar. Ky i ri ishte García Márquez.

Edhe pse “Metamorfoza” nuk ishte një prej librave që Kafka donte të digjte, nuk fitoi famë dhe ndikim të madh derisa Kafka mori vëmendje të mëtejshme përmes veprave që ruajtji Brod-i. Nëse botimi i “Shihemi në gusht”, frymëzon dikë të bëhet shkrimtar, djemtë e García Márquez-it do t'i kenë bërë nder të madh letërsisë, ashtu si Brod-i.

Përktheu: Enxhi Hudhri



Romani i panjohur i G. G. Markezit u botua në të gjithë botën
(në shqip nga Onufri), në të njëjtën ditë: 6 mars 2024




**LIBRARIA
ONUFRÍ**
onufri librari
onufri librari .com